



Raporti vjetor i monitorimit 2020

Strategjia për Menaxhimin e Financave Publike 2019-2022

Korrik 2021

Përmbledhje ekzekutive

Ky dokument paraqet Raportin e gjashtë të Monitorimit Vjetor të Menaxhimit të Financave Publike për periudhën nga 1 janari deri më 31 dhjetor 2020. Ai përmban informacion të detajuar mbi ecurinë e strategjisë së MFP-së. Në vitin 2019 qeveria rishikoi Strategjinë për Reformën në Menaxhimin e Financave Publike, për periudhën 2019-2022. Versioni i përditësuar i së cilës u miratua nga Këshilli i Ministrave në muajin dhjetor 2019. **Objektivi kryesor i strategjisë është të mundësojë një buxhet të mirëekuilibruar dhe të qëndrueshëm me raport të ulur të borxhit nëpërmjet menaxhimit më të fortë financiar dhe kontrollit, si dhe proceseve të auditimit, në mënyrë të atillë që zbatimi i buxhetit të jetë në përputhje me politikat e qeverisë.** Gjatë vitit 2020 u rishikuan disa nga vlerat e synuara të Objektivave Specifikë dhe produktet shoqëruese për të reflektuar pasojat negative të tërmetit të nëntorit 2019 dhe pandemisë së Covid-19 në përmbushjen e rezultateve. Megjithatë ndryshimet janë përfshirë në kornizën logjike të Strategjisë, baza mbetet e njëjtë për objektivin e përgjithshëm dhe objektivat specifike.

Raporti në fjalë përmban një vlerësim të kriterëve klasifikuese të PFM-së në mënyrë që BE-ja të lëvrojë mbështetje buxhetore për Shqipërinë. Kriteret klasifikuese kërkojnë ekzistencën e një programi të qëndrueshëm dhe të rëndësishëm reformash për të përmirësuar MFP-në si dhe ecuri të kënaqshme për zbatimin e programit. Sipas vetëvlerësimit tonë **ecuria e MFP-së në përgjithësi ka qenë e mirë.**

Strategjia e përditësuar përbëhet nga shtatë objektiva specifike (OS):

1. OS1: Kuadër fiskal i matur dhe i qëndrueshëm
2. OS2: Planifikim i mirëintegruar dhe efikas
3. OS3: Mbledhja e të ardhurave
4. OS4: Zbatim efikas i buxhetit
5. OS5: Transparenca e financave publike
6. OS6: Kontroll i brendshëm efektiv
7. OS7: Mbikëqyrje efektive e financave publike

Pjesa 1 përmban një hyrje në raport, shpjegon metodologjinë e monitorimit dhe përshkruan vizibilitetin e MFP-së dhe procesin e konsultimeve. **Pjesët 2 dhe 3 të raportit tregojnë në mënyrë të hollësishme ecurinë e së cilit Objektiv Specifik (OS) si dhe gjendjen me përmbushjen e rezultateve dhe treguesve të performancës.**

OS1 ‘Kuadër fiskal i matur dhe i qëndrueshëm’ synon të krijojë një kuadër makroekonomik të matur dhe politika fiskale që ndihmojnë në uljen e raportit të borxhit ndaj PBB-së në planin afatmesëm në 60 për qind, duke forcuar rregullat financiare, mbikëqyrjen financiare dhe menaxhimin e risqeve fiskale.

Progresi për OS1 ishte përgjithësisht i mirë, vetëm rezultati lidhur me devijimin nga mbledhja faktike e të ardhurave si % e parashikimit të miratuar buxhetor për të ardhurat nga tatimet dhe doganat u përmbush pjesërisht. Veç rregullave ekzistuese (si dispozitat ligjore për rregullimin e parashikimit tepër optimist, rregulla për ndërprerjen e borxhit, etj. të futura që prej vitit 2016) në vitin 2020 u fut dhe një rregull i ri fiskal që synonte bilancin primar. I gjithë grupimi i rregullave synojnë si përfundim që në planin afatmesëm dhe afatgjatë të përmbushin objektivin fiskal për uljen e raportit borxh/PBB në nivele “të sigurta” dhe konsolidimin e financave publike. Raporti tregoi tendencë në ulje për periudhën 2015-2019, por u rrit në 76,1% në 2020 si rezultat i shpenzimeve të menjëhershme të qeverisë për të ndihmuar me procesin e rindërtimit si dhe për të zbutur pasojat nga Covid-19. Gjithashtu u rrit edhe deficitin buxhetor. Megjithatë në periudhën 2016-2020 parashikimet për PBB-në nominale ishin të kujdesshme dhe më të ulëta se parashikimet për PBB-në në IMF World Economic Outlook, për pesë vitet e fundit dhe sidomos në vitin 2020, parashikimet për të ardhurat dhe projeksionet tatimore mbeten vazhdimisht tepër optimiste. Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Makroekonomike dhe Çështjeve Fiskale (DPPMCF) krijoi një sektor të ri për analizat dhe statistikën për të përmirësuar aftësitë parashikuese, por vetëm gjysma e vendeve u plotësuan në

vitin 2020 kryesisht për shkak të kohës që nevojitet për zbatimin e praktikave të punësimit. Në vitin 2019 mbulimi i Pasqyrës së Risqeve Fiskalë (PRF) përfshiu një numër më të madh rreziqesh, përfshirë ato nga ndërmarrjet shtetërore të shërbimeve publike, detyrimet e prapambetura dhe risqet nga kontratat PPP. Në 2020, Njësia e Riskut Fiskal (NjRF) ka monitoruar çdo muaj performancën financiare dhe jofinanciare të gjithë koncesioneve dhe kontratave PPP me mbështetje buxhetore dhe maj 2020 u publikua për herë të parë Përmbledhja e Raportit Vjetor për vitin 2019 që përmbante informacion financiar dhe jofinanciar mbi PPP-të aktive.

OS2 ‘Planifikim i mirëintegruar dhe efikas’ synon të harmonizojë më tej dokumentet planifikues të qeverisë, kombëtarë dhe sektorialë me Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA), si dhe përmirësimin e mëtejshëm të buxhetit vjetor dhe procesit të PBA-së për të përmirësuar qëndrueshmërinë dhe gjithëpërfshirjen e planifikimit afatmesëm dhe për minimizimin e detyrimeve të prapambetura. Gjithashtu, OS2 fokusohet në përmirësimin e mbikëqyrjes së menaxhimit të investimeve publike si dhe në forcimin e menaxhimit financiar në qeverinë vendore.

Në vitin 2020 u krye një rishikim afatmesëm i SKZHI-II (2015-2020) dhe raporti përfundoi në vitin 2020. Departamenti për Zhvillim dhe Mirëqeverisje pranë Zyrës së Kryeministrit (DZHM/ZKM) përfundoi zbatimin e një sistemi të automatizuar gjithëpërfshirës për të forcuar Sistemin e Planifikimit të Integruar (SPI) që lidh planifikimin e politikave strategjike me planifikimin buxhetor. Mbështetja juridike e planifikuar për funksionimin e IPSIS-it nuk mund të përfundohej deri në fund të vitit 2020, megjithatë u miratua një Vendim i Këshilli të Ministrave dhe një udhëzues për vendosjen dhe monitorimin e treguesve të performancës që ndihmon me procesin e zbatimit të tij. Në korrik të vitit 2020, Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit (AKSHI) miratoi operacionalizimin dhe gatishmërinë për fillimin e funksionimit të IPSIS-it. Shumë aktivitete trajnuese u organizuan në lidhje me të.

Njësoj si në vitin 2019, edhe në vitin 2020 u krye rishikimi i mënyrës së zbatimit dhe pajtueshmërisë me Udhëzuesin Standard për Përgatitjen e Buxhetit (USPB). Pavarësisht trajnimeve dhe këshillimeve të thelluara, nga rishikimi u konstatuan se kishte ende mangësi dhe mospërputhshmëri në zbatimin e udhëzuesit të ri në një numër sektorësh. Moduli i ri i PBA-së që përfshin edhe SIFQ-në ekzistuese u përfundua dhe u shtri në ministrinë e linjës dhe institucionet buxhetore. Komiteti i Planifikimit Strategjik miratoi Dokumentin për Politikën Prioritare në mars dhe korrik 2020 në dy takime të ndara. U vendos për nismat për politika të reja përpara përfshirjes së tyre në PBA.

Në lidhje me Menaxhimin e Investimeve Publike (MIP), Këshilli i Ministrave miratoi një procedurë të re në 2008 që synonte të përcaktonte kritere të reja për prioritetizimin dhe vlerësimin e projekteve të mëdha të investimit kapital. Gjatë viteve 2019 dhe 2020 Drejtoria për Investimet Publike dhe KM-ja bënë trajnime të zgjeruara si për propozimet e reja për investime publike që duhen dorëzuar për miratim dhe për modulin e ri të SIMFSH-së. Sa u takon PPP-ve, u rrit numri i kontratave që u rishikuan nga Drejtoria për Koncesionet në vitet 2019 dhe 2020. Siç u përmend, u publikua Raporti Vjetor për vitin 2019 që përmbante informacion financiar dhe jofinanciar. Lista e Unifikuar e Projekteve për të gjitha projektet, pavarësisht burimit të financimit u miratua nga Komiteti i Planifikimit Strategjik (KPS) në 2020. Si rezultat, u përmirësua raporti i investimeve të reja publike të dorëzuara brenda ciklit të PBA-së krahasuar me investimet e reja publike gjithsej të miratuara brenda vitit.

Në fushën e MFP-së në qeverinë vendore (QV) vitin e kaluar u bënë disa ndryshime të rëndësishme në kuadrin rregullator, si miratimi i Ligjit “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligji “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, si dhe një sërë aktesh nënligjore dhe udhëzimesh. Në vitin 2020 NJQV-të forcuan edhe më tej planifikimin strategjik dhe menaxhimin e buxhetit. Shumë NJQV filluan të përdorin treguesit e performancës gjatë procesit të përgatitjes dhe monitorimit të PBA-së. Gjatë vitit 2020 u krye rishikimi i kuadrit rregullator në lidhje me proceset e PBA-së në nivel vendor. Nga fundi i vitit 2020 të gjitha bashkitë përgatitën Raportin mbi Statusin e Vështirësive Financiare. Në vitin 2020 detyrimet e prapambetura nga NJQV-të ishin në rënie

krahasuar me vitin paraardhës, por mbetën mbi synimin e planifikuar. Nuk mund të përfundohej manuali që përmbante rregullat lidhur me tatimet dhe regjistri i përditësuar i tatimeve me synimin e një menaxhimi efektiv të të ardhurave. Nga ana tjetër, rishikimi dhe përmirësimi i paketave të planifikuara fiskale të bashkisë u përfundua. Së fundi, Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik (DPHKBFP) ka realizuar shumë aktivitete për ngritjen e kapaciteteve për të krijuar një kontroll të brendshëm efektiv dhe për funksionin e auditimit të brendshëm në nivel vendor. Gjatë vitit 2020 u krye një Vlerësim Gjithëpërfshirës i Nevojave për të vlerësuar kornizat strategjike sektoriale dhe ndërsektoriale si dhe kapacitetet konkrete për planifikimin strategjik, monitorimin dhe vlerësimin e objektivave të performancës së NJQV-ve. U miratua një Plan Kombëtar për të Dhënat Sistemike (NSPD) 2020-2027 i cili do të trajtojë nevojat e evidentuara në vlerësim.

OS3 ‘Mbledhja e të ardhurave’ synon të rrisë nivelin e mbledhjes të së ardhurave tatimore dhe doganore nëpërmjet politikave të rishikuara për të ardhurat, kapacitetit më të lartë në administratat tatimore dhe doganore si dhe përmirësimit të pajtueshmërisë me detyrimet nga ana e tatimpaguesve, reduktimit të evazionit tatimor dhe ekonomisë informale.

Në 2019, administrata tatimore përfundoi ndërtimin e procedurave të automatizuara bazuar në risk për të gjitha rimbursimet e TVSH-së dhe krijoi një regjister të plotë dhe të saktë për tatimpaguesit. Kjo u forcua më tej me anë të informimit të tatimpaguesve dhe inkurajimin e përmbushjes vullnetare të detyrimeve tatimore, ndër të tjera, përmes fushatave ndërgjegjësuere dhe takimeve informative. Gjatë vitit 2020 u rishikuan rregulloret për rimbursimin që synonin të thjeshtonin dhe të lehtësonin kriteret që zbatonin për riskun. Përfundoi shumica e punës për zbatimin e rimbursimit automatik të TVSH-së. Si rezultat, periudha e shlyerjeve të rimbursimeve të TVSH u përgjysmua dhe stoku i TVSH-së së akumuluar ra me 16% në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019. Pjesë e automatizimit të proceseve bazë të administratës tatimore ishin dhe përmirësimi i modulit për menaxhimin e faturave elektronike që nisi në vitin 2019. Ka pasur progres për plotësimin e verifikimit elektronik që mund të përdoret për të verifikuar informacionin e kthimit. Futja e procesit të fiskalizimit mund ta bëjë edhe më efektiv procesin e verifikimit por meqë raporti nuk mund të përfundohej në 2020 atëherë as verifikimi automatik i informacionit për pagesat nuk mund të përfundohej.

Në 2019, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve krijoi një regjister për tatimpaguesit të plotë dhe të saktë që u përmirësua dhe më tej në vitin 2020. Marrëveshja mes DPT dhe Qendrës Kombëtare të Biznesit mundësoi transmetimin në kohë të të dhënave për regjistrimin dhe ndryshimet përkatëse të kompanive. U organizuan tri fushata ndërgjegjësimi në 2020 që lehtësuan përfundimin e regjistrimit. U realizua trajnimi i punonjësve të menaxhimit të riskut me synim krijimin e një sistemi gjithëpërfshirës për menaxhimin e riskut. Katërmëdhjetë punonjës nga Drejtoria për Menaxhimin e Riskut ndoqën trajnimin gjatë shkurtit – marsit 2020 me fokus në sektorin e ndërtimit. U analizuan në thellësi sektori i turizmit, 33 profesione të lira dhe transaksionet zinxhir që fillojnë nga kompanitë më të mëdha. Së fundi, stoku i borxhit u përditësua bazuar në raportet mujore të Drejtorive Rajonale për Mbledhjen e Borxhit.

Reforma e tatimit mbi pronën u vonua për shkak të ngjarjeve të paparashikuara. Objektivi i vendosur për vitin 2020 për vendosjen e taksës së pronës sipas zonës fiskale për ndërtesat dhe realizimi i mbledhjes së taksave nuk u arrit. Gjatë vitit 2020 u arrit një marrëveshje mes MFE-së, SIDA-s dhe Agjencisë Shtetërore të Tatimeve për të zgjatur për dy vjet agjendën e reformës së tatimit mbi pronën. Ligji për taksën mbi pronën nuk është miratuar siç është planifikuar brenda vitit 2020 pasi është ende në proces konsultimi. Sistemi informatik është përmirësuar dhe personeli i bashkisë është trajnuar mbi versionin konkret të sistemit të TI-së. Krijimi i zonave për vlerën përkatëse dhe zbatimi në sistem është në ecuri e sipër.

Në lidhje me doganat, nuk u arrit vlera e synuar për përqindjen e mbledhjes faktike të të ardhurave në 2020 krahasuar me mbledhjen e të ardhurave në vitin paraardhës. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (DPD) punoi më tej për harmonizimin e kornizës rregullatore me *acquis communautaire* të BE-së, përfshirë

zhvillimet më të fundit si harmonizimi i ITD-së dhe Nomenklaturës së Mallrave. Sistemi për menaxhimin e cilësisë në laboratorët doganorë gjatë vitit 2020 mori certifikimin vjetor dhe akreditimin për analiza të ndryshme. Gjatë 2020, tetë subjekte aplikuan për statusin e Operatorit Ekonomik të Autorizuar (OEA), por asnjë prej aplikimeve nuk është miratuar ende. Po ashtu në 2020 u nënshkruan kontratat për Sistemin e Integruar të Menaxhimit të Tarifave plotësisht në përputhje me BE-në dhe për përmirësimin e sistemit ASYCUDA me UNCTAD.

OS4 ‘Zbatim efikas i buxhetit’ synon të garantojë përdorim efikas dhe efektiv të burimeve buxhetore të aprovuara, duke forcuar zbatimin efikas të buxhetit (falë përdorimit të teknologjisë së informacionit), minimizimin e detyrimeve të prapambetura duke ulur kostot e huasë, mundësimin e likuiditetit në kohë, rritjen e efikasitetit dhe transparencës së sistemit të prokurimeve, përmirësimin e menaxhimit të fondeve të jashtme dhe forcimin e menaxhimit të ndihmës shtetërore.

Gjatë periudhës 2014-2020, 15 institucione buxhetore u përfshinë në SIFQ që përfaqësojnë rreth 78 për qind të shpenzimit të përgjithshme të qeverisë. Qeveria planifikon të shtrijë sistemin në gjithë institucionet buxhetore të mëdha, por është parashikuar një shtyrje në kohë. Integrimi i SIFQ-së me Sistemin për Menaxhimin e Doganave mbetet një sfidë pasi testimi i ndërfaqes nuk u arrit të përfundohej deri në fund të 2020. Është bërë ecuri e mirë në 2020 për integrimin e SIFQ-së me HRMIS. Është parashikuar që të fillojë funksionimin në gjysmën e dytë të 2021 pas nxjerrjes së udhëzimit nga ministri i Financave dhe Ekonomisë lidhur me procesin dhe trajnimin e disa punonjësve nga njësitë e qeverisë qendrore nga ana e DAP-it dhe MFE-së. Deri në fund të 2020 portali në internet për arkivat elektronike ishte i aksesueshëm për 110 IB. IB-të e mbetura do kenë akses duke nisur nga gjysma e dytë e 2021, menjëherë pas përmirësimit të suksesshëm të pajisjes së SIMFSH-së.

MFE-ja vazhdoi punën për forcimin e masave për pajtueshmërinë ndaj angazhimeve të shpenzimeve dhe kontrolleve. Gjatë vitit 2020 Ministri i Financave dhe Ekonomisë ngriti një grup pune për detyrimet e prapambetura për të monitoruar zhvillimet në fushën e detyrimeve të prapambetura dhe për të dhënë rekomandime sistematike. Audituesit e brendshëm kanë qenë të angazhuar në auditimin e detyrimeve të prapambetura në njësitë më problematike. Rreth 67 njësi audituese kanë raportuar gjetjet e tyre dhe kanë dhënë rekomandime për vitin 2020. Draft Udhëzuesi për auditimin e detyrimeve të prapambetura është përgatitur për të ndihmuar audituesit të kryejnë sa më mirë auditimet. Mjedisi i dobët i kontrollit (sidomos zbatimi i kontrollit) në të gjitha njësitë, sidomos në NJQV, ishin shkak kryesor për krijimin e detyrimeve të prapambetura. Gjetjet dhe rekomandimet përfshiheshin në raportin vjetor të KBFP-së dhe janë diskutuar në takimet e bordit të KBFP-së.

Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit ka punuar më shumë për të përmirësuar parashikimin dhe monitorimin e likuiditetit. Shumica e rekomandimeve nga Banka Botërore dhe FMN-ja për të përmirësuar parashikimin e likuiditetit u trajtuan si duhet në 2020. Veçse nuk mund të organizohej trajnimi i punonjësve kryesor të financës së IB-ve kryesore për shkak të pandemisë nga Covid-19. Analiza për qëndrueshmërinë e borxhit kryhet rregullisht. Në vitin 2020 u përgatit një Strategji për Menaxhimin e Borxhit në Planin Afatmesëm dhe u miratua në fillim të 2021. Programi vjetor i huasë nuk u aprovua për shkak të vështirësive të mëdha me të cilat u përball Drejtoria e Borxhit në kuadër të instrumentave të reja që dolën për shkak të pandemisë së Covid-19, rritjes së kërkesës për likuiditet dhe ndryshimi i stafit.

Prokurimi Publik ka pasur progres. Parlamenti miratoi Ligjin e ri “Për Prokurimin Publik” më 24 dhjetor 2020. Deri në fund të 2020 u plotësuan vendet bosh në KPP. Planet për përmirësimin e Sistemit të Prokurimit Elektronik (SPE) nuk u realizuan në 2020 dhe do të zbatohen në 2021. Sistemi elektronik i ankesave në KPP është në përfundim për të thjeshtuar menaxhimin e ankesave. Ndërfaqja e SIFQ-së dhe SPE-së u përfunduan në 2020 dhe mund të kryhet kontrolli online i fondeve të lira para se të fillojë procedura e prokurimit. Gjithashtu, në 2020, dy vlerat e synuara të rezultateve lidhur me prokurimin publik nuk u përmbushën plotësisht. Treguesi në % në vlerën e procedurave përfundoi me fituesin brenda tremujorit të parë kundrejt fondit gjithsej të parashikuar, ndërsa për 6 mujorin nuk u realizua për shkak të pandemisë nga Covid-19 dhe

ndryshimit të prioriteteve nga autoritetet kontraktuese. Pritet që reformat në fushën e prokurimeve të përfundojnë vitet e ardhshme.

Në lidhje me menaxhimin e fondeve të jashtme, u krye më shumë punë për plotësimin me të dhëna të Sistemit Informatik për Menaxhimin e Asistencës së Jashtme (SIMAJ). Deri në fund të 2020, përfundoi praktikisht hedhja/migrimi i të dhënave për 2017 dhe 2018. Do të vazhdojë puna në 2021 për të hedhur të dhënat e BE-së dhe të partnerëve të tjerë për zhvillim.

Së fundi, kuadri rregullator për Ndhimën Shtetërore u përmirësua në përputhje me rregulloret dhe udhëzimet e BE-së. Ka nisur puna për krijimin e një baze të dhënash efektive për monitorimin e zbatimit të Ndhimës Shtetërore dhe janë zhvilluar aktivitete ndërgjegjësuere për rolin dhe detyrat e Komisionit të Ndhimës Shtetërore. Komisioni i Ndhimës Shtetërore ka miratuar tetë vendime nga dy të planifikuara për vitin 2020.

OS5 ‘Transparenca e financave publike’ synon rritjen e llogaridhënies dhe transparencës nëpërmjet raportimit më të mirë të performancës financiare dhe jofinanciare, në përputhje me standardet ndërkombëtare. Është bërë ecuri e mirë në këtë drejtim dhe janë përmbushur pothuajse të gjithë vlerat e synuara të treguesve të performancës.

Është bërë ecuri për forcimin e sistemeve dhe kapaciteteve për përgatitjen e statistikave financiare të qeverisë në përputhje me standardet ndërkombëtare. Nga INSTAT në 2020¹ u publikua një dokument i rëndësishëm që synon përmirësimin e zbatimit të parimit të dyanshëm lidhur me harmonizimin mes statistikave në nivel kombëtar dhe harmonizimin me vendet e BE-së. Për shkak të kufizimeve nga Covid-19 nuk u plotësuan tërësisht automatizimi i sistemit të përpilimit të buxhetit qeveritar dhe Tabela 1100 – Për shpenzimet e përgjithshme të qeverisë sipas funksionit, por pritet të përfundojë nga fundi i 2021.

Transparenca fiskale e Shqipërisë u përmirësua lehtë sipas Anketimit për Buxhetin e Hapur (Open Budget Survey) pasi botoi në internet Raportin e Rishikimit Gjashtëmujor. Gjatë 2020 u organizuan seanca trajnime në vendin e punës me drejtuesit e programeve të dy ministrive të linjës me synim përmirësimin e formateve të raportimit vjetor dhe përgjatë vitit. Gjithashtu, SIMFSH-ja u shtri edhe te ministrinë e linjës dhe IB-të dhe të dhënat përkatëse janë hedhur në sistem. Situata nga pandemia dhe puna në distancë e bllokuan edhe më shumë procesin. Njësoj si vitet paraardhëse, u përgatit dhe u publikua Udhëzuesi i Buxhetit për Qytetarët. Për më tepër, u përgatit dhe u zbatua një kalendar për dëgjuesat për buxhetin. OSHC-të u trajnuan online në 2020 për të rritur kapacitetet e tyre për të kuptuar më mirë ciklin buxhetor.

Kalimi gradual në paraqitjen e pasqyrave financiare të qeverisë të bazuara në kontabilitetin në bazë të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara nuk përparoi siç ishte planifikuar. Rishikimi i akteve ligjore në lidhje me kontabilitetin publik dhe vlerësimi për përmirësimin e SIFQ-së për të mundësuar regjistrimin në bazë të detyrimeve dhe të drejtave të konstatuara nuk mund të përfundonte. Plani i zhvillimit të kapaciteteve nuk mund të zbatohet siç ishte synuar. Zhvillimi i planit të zhvillimit të kapaciteteve dhe Strategjisë së Edukimit dhe Trajnimit për Kontabilistët filloi në vitin 2020, por nuk mundi të përfundonte plotësisht siç ishte planifikuar.

Në lidhje me menaxhimin e aktiveve, regjistrimi i tyre në SIFQ vijoi sipas planit. Gjatë vitit 2020 Ministria e Kulturës, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Autoriteti Rrugor Shqiptar kanë hedhur inventarin e aktiveve në modulën e aktiveve. Janë mbajtur disa trajnime lidhur me menaxhimin e aktiveve nga Drejtoria e Procesimit të Biznesit pranë MFE-së për specialistët e financës në këto IB (gjashtë punonjës në total). Version i parë i metodologjisë për njohjen e aktiveve është përgatitur dhe pritet të përfundojë gjatë 2021.

OS6 ‘Kontrolli i brendshëm efektiv’ synon të forcojë disiplinën financiare, kontrollin dhe transparencën, nëpërmjet auditimit të brendshëm dhe menaxhimit financiar dhe kontrollit në nivel qendror dhe vendor.

Për të forcuar më tej sistemin e menaxhimit financiar dhe mjedisin e kontrollit të brendshëm u miratuan dokumente të rëndësishme gjatë 2020: (a) Dokumenti i Politikave për zhvillimin e mëtejshëm të KBFP-së në

¹ Transparenca fiskale e Shqipërisë u përmirësua lehtë sipas

Shqipëri për periudhën 2021–2022, (b) Udhëzim për delegimin e detyrave, dhe (c) Metodologjia për Rishikimin e Kontrollit të Brendshëm të Cilësisë. Dokumenti i Politikave do të shërbejë si një mjet për t'u përdorur nga njësitet publike për menaxhim transparent dhe të përgjegjshëm të fondeve kombëtare dhe të huaja. Qëllimi i udhëzimit të ri është të përcaktojë rregullat dhe procedurat që duhen zbatuar në procesin e delegimit të detyrave. Disa nga aktivitetet e përfshira në planin e veprimit të Dokumentit të Politikave kanë filluar gjatë 2020. U vlerësua statusi aktual i sistemit për menaxhimin e riskut në institucionet e përzgjedhura (MFE, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, DPT). Gjithashtu, është përgatitur programi i trajnimit për zbatimin e kriterëve ligjore të MFK-së si dhe zhvillime të tjera në sistemin e kontrollit të brendshëm në njësitet publike dhe janë diskutuar në Bordin e KBFP-së. Programi do të përdoret për trajnime të ardhshme sipas nevojave dhe kërkesave të institucioneve për ngritje kapacitetesh. Në 2020 u krijuan dhe baza të dhënash të ndara për gjetjet dhe rekomandimet për MFK-në dhe auditimin e brendshëm, të cilat do të ndihmojnë NJQH-në të analizojë dhe të raportojë më mirë problematikat sistematike tek Bordi KBFP-së.

U krijuan më shumë Njësi për Auditimin e Brendshëm (AB) në qeverinë vendore dhe qendrore. Në fund të 2020, 77% e audituesve në detyrë u certifikuan nga Komisioni për Kualifikimin e Auditueve të Brendshëm dhe rreth 12% janë në proces certifikimi. Në janar 2020 u rishikua Manuali i AB-së.

Për të krijuar një funksion efektiv të inspektimit financiar publik, gjatë vitit 2020 u bë një shqyrtim i listës së inspektorëve të jashtëm me qëllim zëvendësimin ose punësimin e inspektorëve të rinj, por për shkak të pandemisë COVID-19 punësimi nuk u realizua.

Në përgjithësi, për OS6 u përmbushën vlerat e synuara të treguesve të rezultateve dhe kjo tregon një përmirësim krahasuar me 2019. Analiza deri në çfarë shkalle janë zbatuar në praktikë sistemet e kontrollit të brendshëm dhe nëse janë rregulluar mekanizmat për llogaridhënien e niveleve drejtuese treguan se institucionet buxhetore morën përkatësisht 2.56 dhe 2.9 pikë nga 4 pikë që tregon edhe përmirësim krahasuar me 2019. Është bërë ecuri e konsiderueshme për harmonizimin e kornizës së auditimit të brendshëm me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm si dhe për krijimin e një funksioni efikas për Inspektimin Financiar Publik.

OS7 'Mbikëqyrje e jashtme efektive e financave publike' synon forcimin e funksionit të mbikëqyrjes së jashtme në përputhje me standardet ONISA (INTOSAI) (Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit) duke rritur kapacitetet e audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit (KLSH) në auditimin financiar dhe të performancës, në mënyrë që të rritet sa më shumë vlera dhe përfitimet e tyre për shoqërinë.

Njësoj si në 2019, edhe në 2020 u arritën të gjitha vlerat e synuara të rezultateve të caktuara për rritjen e efektivitetit të mbikëqyrjes së jashtme të financave publike për të rritur sa më shumë përfitimet në shoqëri.

U përmbushën të gjitha vlerat e synuara për 2020 për harmonizimin e mëtejshëm të auditimit me standardet ndërkombëtare. Së pari, u përgatit plani vjetor i auditimit për 2020 bazuar në metodologjinë e rishikuar "Metodologjia strategjike dhe e planifikimit vjetor të aktivitetit auditues bazuar në risk". Së dyti, personeli i KLSH-së u angazhua për rishikimin dhe ndryshimin e kuadrit rregullator të institucionit, përfshirë manualët për auditimin e përputhshmërisë, financiar dhe të performancës, u ndryshua Rregullorja e Auditit si dhe u përgatit një manual i ri "Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve dhe regjistri institucional i rekomandimeve". Së treti audituesit e KLSH-së, përfshirë të sapoemëruarit janë trajnuar edhe në çështje lidhur me auditimin e fushave që lidhen me pandeminë Covid-19 si dhe masat parandaluese.

KLSH-ja i ka dorëzuar disa raporte Parlamentit si: (a) Raporti për zbatimin e rekomandimeve të auditimit, (b) Raporti Vjetor i Performancës për vitin 2019; dhe (c) Raporti për Zbatimin e Buxhetit 2019.

Në përgjithësi, pavarësisht nga pasojat e tërmetit të nëntorit 2019 dhe pandemisë COVID-19, është bërë progres i mirë në të shtatë Objektivat Specifike. Një përmbledhje e përgjithshme është pasqyruar me anë të shifrave në faqen tjetër.

Përmbledhja e parë tregon statusin e ecursë bazuar në metodologjinë e përdorur në Raportin Vjetor të Monitorimit në 2019 e cila përdor një skemë klasifikimi me tri ngjyra. Përmbledhja e dytë² tregon ecurinë bazuar në metodologjinë zyrtare të monitorimit që ka përdorur Kryeministria, e zbatueshme për monitorimin e të gjitha strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale. Metodologjia në fjalë përmban një skemë klasifikimi me pesë ngjyra.

Jo të gjitha vlerat e synuara u përmbushën për shkak të rrethanave të jashtme. Për më tepër, një sërë risqesh konkrete u identifikuan për komponentët e Strategjisë së Reformës së MFP-së dhe këta risqe ndikuan në zbatimin e aktiviteteve dhe produkteve të planifikuara duke penguar kështu përmbushjen e plotë të disa prej rezultateve të planifikuara për 2020.

Këto risqe përmenden në Pjesën 5 të raportit. Bazuar në zbatimin e 2020 dhe metodologjinë e monitorimit të KM është ndryshuar dhe vlerësimi i riskut.

Pjesa 6 paraqet një përmbledhje të përditësuar të burimeve që janë përdorur për të zbatuar reformën, duke paraqitur të dhënat financiare për shpenzimet gjatë zbatimit të secilit objektiv specifik, përfshirë shumat e fondeve buxhetore të shpenzuara nga qeveria dhe financimet e donatorëve. **Kontributet nga Partnerët për Zhvillim dhe Integritim (PZHI)** ishin të rëndësishme. PZHI-të konsiderohen partner të rëndësishëm në përgatitjen dhe zbatimin e Strategjisë së MFP-së, si edhe kanë financuar rreth 3,38 milionë euro, që korrespondon me rreth 30% të totalit të buxhetit të strategjisë së reformës së MFP-së për vitin 2020.

² Shih shtojcën 2

Raporti i monitorimit MFP 2020

Përmbledhje e arritjeve të rezultateve – Treguesit e performancës

Objektivi Specifik 1	Objektivi Specifik 2	Objektivi Specifik 3	Objektivi Specifik 4	Objektivi Specifik 5	Objektivi Specifik 6	Objektivi Specifik 7
Kuadër fiskal i matur dhe i qëndrueshëm	Planifikim i mirëintegruar dhe efikas	Mobilizimi i të ardhurave	Zbatimi efikas i buxhetit	Transparenca e Financave Publike	Kontroll i brendshëm efektiv	Mbikqyrje e jashtme efektive e financave publike
la) Raporti mes borxhit dhe PBB	Illa) Raporti midis fondeve totale të parashikuara në strategjitë sektoriale dhe fondet totale të identifikuar për sektorët korrespondues brenda PBA-së	VIIa) Baza e tatimit të bizneseve	XIa) Shuma totale e buxhetit që është zbatuar me anë të SIFQ në raport me shumën totale të buxhetit që është zbatuar nga qeveria qendrore	XVa) Përgatitja e llogarive kombëtare të qeverisë sipas metodologjisë ndërkombëtare (ESA 2010)	XXa) Niveli i zbatimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm në praktikë brenda institucioneve buxhetore	XXIIIa) % e rekomandimeve të auditimit të pranuar dhe të zbatuara nga subjektet e audituara
lb) PBB nominale e parashikuar në krahasim me parashikimit të FMN-së World Economic Outlook	IVa) Totali i shpenzimeve të planifikuara për KPBA miratuar në vitin n/total i shpenzimeve të planifikuara në vitin n në buxhetin vjetor	VIIb) % e mbledhjes faktike të tatimeve në vitin N /mbledhja faktike në vitin N-1 -100% (nga tatimet)	XIIa) PEFA 22.1. Stoku i shpenzimeve (detyrimet e prapambetura si përqindje e totalit të shpenzimeve për vitin fiskal)	XVIIa) Vlerësimi nga Ideksi për Buxhetin e Hapur (Pjesëmarrja e Publikut)	XXb) Mekanizmat për llogaridhënien menaxheriale në kuadrin rregullator	XXIIIb) Ndarja e auditimeve financiare (audit financiar i pastër + audit të kombinuar) dhe audit performance
lc) Bilanci primar	IVb) Realizimi faktik i shpenzimeve sipas funksionit (PEFA PI-2, 2.1)	VIIc) Përpjestimi i borxhit të tatimit të mbledhur në vitin N kundrejt shumës së prapambetur të detyrimeve tatimore	XIIb) PEFA 22.2 Monitorimi i detyrimeve të prapambetura të shpenzimeve (në SIFQ)	XVIIIa) Kalimi në fazën ku pasqyrat financiare të qeverisë do të paraqesin kontabilitetin në bazë të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara	XXIa) % e rekomandimeve të zbatuara të auditimit të brendshëm	
ld) Diferenca mes tepriçës/deficitit të synuar të parashikuar në buxhet për vitin buxhetor	Va) Pjesa e projekteve të investimeve publike që janë propozuar bazuar tek prioritetet strategjike të qeverisë (vlera e projekteve për vitin specifik)	VIIIa) Raporti i deklarimeve tatimore kundrejt vitit paraardhës	XIIa) Stoku i borxhit të brendshëm të risistemuar brenda një viti	XIXa) Aktivitet publike të regjistruara në SIFQ	XXIb) Kuadri për auditimin e brendshëm është harmonizuar me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm	
le) Përqindja e devijimit të mbledhjes konkrete është brenda % të përcaktuar/miratuara të vlerësimit buxhetor për të ardhurat tatimore dhe doganore	Vb) Disbursimet aktuale për projektet e mëdha të investimit krahasuar me disbursimet e planifikuara shoqëruar me shpjegimet përkatëse në rastet kur ka devijime	IXa) Numri i ndërtesave të regjistruara dhe të faturuara	XIIb) Maturimi mesatar i borxhit të brendshëm		XXIc) % e rekomandimeve bazë për sistemin që janë adresuar kundrejt numrit total të gjetjeve	
IIa) Raportimi i riskut fiskal (PEFA PI 10)	Vc) Raporti i investimeve të reja publike të dorëzuara në ciklin e PBA kundrejt totalit të investimeve të reja publike të miratuara në një vit	Xa) % e mbledhjes faktike të ardhurave doganore në vitin N /mbledhja faktike e të ardhurave doganore në vitin N-1 -100% (nga doganat)	XIVa) % në vlerë për procedurat e përfunduara me fitues brenda semestrit të parë kundrejt shumës së parashikuar në regjistrin e parashikimeve		XXIIa) % e rekomandimeve të zbatuara të inspektimit financiar (të nxjerra me urdhër të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë)	
	Via) Normat e mbledhjes së tatimeve (RLGRG)	Xb) Koha e përpunimit të deklarave doganore	XIVb) Përqindja e rasteve kur organi i shqyrtimit nuk ka respektuar afatet kohore të shqyrtimit të rastit			
	Vib) Niveli vendor PEFA PI-22.1 Stoku i detyrimeve të prapambetura					

Jeshile: I përmbushur; **Portokalli:** I përmbushur pjesërisht; **E kuqe:** I papërmbushur; **Gri:** Të dhëna të padisponueshme

Shkurtime dhe akronime

AB	Auditimi i brendshëm
AKSHI	Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit (AKSHI)
APP	Agjencia e Prokurimit Publik
AT	Asistencë Teknike
BE	Bashkimi Evropian
BGj	Buxheti me baza gjinore
DAMS	Drejtoria e Analizës Makro-ekonomike dhe Statistikave
DAPB	Drejtoria e Analizës dhe Programimit Buxhetor
DFV	Drejtoria e Financave Vendore
DHAB	Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm
DHMFKK	Drejtoria e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar, Kontrollit dhe Kontabilitetit
DIFP	Drejtoria e Inspektimit Financiar Publik
DMB	Drejtoria e Menaxhimit të Buxhetit
DMIP	Drejtoria për Menaxhimin e Investimeve Publike
DMRMFP	Drejtoria e Menaxhimit të Reformës në fushën e MFP
DPBPKNH	Drejtoria e Përgjithshme e Borxhit Publik dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj
DPD	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
DPT	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
DWH	Data Warehouse
DZhM/ZKM	Departamenti për Zhvillim dhe Mirëqeverisje pranë Zyrës së Kryeministrit
EXBS	Kontrolli i Eksporteve dhe Siguria Kufitare
FMIS	Sistemi i Informacionit të Menaxhimit Financiar
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
FRS	Pasqyrat e Riskut Fiskal
GDTP	Drejtoria e Përgjithshme për Taksën mbi Pronën
GPTH	Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit
DPZHEP	Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit Ekonomik dhe Punësimit
GSP	Grupi Sektorial i Punës
IB	Institucione Buxhetore
IHD	Investime të Huaja të Drejtpërdrejta
INSTAT	Instituti i Statistikave
IPA	Instrumenti i asistencës për para-anëtarësim
IPSAS	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Fushën e Sektorit Publik
KBFP	Kontrolli i Brendshëm Financiar Publik
KD	Komiteti Drejtues
KK	Komitete Koordinuese
KKAB	Komisioni për Kualifikimin e Audituesve të Brendshëm
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
KM	Kryeministria
KPP	Komisioni për Prokurimin Publik
KPS	Komiteti për Planifikimin Strategjik
KT	Komiteti teknik
LluTh	Llogaria Unike e Thesarit
LOB	Ligji Organik për Buxhetin
LPP	Ligji për prokurimin publik
MAS	Marrëveshje e Asocim-Stabilizimit
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
MFP	Menaxhimi i Financave Publike
MIP	Menaxhimi i Investimeve Publike
ML	Ministritë e Linjës

MSFQ	Manuali për Statistikat Financiare Qeveritare
NjRF	Njësia e Riskut Fiskal
NSh	Ndërmarrje shtetërore
OBI	Indeksi për Buxhetin e Hapur
OEA	Operatorët Ekonomik të Autorizuar
OECD	Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
ONISA	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
OShC	Organizatat e Shoqërisë Civile
PBA	Programi Buxhetor Afatmesëm
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
PEFA	Shpenzimet Publike dhe Llogaridhënie Financiare
PFAM	Planifikimi financiar afatmesëm
PPP	Partneriteti publik-privat
PZHI	Partnerët për Zhvillim dhe Integrim
QQ	Qeveria Qendrore
QSh	Qeveria e Shqipërisë
QV	Qeveria Vendore
RA	Rishikimi afatmesëm
RAP	Reforma në administratën publike
SAA	Strategjia Afatmesme për të Ardhurat
SAMB	Strategjia Afatmesme për Menaxhimin e Borxhit
SELI	Sistemi Evropian i Llogarive
SFQ	Statistikat Financiare të Qeverisë
SHKA	Shërbimi i Koordinimit anti-mashttrim
SIFQ	Sistemi Informatik Financiar Qeveritar
SIGMA (MPQM)	Mbështetje për Përmirësimin në Qeverisje dhe Menaxhim
SIMAJ	Sistemi i Informacionit të Menaxhimit të Asistencës së Jashtme
SIMBNJ	Sistemi Informatik i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore
SIMFSH	Sistemi Informatik për Menaxhimin Financiar Shqiptar
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
SMART	Specifik, i matshëm, i arritshëm, realist, i realizueshëm në kohë
SNISA	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditit
SPI	Sistemi i Planifikimit të Integruar
T-bills	Bono thesari
TVSH	Taksa mbi Vlerën e Shtuar
USPB	Udhëzimi Standard për Përgatitjen e Buxhetit
VMIP	Vlerësimi për Menaxhimin e Investimeve Publike

Tabela e Përmbajtjes

1 PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME LIDHUR ME ZBATIMIN E STRATEGJISË 2019-2022	13
1.1 HYRJE	13
1.2 METODOLOGJIA E MONITORIMIT	13
1.3 VIZIBILITETI I MFP-SË DHE KONSULTIMET	14
2. PROGRESI I STRATEGJISË NË VITIN 2020.....	14
2.1 ARRITJET NË ZBATIMIN E OBJEKTIVAVE SPECIFIKE TË STRATEGJISË MFP-SË PËR VITIN 2020.....	14
2.2 NDIKIMI I ZBATIMIT TË STRATEGJISË MFP NË PËRPUTHJE ME AGJENDËN E INTEGRIMIT EVROPIAN	15
2.3 NDIKIMI NË SEKTORIN E ZHVILLIMIT NË RAJON DHE/OSE MË TEJ	16
2.4 KOMPONENTËT E OBJEKTIVAVE SPECIFIKE OSE PRODUKTET QË NUK ECËN SIPAS PLANIT	17
2.5 ZBATIMI I PËRGJITHSHËM I BUXHETIT	18
3 ECURIA NË ZBATIMIN E OBJEKTIVAVE SPECIFIKE TË STRATEGJISË MFP	19
3.1 ECURIA PËR OBJEKTIVIN SPECIFIK 1	19
3.2 ECURIA PËR OBJEKTIVIN SPECIFIK 2	21
3.3 ECURIA PËR OBJEKTIVIN SPECIFIK 3	26
3.4 ECURIA PËR OBJEKTIVIN SPECIFIK 4.....	30
3.5 ECURIA PËR OBJEKTIVIN SPECIFIK 5	35
3.6 ECURIA PËR OBJEKTIVIN SPECIFIK 6	39
3.7 ECURIA PËR OBJEKTIVIN SPECIFIK 7	43
4. PERFORMANCA E KATEGORIZUAR NGA STANDARDET	46
5. RISQET DHE HAPAT PËR T’I TRAJTUAR	48
6. KOSTOJA E STRATEGJISË MFP	50
7. KONKLuzionet dhe rekomandimet	51
SHTOJCA 1: STATUSI I PRODUKTEVE PËR 2020	52
SHTOJCA 2: PËRMBLEDHJE E ARRITJEVE TË REZULTATEVE – TREGUESIT E PERFORMANCËS – METODOLOGJIA SIPAS ZKM	65

1 Përmbledhje e përgjithshme lidhur me zbatimin e Strategjisë 2019-2022

1.1 Hyrje

Ky është Raporti i gjashtë Vjetor i Monitorimit mbi Zbatimin e Menaxhimit të Financave Publike që mbulon periudhën 1 janar 2020 deri më 31 dhjetor 2020. Raporti mbulon një vit të reformës në fjalë dhe përmban informacion të hollësishëm lidhur me Komitetet Drejtuese dhe Komitetet Teknike të MFP-së sa i takon ecurisë së kryer dhe sfidave që janë ndeshur në përmbushjen e objektivave dhe rezultateve të MFP-së.

Gjatë vitit 2020, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE) dhe qeveria e Shqipërisë rishikuan disa nga vlerat e synuara të treguesve të performancës për Objektivat Specifike dhe produktet përkatëse në mënyrë që të pasqyroheshin pasojat negative që pati tërmeti i nëntorit 2019 dhe pandemia Covid-19 në përmbushjen e rezultateve. Procesin e ndryshimeve e udhëhoqi Drejtoria e MFP-së me mbështetjen e Asistencës Teknike të BE-së. U konsultuan të gjithë aktorët e përfshirë. Megjithatë ndryshimet janë reflektuar dhe në logframe të Strategjisë themeli mbetet i njëjtë sikurse dhe objektivat e përgjithshme dhe ato specifike.

Raporti në fjalë përmban një vlerësim të kriterëve klasifikues të PFM-së në mënyrë që BE-ja të lëvrojë mbështetje buxhetore për Shqipërinë. Kriteret kualifikuese të MFP-së parashikojnë ekzistencën e një programi të besueshëm dhe të rëndësishëm për të përmirësuar menaxhimin financiar publik si dhe progres të kënaqshëm të zbatimit të programit. Sipas vetëvlerësimit të vetë MFP-së progresi ka qenë në përgjithësi i kënaqshëm.

Qeveria ka bërë progres të mirë për zbatimin e Strategjisë së Reformës në Menaxhimin e Financave Publike. Zhvillimi për secilën Objektiv Strategjik përshkruhet në pjesën vijuese.

1.2 Metodologjia e monitorimit

Procesi i përgatitjes së raportit të monitorimit filloi më 23 mars 2021 me një kërkesë që u nisi Drejtoria e MFP-së të gjithë koordinatorëve të OS-ve të cilët janë struktura përgjegjëse për zbatimin e Strategjisë kundrejt planit të veprimit të kostuar, performancës kundrejt vlerave të synuara, vonesave apo për ndryshimeve, si edhe identifikimin dhe zbutjen e risqeve. Raporti është përgatitur bazuar në udhëzimin e ri të monitorimit të miratuar nga Komiteti Drejtues nr. 11 i datës 7 prill 2020, dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 290, datë 11.4.2020, “Për krijimin e bazës së dhënave shtetërore për Sistemin e Integruar të Planifikimit Informatik (SIPI/IPSIS)”.

Gjatë përgatitjes së raportit, Drejtoria e MFP-së mbajti komunikim me përfaqësuesit e strukturave të përfshira në MFP për të paraqitur mirë dhe qartë arritjet dhe vështirësitë e ndeshura gjatë periudhës së raportimit. Pas një procesi intensiv, MFE-ja hartoi raportin vjetor të monitorimit për vitin në fjalë të cilin e diskutoi në takimin e Komitetit Teknik me të gjitha palët e përfshira në MFP. Versioni përfundimtar u prezantua në Komitetin Drejtues që e drejtoi ministria e MFE-së ku morën pjesë përfaqësues të institucioneve dhe drejtorive brenda MFE-së përfshirë në Strategjinë e MFP-së si dhe anëtarë të tjerë të KD. Gjithashtu, Partnerët për Zhvillim dhe Organizatat e Shoqërive Civile morën pjesë. Komentet dhe sugjerimet u diskutuan dhe u pasqyruan në raport, versioni përfundimtar i të cilit, së bashku me paketën e plotë të dokumenteve u dërgua në Drejtorinë për Zhvillim dhe Mirëqeverisje. Në kuadër të transparencës dhe komunikimit me publikun, MFE-ja publikon çdo vit në faqen e vet zyrtare³ raportin vjetor të monitorimit në shqip dhe në anglisht.

³ <https://www.financa.gov.al/raportet-e-monitorimit-2/>

1.3 Vizibiliteti i MFP-së dhe konsultimet

Strategjia për reformën e MFP-së shërben si kornizë për dialogun strategjik për të gjithë donatorët dhe aktorët e shoqërisë civile në këtë sektor. Në 2020 u mbajtën dy Komitetet Drejtuese të MFP-së (KD) dhe tre Komitetet Teknike (KT) si dhe u morën vendime të rëndësishme për të mundësuar zbatimin pa problem të MFP-së, të tilla si pasaporta e treguesve e Strategjisë MFP, termat e referencës të gjithë strukturave drejtuese të Strategjisë si dhe përgatitja e një udhëzimi të thjeshtuar për raportin vjetor të monitorimit. Gjithashtu, gjatë 2020, Drejtoria e MFP-së drejtoi procesin e ndryshimit të disa vlerave të synuara të treguesve të Objektivave Specifike dhe produkteve përkatëse për të reflektuar pasojat negative nga tërmetit të muajit nëntor 2019 si dhe të pandemisë Covid-19 në përmbushjen e rezultateve. Të gjitha takimet e KD-së kishin marrë pjesë nga qeveria e Shqipërisë, palët e interesit të MFP-së si dhe donatorë/partnerë për zhvillim dhe organizatat e shoqërisë civile. Gjithashtu, projekt raporti dhe të gjitha materialet përkatëse u shpërndanë për konsultim paraprakisht.

2. PROGRESI I STRATEGJISË NË VITIN 2020

2.1 Arritjet në zbatimin e Objektivave Specifike të Strategjisë MFP-së për vitin 2020

Pavarësisht pasojave nga tërmeti i nëntorit 2019 dhe pandemisë nga Covid-19 është bërë ecuri e mirë në shumicën prej shtatë Objektivave Specifike. Objektiv i Specifike 4 nuk pati shumë ecuri lidhur me zbatimin e buxhetit të shtetit pasi u ndikua shumë nga ndodhitë e jashtme.

Ecuria në OS1 ‘Kuatër fiskal i matur dhe i qëndrueshëm’ ishte relativisht e mirë; vetëm 1 tregues rezultati lidhur me devijimin e mbledhjes faktike në % të parashikimit buxhetor të miratuar të të ardhurave tatimore dhe doganore u përmbush pjesërisht. Për OS2 ‘Planifikim i mirëintegruar dhe efikas’ u përmbushën pesë tregues rezultati, ndërsa dy tregues rezultati (lidhur me disbursimin e projekteve madhore të investimit dhe detyrimet e prapambetura të qeverisë vendore) nuk u përmbushën ndërsa për një tregues rezultati (lidhur me financimin e parashikuar në strategjitë sektoriale dhe financimi total i identifikuar për sektorët përkatës në PBA) janë të vështira të mblidhen të dhënat për të dalë në një përfundim objektiv. Gjithashtu për OS3 ‘Mbledhja e të ardhurave’ u realizuan pesë objektiva ndërsa dy nuk u përmbushën (lidhur me numrin e ndërtesave të regjistruara dhe të faturuara dhe rritja në mbledhjen e të ardhurave doganore). Viti pandemik 2020 qe tepër i vështirë për zbatimin e buxhetit të qeverisë. Vetëm katër nga treguesit e rezultatit të OS4 ‘Zbatim efikas i buxhetit’ u zbatuan, një u përmbush pjesërisht ndërsa dy nuk u përmbushën:


- Pjesa totale e buxhetit ekzekutuar përmes SIFQ-së në raport me totalin e buxhetit të zbatuar nga qeveria;
- Përqindja në vlerë e procedurave të përfunduara me fitues brenda tremujorit të parë kundrejt totalit të fondeve të parashikuar në regjistrin e parashikimeve;
- Përqindja e rasteve kur organi shqyrtimit tejkalon afatet ligjore të përpunimit të rasteve.

Për OS5 ‘Transparenca e financave publike’ nuk u përmbush vetëm vlera e synuar e treguesit të rezultatit lidhur me tranzicionin gradual në paraqitjen e kontabilitetit në bazë të detyrimeve dhe drejtave të konstatuara ndërsa vlerat e synuara për tri treguesit e rezultatit të tjerë u realizuan. Për OS6 ‘Kontrolli brendshëm efektiv’ u përmbushën vlerat e synuara për gjashtë treguesit e rezultateve ndërsa për OS7 ‘Mbikëqyrje efektive e financave publike’ u përmbushën vlerat e synuara për të dy treguesit e rezultateve.

Grafiku më poshtë paraqet një përmbledhje të arritjeve për shtatë objektivat specifike.

U përmbushën 75% e vlerave të synuara të rezultateve, 17.5% nuk u përmbushën dhe 5% u përmbushën pjesërisht. Për 2.5% të dhënat e pamjaftueshme nuk mjaftonin për të dalë në një konkluzion. OS6 dhe OS7 përmbushën të gjitha vlerat e synuara të objektivave (100%). OS1, OS2, OS3 dhe OS5 përparuan nga mirë në nivel të kënaqshëm ku përkatësisht përmbushën 83%, 63%, 71% dhe 75% të vlerave të synuara të objektivave të rezultateve. Ndërsa për OS4 vetëm 57% e vlerave të synuara të rezultateve u përmbushën.

Në përgjithësi grafiku më poshtë paraqet një përmbledhje të arritjeve mesatar për secilin objektiv.



2.2 Ndikimi i zbatimit të Strategjisë MFP në përputhje me agjendën e integritetit evropian

Reforma për menaxhimin e financave publike mbetet përparësi për qeverinë shqiptare jo vetëm si parakusht për anëtarësimin në Bashkimin Evropian (sipas reformës së administratës publike) por synon edhe mbështetjen e zhvillimit të një ekonomie më të mirë që ofron shërbim më të mirë për shtetasit e saj. Ecuria e kënaqshme në zbatimin e reformave për përmirësimin e menaxhimit financiar publik përfshirë mbledhjen e të ardhurave kombëtare dhe vazhdimi i rëndësisë dhe besueshmërisë së programit të reformave është një nga kushtet kryesore për lëvrimin e kësteve të mbështetjeve buxhetore.

Rrugëtimi i zhvillimit ekonomik dhe social të Shqipërisë dhe perspektiva e harmonizimit të saj me standardet evropiane nuk është një proces i lehtë. Ai kërkon vizion, ide të qarta dhe kurajë nga ana e shtetit, institucioneve dhe faktorëve të tjerë të rëndësishëm social. Në këtë drejtim, Strategjia e Menaxhimit të Financave Publike 2019-2022, trajton një sërë sfidash që Shqipëria duhet të përballojë në rrugën e saj drejt Bashkimit Evropian. Për më tepër, progresi i MFP-së është pjesë e disa raporteve të monitorimit dhe vlerësimit si: Raporti i Grupit Special të RAP-it dhe Raporti i Progresit të BE-së për Shqipërinë.

Lidhur me GS PAR BE-Shqipëri, ai shërben si një platformë për të nxitur procesin e reformës së administratës publike. Qeveria e Shqipërisë përgatit raporte periodike për ndjekjen e konkluzioneve të GS PAR çdo vit në takimet vjetore nxirren konkluzione për fushat që kanë nevojë për përmirësim. Në takimin e 9-të të PAR GS që u mbajt në 2020 u raportua zbatimi i konkluzioneve të MFP-së, konkretisht për vendet ende të lira, sidomos funksionet kryesore në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë; akumulimin e

detyrimeve të prapambetura si në nivel vendor dhe qendror; vendimmarrja dhe procesi i menaxhimit për investimet publike; mbledhja e të ardhurave në vend dhe aktet nënligjore të ligjit për financat vendore.

Në raportin e BE-së për Shqipërinë për vitin 2020⁴, gjetjet kryesore paraqiten në kutinë më poshtë.

“...Më shumë vëmendje është tashmë në shlyerjen dhe parandalimin e detyrimeve të prapambetura, uljen e borxhit publik, zgjerimin e menaxhimit të risqeve fiskale për të përfshirë dhe NSH-të, detyrimet e prapambetura dhe risqet që vijnë nga kontratat PPP dhe të koncesioneve...
... Megjithatë duhen rishikuar shifrat nga të ardhurat dhe rritja ekonomike. Ligji për koncesionet dhe partneritetin publik-privat u ndryshua për të ulur fushëveprimin e ofertave të parëndësishme dhe për të forcuar rolin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomikë në vlerësimin dhe miratimin e kontratave dhe shtyrjeve PPP. Mbledhja e të dhënave për përgatitjen e një strategjie afatmesme për të ardhura është në vazhdimësi në kuadër dhe të ndryshimeve për shkak të Covid-19 ...”

MFE-ja prezanton progresin e Strategjisë MFP në pjesën e reformës së administratës publike në Raport Progresin 2020 për Shqipërinë. Masat janë propozuar dhe zbatuar nga njësitë përkatëse për të trajtuar rekomandimet e BE-së. Më tej, njësitë përgjegjëse të MFP-së raportuan së 14 nga 24 komponentë të reformës MFP e paraqesin ecurinë e tyre në kapitujt e PKIE. Ndërsa 8 nga 14 komponentë janë përmbushur pjesërisht gjatë 2020, dhe 6 nga 14 janë përmbushur plotësisht. Për secilin nga kapitujt janë dhënë rekomandimet përkatëse dhe janë marrë masat e nevojshme për t'i trajtuar.

2.3 Ndikimi në sektorin e zhvillimit në rajon dhe/ose më tej

Në këtë pjesë paraqitet një analizë krahasimore mes vendeve të Ballkanit Perëndimor me fokus në fushën e financave publike dhe në performancën ekonomike që është arritur përmes reformave në vazhdimësi. Sipas studimeve të ndryshme të kryera në gjashtë vendet e BP-së (Shqipëri, Kosovë, Bosnje dhe Hercegovina, Serbi, Mal i Zi dhe Maqedoninë e Veriut) tregohet se janë pothuajse në të njëjtat faza lidhur me zbatimin e reformës së MFP-së. Është veçanërisht me rëndësi raporti për Ballkanin Perëndimor “Raporti për Ekonominë në Ballkanin Perëndimor nr.18 “Një rimëkëmbje e pasigurt” ku paraqitet një pikëpamje e përgjithshme e treguesve kryesorë të financave publike dhe ndikimi i pandemisë në këto ekonomi. Tabela më poshtë paraqet pamjen e përgjithshme fiskale në vendet e Ballkanit Perëndimor për vitin 2019 dhe vlerësimin për 2020.

Tabela 1: Treguesit fiskal në vendet e Ballkanit Perëndimor 2019, 2020⁵

Indicator	Real GDP growth (percent)		Public debt (percent of GDP)		Fiscal balance (percent of GDP)		Public Expenditures (percent of GDP)		Public revenues (percent of GDP)	
	2019	2020	2019	2020	2019	2020	2019	2020	2019	2020
Albania	2.2	-8.4	63.5	76.2	-1.9	-8.5	29.3	35.1	27.4	26.6
Bosnia and Hercegovina	2.6	-3.2	33.1	38	1.9	-4.2	41.5	46.6	43.3	42.3
Kosovo	4.2	-8.8	17	22.6	-2.9	-9.5	29.5	34.5	26.7	25.1
North Macedonia	3.6	-4.1	40.2	50.8	-2.1	-6.1	33.3	35	31.2	28.9
Montenegro	4.1	-12.4	76.5	92.9	-3	-11.7	46.2	53	43.3	41.3
Serbia	4.2	-3	49.7	55.3	-0.2	-7.6	42.3	47	42.1	39.4

Burimi i informacionit: Banka Botërore (2021)

Recesioni ka qenë shumë i rëndë sidomos në Malin e Zi, Shqipëri dhe Kosovë për shkak të mbështetjes së tyre tek turizmi dhe është sektori dhe më i ndikuar nga kriza Covid-19. Siç shihet:

⁴ https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/albania_report_2020.pdf


⁵ 2020 janë vlera ta parashikuara

- Shqipëria duket në pozicion më të keq në 2019 *se rritja faktike* e PBB-së është më e ulëta në BP për shkak të pasojave të tërmetit. Por kur filloi rindërtimi pandemia botërore nga Covid-19 detyroi sektorët më të mëdhenj të ekonomisë të izolohehin dhe situata ekonomike u përkeqësua. Sidoqoftë duke pasur parasysh parashikimin për vitin 2020, Shqipëria duket më mirë se Mali i Zi dhe Kosova, megjithëse është nën mesataren e BP6. Prodhimi i Brendshëm Bruto në Ballkanin Perëndimor është parashikuar të rritet me 4,8 për qind në 2020, ndërsa për Shqipërinë produkti është parashikuar të ulet me 8,4 %.
- Një tregues tjetër i rëndësishëm i cili është ndikuar shumë nga efektet e pandemisë është *borxhi publik*, nëse krahasojmë vlerësimet midis vendeve, vihet re se Shqipëria është vendi i dytë nga BB6 me borxhin më të lartë publik në përqindje të PBB-së, pas Malit të Zi.
- *Shpenzimet publike* në kuadër të PBB-së janë rritur në Shqipëri, si dhe në vende të tjera.
- *Të ardhurat publike* kanë pësuar rënie jo vetëm në Shqipëri, por në përgjithësi në rajon, megjithatë Shqipëria pozicionohet në nivelet e poshtme. Duke marrë parasysh vlerësimin për vitin 2020, Shqipëria është vendi i dytë me të ardhurat publike më të ulëta pas Kosovës.


2.4 Komponentët e Objektivave Specifike ose produktet që nuk ecën sipas planit

Siç u përmend në pjesën 1.2.1, OS4 ishte dhe komponenti që u ndikua më shumë nga dukuritë e jashtme. Gjithashtu për disa Objektiva Specifike ndodhitë e jashtme ndikuan realizimin e objektivave të rezultateve. Megjithatë në nivel produkti– që mat dhe lidhjen më të drejtpërdrejtë mes aktiviteteve dhe produkteve, shumica e produkteve (62%) u përmbushën, megjithëse performanca e produkteve luhatej mes Objektivave Specifike të ndryshme.

Grafiku më poshtë paraqet një panoramë të produkteve të planifikuara për shtatë objektivat specifike.



Për OS6 dhe OS7 të gjitha produktet u përmbushën plotësisht; dhe për OS1 67% e produkteve u përmbushën plotësisht ndërsa 33% vetëm pjesërisht. Për OS2 dhe OS5 përqindja e produkteve që u përmbushën plotësisht ishte përkatësisht 59%, 50%, 62% dhe 50% dhe mund të shihet në grafikun më poshtë. Faktorë të ndryshëm që ndikuan në zbatimin e produkteve përshkruhet në seksionin 1.3 më poshtë.



2.5 Zbatimi i përgjithshëm i buxhetit

Shumica e reformave të përfshira në këtë strategji janë reforma politike. Puna për formalizimin e këtyre reformave bazuar në legjislacion të ri dhe/ose të ndryshuar si dhe në rregullore zakonisht nuk ka kërkuar burime financiare shtesë. Personeli ekzistues i institucioneve të përfshira në zbatimin e reformave ka ndërmarrë hapat e nevojshëm për realizimin e rezultateve të dëshiruara. Plani i Veprimit i kostuar 2019-2022 përcakton që kostoja gjithsej për zbatimin e aktiviteteve është 83 milionë Euro nga të cilat 57,8 milionë Euro do të mbulohen nga buxheti i shtetit dhe 25,6 milionë Euro nga partnerët ndërkombëtarë për zhvillim. Gjatë 2020 burimet e përdorura për zbatimin e reformës ishin 77% e buxhetit të planifikuar ose 11,2 milionë Euro nga 14,6 milionë EURO (7,8 milionë Euro ishin nga buxheti i shtetit ndërsa 3,3 milionë Euro nga PNZH). Me zbatimin e IPSIS-it besohet se do të nxirret një panoramë e plotë e kostove të planit të veprimit, pasi do të ketë një lidhje më të mirë mes Strategjisë dhe PBA-së, kështu që buxheti i shpenzuar gjatë zbatimit të planit të veprimit do të nxirret lehtësisht. Gjatë 2020, MFE-ja ka marrë financim dhe/ose asistencë të drejtpërdrejtë nga partnerët e jashtëm për zhvillim për të mbuluar shpenzimet lidhur me zbatimin e sistemit dhe ngritjen e kapaciteteve.

Gjatë përgatitjes së Planit të Veprimit të rishikuar të Strategjisë së MFP-së 2019-2022 ishte parashikuar një hendek financimi prej 8,9 milionë EURO për të gjithë periudhën e zbatimit të tij. Megjithatë, siç përmendet edhe në dokumentin kryesor të Strategjisë së MFP-së, qeveria mbetet e përkushtuar për të siguruar hendekun financiar për të mundësuar zbatimin e aktiviteteve të reformës, siç dhe ndodhi në 2020 ku disa aktivitete që nuk ishin planifikuar fillimisht të mbuloheshin nga buxheti i qeverisë ose donatorët janë kryer nga stafi i IB-

ve të përfshirë në zbatim. Më shumë lidhur me burimet e përdorura për zbatimin e reformës gjenden në Kapitullin 6 të këtij raporti.

3 Ecuria në zbatimin e Objektivave Specifike të Strategjisë MFP

Detajet konkrete mbi zhvillimin e secilit Objektiv Specifik janë të përshkruara në pjesët më poshtë.

3.1 Ecuria për Objektivin Specifik 1

Në legjislacion u përfshinë dispozita për të trajtuar parashikimet tepër optimiste. Dispozitat përfshinin borxhin, deficitin dhe rregullat e bilancit primar aktuale me qëllim uljen e normës së borxhit ndaj PBB-së në nivele të qëndrueshme. Krahasuar me vitin 2015, raporti i borxhit ndaj PBB-së tregoi një tendencë në rënie përgjatë periudhës 2015-2019, ndërsa në vitin 2020 raporti u rrit me 76.1%. Qeveria mori masa të menjëhershme për t'iu përgjigjur dëmtimeve nga tërmeti/procesit të rindërtimit dhe për të mbajtur në kontroll pasojat nga pandemia Covid-19, të cilat rritën në mënyrë domethënëse shpenzimet, çka solli deficit buxhetor më të lartë në planin afatshkurtër dhe nivel më të lartë të borxhit kombëtar. Parashikimet e PBB-së nominale ishin më të matshme dhe më të ulëta se parashikimet përkatëse të PBB-së nominale në World Economic Outlook të FMN-së për periudhën 2016-2020. Sidoqoftë, pesë vitet e fundit e sidomos në vitin 2020, proceset e planifikimit dhe të buxhetimit u dëmtuan nga parashikimet sistematike tejte optimiste dhe projeksionet tatimore. Drejtoria e Përgjithshme e Politikave Makroekonomike dhe Çështjeve Fiskale krijoi një sektor të ri për analizën dhe statistikën për përmirësimin e aftësive parashikuese. Vetëm gjysma e vendeve të lira të punës u plotësuan në vitin 2020. U krijua Njësia e Riskut Fiskal (NJRF) në MFE përgjegjëse për analizën, monitorimin dhe raportimin e risqeve fiskale. Deklarata e parë e Risqeve Fiskale u publikua bashkë me buxhetin vjetor të vitit 2019. Gjatë 2019-ës filloi puna për të thelluar dhe zgjeruar mbulimin e Deklaratës së Risqeve Fiskale duke e shtrirë analizën në një gamë më të gjerë risqesh, ku përfshihen ndërmarrjet shtetërore, detyrimet e prapambetura si dhe kontratat PPP. Në vitin 2020, NJRF-ja monitoroi çdo muaj performancën financiare dhe jofinanciare të të gjitha kontratave të koncesioneve/PPP-ve me mbështetje buxhetore. Në maj të vitit 2020, u publikua për herë të parë Raporti Përmbledhës Vjetor për 2019 që përmbante informacion financiar dhe jofinanciar për PPP-të aktive.

Në përgjithësi, 83% e vlerave të synuara të treguesve të rezultateve që synojnë të zhvillojnë një kuadër makrofiskal afatmesëm të besueshëm që mbështet përgatitjen e PBA-së u përmbushën në 2020 dhe 17% prej tyre u përmbushën pjesërisht çka tregon përmirësim krahasuar me vitin 2019 (67% e vlerave të synuara të treguesve të rezultatit u përmbushën ndërsa 33% u përmbushën pjesërisht). Krahasuar me vitin 2019, dy vlera të synuara të treguesve të performancës u përmirësuan në vitin 2020: “Bilanci primar” dhe “% e devijimit e arkëtimit faktik”. Tabela më poshtë rendit vlerat e synuara për performancën e treguesve për vitin 2020 për secilin rezultat (nëse statusi i vlerës së synuar është *me të kuqe* – nuk është përmbushur: nëse është *portokalli* – është përmbushur pjesërisht; nëse është jeshile - është përmbushur).

Tabela 1: Rezultatet kyçe dhe treguesit e performancës

Rezultati	Treguesi i Performancës	Institucioni Drejtues	Niveli bazë (2018)	Vlerë faktike FY 2019	Objektivi i Synuar FY20	Vlerë faktike FY20	Objektivi i Synuar FY 2021
I) Rritja e besueshmërisë së kuadrit fiskal	Ia) Raporti mes borxhit dhe PBB	GDMPPFA	68%	66,3%	79,9% *	76,1%	< FY 20
	Ib) PBB nominale e parashikuar në krahasim me parashikimet të FMN-së World Economic Outlook	GDMPPFA	-5.9 billion ALL	-16.5billion ALL	< 0	ALL -0.2 billion	< 0
	Ic) Bilanci primar	GDMPPFA	+0.5%	0,20%	-4,90%	-4,7%	> FY20
	Id) Diferenca mes tepricës/deficitit të synuar të parashikuar në buxhet për vitin buxhetor	GDMPPFA	-18%	-4%	≤ deficitit i planifikuar	-17,0%	≤ deficitit i planifikuar
	Ie) Përqindja e devijimit të mbledhjes konkrete është brenda % të përcaktuar/miratuar të vlerësimit buxhetor për të ardhurat tatimore dhe doganore	GDMPPFA	-1.4%	-3,50%	-16,50%	-16,80%	> -5%
II) Identifikimi dhe frenimi i risqeve fiskale më efektivisht	IIa) Raportimi i riskut fiskal (PEFA PI 10)	GDMPPFA	C (2017)	B+	B	B	B

Ecuria e arritur në vitin 2020

Komponenti 1.1: Rregullat fiskale dhe parashikimi

Puna për forcimin e rregullave fiskale ka ecur më mirë nga sa ishte parashikuar gjatë rishikimit të Strategjisë. Ndryshimet në Ligjin Organik të Buxhetit (LOB) ku janë shtuar rregulla të reja fiskale, të planifikuara për vitin 2022 u morën në korrik të vitit 2020. Rregulli i ri kishte të bënte me bilancin primar, që duke filluar nga viti 2023 nuk mund të jetë më negativ (pra duhet të jetë ose i balancuar ose të tregojë tepricë pozitive). Rregulli i ri konsiderohet një tregues thelbësor për qëndrueshmërinë afatgjatë të financave publike dhe është në përputhje me rekomandimet e KE-së dhe me parimet kryesore të legjislacionit të BE-së. Gjatë 2020 DPPMCF-së ka rritur kapacitetet ekzistuese të stafit.

Komponenti 1.2: Menaxhimi i riskut fiskal

Janë bërë disa përmirësime sidomos sa i takon forcimit të monitorimit të risqeve kryesore fiskale, të tilla si ato që lidhen me NSH-të, detyrimet e prapambetura dhe kontigjencat, dhe pagesat buxhetore për kontratat PPP. Gjatë gjysmës së parë të vitit 2020, monitorimi i NSH-ve është zgjeruar ku është përfshirë për herë të parë dhe ndërmarrja e sektorit të ujit. Me mbështetjen e Bankës Botërore është përgatitur raporti i monitorimit lidhur me ndërmarrjet shtetërore (NSH) në sektorin e ujit i cili do të shërbejë dhe si bazë për analizat e ardhshme të risqeve fiskale që duhen përfshirë në Deklaratën e Riskut Fiskal. Në kuadër të reformës në sektorin e energjisë, është thelluar raporti i monitorimit për këtë sektor. Në dhjetor 2020 u përfundua me sukses plani i masave për uljen e detyrimeve të prapambetura në sektorin e energjisë elektrike. Gjatë vitit të pandemisë në 2020, NJRF-ja ka monitoruar nga afër PPP-të që janë me mbështetje buxhetore, të cilët ishin disa herë objekt i shkurtimeve buxhetore, për të krijuar hapësirë për masat kundër Covid-it. Në këtë drejtim NJRF/MFE ka monitoruar nga afër këto kontrata, duke ndërmarrë më tej veprime dhe duke rinegociuar disa kontrata koncesionare, kryesisht për të shtyrë afatet e pagesës së tyre, me synim final lehtësimin e barrës buxhetore për vitin e vështirë 2020, por edhe për vitin 2021. Detyrimet kontingjente nga ana tjetër mbeten me rëndësi, kështu që NJRF-ja po monitoron dhe raporton vazhdimisht detyrimet financiare që rrjedhin nga vendimet e gjykatave të Strasburgut dhe rastet e arbitrazhit.


Është krijuar organizimi institucional për matjen efektive dhe menaxhimin e detyrimeve të prapambetura. Së pari, u krijua Grupi i Punës për detyrimet e prapambetura për monitorimin e detyrimeve të prapambetura të subjekteve të qeverisë së përgjithshme me Urdhër të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, datë 21 korrik 2020. Grupi i punës ka gjashtë anëtarë dhe udhëhiqet nga Sekretari i Përgjithshëm i MFE-së dhe do të përmirësojë koordinimin brenda Ministrisë së Financave dhe do të parandalojë grumbullimin e detyrimeve të reja. Së dyti, në tetor 2020 doli një udhëzim⁶ që detyron IB-të dhe institucionet e varësisë të regjistrojnë detyrimet e prapambetura në SIFQ. Duke filluar nga janari i vitit 2021, do të përgatiten raportet automatike që përmbajnë informacion mbi natyrën e detyrimeve të prapambetura dhe

⁶ Udhëzimi i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.37, datë 06.10.2020 botuar në linkun e mëposhtëm <https://www.financa.gov.al/procedura-operacionale/>

bilancin e mbetur për çdo institucion dhe sipas udhëzimit të ri NJRF-ja është përgjegjësi për të raportuar rreth tyre sipas raporteve në SIFQ.

Përmbledhje e ecurisë së vlerave të synuara të produkteve për Objektivin Specifik 1

Grafiku 1: Statusi i vlerave të synuara të produkteve për vitin 2020



Risqet kyçe

Forcimi i përgjithshëm i NJRF-së me staf si nxitje për ndryshim duhet të pranohet përgjithësisht nga nivelet më të larta drejtuese.

3.2 Ecuria për Objektivin Specifik 2

Qeveria miratoi SKZHI-II (2015-2020), që krahas strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale, masterplaneve dhe planeve të veprimit formojnë kuadrin për zhvillimin gjithëpërfshirës strategjik të vendit. Pas katër vitesh zbatim u krye rishikimi afatmesëm i SKZHI-II dhe raporti përfundoi në 2020. Departamenti për Zhvillim dhe Mirëqeverisje pranë Zyrës së Kryeministrit (DZHM/ZKM) përfundoi zbatimin e sistemit të automatizuar gjithëpërfshirës për forcimin e Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI) që lidh planifikimin strategjik me planifikimin e buxhetit. Megjithatë nuk mund të përfundohej ndihma juridike për funksionimin e IPSIS-it deri në fund të 2020 siç ishte planifikuar, u miratua Vendimi i Këshillit të Ministrave dhe udhëzimi për treguesit e performancës dhe monitorimin për të ndihmuar me procesin e zbatimit. Në korrik 2020, Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit (AKSHI) akordoi operacionalizimin dhe gatishmërinë e IPSIS-it për të filluar funksionimin dhe u bënë shumë aktivitete trajnuese.

Ndryshimet në Ligjin Organik të Buxhetit (LOB) në 2016 fuqizuan parlamentin të votonte dhe të miratonte tavanet e PBA-së në nivel programi dhe për t'i bërë detyruese për periudhën trivjeçare. Gjithashtu, u miratua Udhëzimi Standard i rishikuar për Përgatitjen e Buxhetit (USPB) për të reflektuar praktikatat më të mirë ndërkombëtare në fillim të 2018, dhe këshillimi i zgjeruar dhe rishikimi i zbatimit të tij në të gjitha njësitë e qeverisë qendrore u krye midis 2019 dhe 2020. Rishikimi tregoi se ka ende hendeqe dhe mospërputhshmëri në zbatimin e udhëzuesit nëpër sektorët e ndryshëm. Gjithashtu, moduli i ri i PBA-së i zhvilluar si shtesë e SIFQ-së ekzistuese u përfundua dhe u shtri në të gjitha ministratë e linjës. Për të shqyrtuar si duhet dhe për të

financuar nismat për politika të reja, Komiteti për Planifikimin Strategjik miratoi Dokumentin e Politikave Prioritare në mars dhe korrik të vitit 2020 në dy takime të veçanta dhe për politikat e reja u vendos para përfshirjes së tyre në PBA.

Lidhur me investimet publike, Këshilli i Ministrave⁷ aprovoi një procedurë të re në vitin 2018 që synonte krijimin e kriterëve të reja për priorizimin dhe vlerësimin e projekteve të mëdha të investimit kapital. Gjatë viteve 2019 dhe 2020 Drejtoria për Investimet Publike dhe KM-ja ofruan shumë trajnime lidhur me propozimet për investime publike që duhen dorëzuar për miratim dhe për modulet e reja të MIP-it më SIMFSH. Sa i takon PPP-ve pati ndryshime të rëndësishme ligjore që nga 2016 kur dispozitat e LOB-it vendosën kufizime vjetore për koncesionet dhe PPP-të. Gjithashtu, u ndryshua ligji për PPP-të në vitet 2014, 2015 dhe 2019 me qëllim krijimin e stimuljeve për disa sektore të reja të ekonomisë dhe për ndalimin e propozimeve të panevojshme. Së fundi, ndryshime të tjera rregullatore për monitorimin e PPP-ve dhe koncesioneve rritën ndjeshëm numrin e kontratave nën shqyrtim nga Drejtoria e Koncesioneve krahasuar me vitin 2018. Raporti vjetor për vitin 2019 me informacionin financiar dhe jofinanciar për të gjitha PPP-të aktive u publikua për herë të parë. Lista e Unifikuar e Projekteve për të gjitha projektet, pavarësisht burimit të informacionit, u miratua nga Komiteti i Planifikimit Strategjik në vitin 2020.

Përsa i përket MFP-së në pushtetin vendor (QV), janë arritur arritje të rëndësishme në kuadrin rregullator, si miratimi i ligjit “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit “Për financat e vetëqeverisjes vendore” dhe disa akteve nënligjore dhe udhëzimet. Puna për forcimin e planifikimit strategjik dhe menaxhimin e buxhetit në nivelin e QV përparoi mirë gjatë vitit 2019 dhe vitit 2020. Të gjitha bashkive iu ofrua trajnim për buxhetimin në bazë të performancës dhe shumë prej tyre filluan përdorimin gjatë procesit të përgatitjes së planit të buxhetit afatmesëm dhe monitorimit të tij. Gjatë vitit 2020 u krye rishikimi i kuadrit rregullator për PBA-në që shërben si bazë e mirë për monitorimin e pajtueshmërisë. Për më tepër, doli një udhëzim që synon zbatimin e një sistemi monitorimi për identifikimin e hershëm të njësive të QV që përballen me probleme financiare në korrik 2019.⁸ Nga fundi i vitit 2020 të gjitha bashkitë përgatitën Raportin e Paaftësinë së Pagesave. Detyrimet e prapambetura në nivel vendor mbeten problem pasi stoku u rrit krahasuar me vlerën e synuar të caktuar. Nuk mund të përfundohej manuali me të gjitha rregulloret për tatimet dhe regjistri i përditësuar i tatimeve për krijimin e menaxhimit efektiv të të ardhurave. Në anën tjetër është bërë rishikimi dhe përmirësimi i paketave të planifikuara fiskale të bashkive. Së fundi, Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik (DPHKBFP) ka kryer shumë aktivitete për ngritjen e kapaciteteve për të krijuar një funksion efektiv të kontrollit të brendshëm dhe auditimit të brendshëm në nivel vendor. Gjatë vitit 2020 është bërë një vlerësim gjithëpërfshirës i nevojave për të vlerësuar kuadrin strategjik sektorial dhe ndërsektorial dhe kapacitetet aktuale për planifikimin strategjik, monitorimin dhe vlerësimin e objektivave të performancës në Njësitë e Qeverisjes Vendore. Për të adresuar nevojat e identifikuara në vlerësim, një Plan Kombëtar i të Dhënave Sistemik (NSPD) 2020-2027 u miratua nga Grupi Tematik i Politikave të kryesuar nga DZHM/ZKM.

Në përgjithësi, u përmbushën 63% e treguesve të rezultetit, 25% nuk u përmbushën dhe për 13% nuk kishte të dhëna të disponueshme gjatë vitit 2020 çka tregon një përkeqësim të lehtë krahasuar me vitin 2019 (75% u përmbushën). Ashtu si në vitin 2019, janë përmbushur pesë tregues që synojnë arritjen e një planifikimi të mirëintegruar dhe efikas, ndërkohë që stoku i detyrimeve të prapambetura në njësitë vendore nuk është ulur siç ishte planifikuar. Raporti i investimeve të mëdha publike aktuale të disbursuara për vitin 2020 nuk ishte në nivelet e synuara. Vihet re se raporti mes fondeve të vlerësuara në strategjitë sektoriale dhe financimit total të identifikuar për sektorët përkatës në PBA nuk mund të llogaritet në këtë moment (nëse statusi i objektivit është shënuar *me të kuqe*-nuk është përmbushur, nëse është *portokalli*-është përmbushur pjesërisht, nëse është me ngjyrë *jeshile* – është përmbushur). Tabela më poshtë rendit objektivat e treguesve të performancës 2020 për secilin rezultat.

⁷ Vendimi nr. 185 i Këshillit të Ministrave ‘Për Procedurat e Menaxhimit të Investimit Publik’

⁸ Udhëzimi nr. 26, data 27.09.2019 “Pamundësia e shlyerjes për njësitë e qeverisjes vendore”

Tabela 2: Rezultatet kyçe dhe treguesit e performancës

Rezultati	Treguesi i Performancës	Institucioni Drejtues	Niveli bazë (2018)	Vlerë faktike FY 2019	Objektivi i Synuar FY20	Vlerë faktike FY20	Objektivi i Synuar FY 2021
III) Dokumentet planifikuese të qeverisë si SKZHI, Strategjitë Sektoriale dhe PBA janë të harmonizuara plotësisht me njëra-tjetrën	IIIa) Raporti midis fondeve totale të parashikuara në strategjitë sektoriale dhe fondet totale të identifikuar për sektorët korrespondues brenda PBA-së	DDB	56% (2017)	NA	> (t-1) (tendencë në rritje)	NA*	> (t-1) (tendencë në rritje)
IV) Përmirësimi i buxhetit vjetor dhe procesit dhe dokumentacionit të PBA-së për të rritur besueshmërinë dhe gjithëpërfshirjen e planifikimit afatmesëm	IVa) Totali i shpenzimeve të planifikuara për KPBA miratuar në vitin n/total i shpenzimeve të planifikuara në vitin n në buxhetin vjetor		0.78% (2018)	-0,14%	22.8% (2020)	22.8% (2020)	< (t-1) (tendencë në ulje)
	IVb) Realizimi faktik i shpenzimeve sipas funksionit (PEFA PI-2, 2.1)		D (2017)	B	C	B	C
	Va) Pjesa e projekteve të investimeve publike që janë propozuar bazuar tek prioritetet strategjike të qeverisë (vlera e projekteve për vitin specifik)		64% (2018)	78%	> (t-1) (tendencë në rritje)	82%	> (t-1) (tendencë në rritje)
V) Mblikërrje e Menaxhimit e përmirësuar e Menaxhimit të Investimeve Publike	Vb) Disbursimet aktuale për projektet e mëdha të investimit krahasuar me disbursimet e planifikuara shoqëruar me shpjegimet përkatëse në rastet kur ka devijime		97% (2018)	97%	97%	95%	97%
	Vc) Raporti i investimeve të reja publike të dorëzuara në ciklin e PBA kundrejt totalit të investimeve të reja publike të miratuara në një vit		30,38%	28,90%	30% - 50%	46,35%	> (t-1) (tendencë në rritje)
	Via) Normat e mbledhjes së tatimeve (RLGRG)		4,62%	5,6%	-4,90%	-4,90%	15.7% (fact 2021/2020)
VI) Forcimi i menaxhimit financiar në qeverinë vendore	Vib) Niveli vendor PEFA PI-22.1. Stoku i detyrimeve të prapambetura		6.8 mld lekë (2018)/ 49.6 mld lekë (13.7 %)	8.1 mld lekë/ 56.2 mld lekë (14.4 %)	6.5 bln ALL/52.7 billion ALL (12.3%)	6.9 bln ALL/51.6 billion ALL (13.3%)	3.5 bln ALL/56.8 bln ALL (6.1%)

Ecuria e arritur në 2020

Komponenti 2.1: Zhvillimi i politikave dhe qeverisja e integruar strategjike

Për përmirësimin e proceseve të buxhetimit dhe planifikimit të politikave dhe konsolidimin e zotërimit institucional DZHM/ZKM vazhdoi përpjekjet në vitin 2020 për rishikimin e dokumenteve strategjike të miratuara nga Këshilli i Ministrave. Megjithatë, vlera e synuar e produktit u arrit pjesërisht, sepse 14 nga 25 dokumente strategjike (ose 56%) ishin rishikuar dhe plani ishte që numri të ishte mbi mbi 16 (ose 64%). Qëllimi kryesor i rishikimit ishte të analizonte përputhshmërinë dhe nivelin e integritetit të strategjive me prioritetet e politikave dhe planifikimin buxhetor.

DZHM/ZKM ka koordinuar në mënyrë të suksesshme aktivitetet për menaxhim më të mirë të strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale. Synimi i parë që lidhej me finalizimin e Raportit Afatmesëm të Monitorimit të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020 (SKZHI II), u plotësua gjatë vitit 2020. Raporti pasqyron progresin, rezultatet e arritura dhe sfidat në zbatimin e axhendës së reformës së qeverisë. Synimi i dytë i përfunduar ishte shqyrtimi dhe komentet e bëra në 22 nga 28 raportet e monitorimit të dorëzuara tek DZHM/ZKM -së.

Për zbatim efektiv të Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI), ishte planifikuar mbështetje juridike për funksionimin e Sistemit Informatik për Menaxhimin e Planifikimit të Integruar (IPSIS). Për shkak të vonësive në marrjen e ekspertizës teknike për të ndihmuar në hartimin e Ligjit për SPI-në, objektivi i synuar nuk mund të arrihej siç ishte planifikuar dhe analiza e hendeqeve ligjore në lidhje me proceset e menaxhimit të politikave nuk ka filluar ende. Megjithatë në muajin prill 2020 u miratua një VKM⁹ për të ndihmuar me zbatimin e IPSIS-it. Fushëveprimi kryesor i vendimit ishte krijimi i bazës së të dhënave IPSIS që do të shërbente si sistemi kryesor për planifikimin, analizën, përgatitjen e të gjitha tipologjive të dokumenteve strategjike si dhe për monitorimin e performancës së realizuar në përmbushje në objektivat e planifikuara.

Udhëzimi për përcaktimin dhe monitorimin e treguesve të performancës që synon forcimin e procesit të zhvillimit të politika përfundoi sipas planit si dhe zbatimi i sistemit IPSIS përparoi mirë. Shumica e aktiviteteve, të cilat për shkak të tërmetit nuk mundën të konkretizoheshin gjatë vitit 2019, përfunduan me sukses në vitin 2020. Për shembull, janë përfunduar 25 manuale strukturore të sistemit IPSIS dhe 15 manuale

⁹ Council of Ministers no. 290, dated 11.4.2020 "On the establishment of the state database of the integrated planning information system (SIPI/IPSIS)"

për cilësinë dhe menaxhimin e të dhënave/treguesve të performancës; Është mundësuar trajnimi i 86% të rrjeteve IPSIS duke përfshirë paketën e konsoliduar të kurrikulave dhe materialeve; u përgatitën gjashtë raporte trajnimi (një për trajnimin TT, një për trajnimin e përdoruesve të IPSIS-it dhe katër për seminarët/trajnimet e dedikuara të përdoruesve të sistemit). Grupi i dytë i trajnimeve u zhvillua në vitin 2020 me më shumë se 200 pjesëmarrës që u trajnuan për tema të ndryshme që lidhen me zbatimin e sistemit. Në korrik 2020, AKSHI ka miratuar funksionalizimin dhe gatishmërinë e IPSIS-it për të filluar funksionimin. Më në fund, u zhvillua arkivi elektronik në IPSIS, i cili është funksional që kur sistemi hyri në përdorim.

Komponenti 2.2: Programi buxhetor afatmesëm

Objekti i synuar i produktit për zbatimin e buxhetimit bazuar në performancë për institucionet buxhetore u përmbush. Bazuar në USPB-në e rishikuar, të miratuar në fillim të vitit 2018, u bë trajnim dhe rishikim i thelluar në të gjitha njësitë e qeverisjes qendrore gjatë vitit 2020. Më konkretisht, u bë rishikimi i zbatimit të udhëzuesve të rinj për tre ministri linje/institucione me mbështetjen e asistencës teknike të BE-së. Këto ministri përfshijnë, Ministrinë e Kulturës (MK), Ministrinë e Brendshme (MB) dhe Ministrinë e Mjedisit dhe Turizmit (MMT). Rishikimet evidentuan se ka ende disa boshllëqe dhe mospërputhje në zbatimin e udhëzimeve buxhetore nëpër sektorë. Prandaj, Drejtoria e Analizës dhe Programimit Buxhetor do të ndjekë nga afër zbatimin e tij përpara fazës së ardhshme të PBA-së. Moduli i ri i PBA-së u shpërnda në të gjitha ministritë e linjës dhe IB-të gjatë vitit 2020. Gjithashtu gjatë kësaj periudhe, u asistuan 132 ekipe të menaxhimit të programit për të lehtësuar zbatimin e shpejtë të modulit. Së fundi, për të ndihmuar më tej ministritë në zbatimin e udhëzimeve të reja, janë miratuar dhe publikuar katërmbëdhjetë udhëzime sektoriale. Për të shqyrtuar dhe financuar siç duhet të gjitha nismat e reja të politikave, Komiteti i Planifikimit Strategjik miratoi Dokumentin e Politikave Prioritare në mars dhe në korrik të vitit 2020 në dy takime të veçanta u vendosën nismat e reja të politikave përpara përfshirjes së tyre në PBA. Është arritur gjithashtu progres në përmirësimin e mëtejshëm të buxhetimit gjinor (BPGJ) në nivelin e qeverisë qendrore; gjatë vitit 2020, 55% e programeve buxhetore janë integruar plotësisht në BPGJ. 15 OSHC janë trajnuar për buxhetimin me pjesëmarrje dhe BPGJ gjatë vitit 2020.

Produkti në lidhje me rritjen e cilësisë dhe përmbajtjen e dokumenteve buxhetore për miratim në Kuvend u arrit siç ishte synuar për vitin 2020. Janë rishikuar materialet dhe planet e veprimit. U përgatitën formatet për prezantimin e të dhënave dhe përmbajtjen.

Komponenti 2.3: Planifikimi dhe mbikqyrja e investimeve publike

Puna për krijimin e një Liste të Unifikuar të Projekteve, për të gjitha projektet, pavarësisht burimit të financimit, ka përparuar mirë. Gjatë vitit 2020, Komiteti për Planifikimin Strategjik (KPS) u mbledh dhe miratoi Listën e Unifikuar të Projekteve. Në vijim të miratimit të ndryshimeve në ligjin për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat filloi puna për hartimin e akteve nënligjore dhe çdo gjë ka ecur sipas planit. Gjatë vitit 2020 u miratuan tre Vendime të Këshillit të Ministrave¹⁰ me anë të cilave u përcaktuan mënyrat për organizimin punës nga institucionet për të kryer vlerësimin e koncesioneve dhe PPP-ve si dhe për organizimin dhe funksionimin e ATTRAKO.

Megjithëse nuk u vendosën objektiva të synuara specifike për vitin 2020 me qëllim rritjen e cilësisë së propozimeve për investime publike që dërgohen për miratim, projekti i Asistencës Teknike i BE-së trajnoi në vendin e punës dhe organizoi seminare për punonjësit e ML-ve. Gjithashtu, po gjatë vitit 2020, një vit para planifikimit fillestar, filloi përgatitja e metodologjive për të zhvilluar studime fizibiliteti, analizën kosto-përfitim, vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe në shoqëri si dhe mjetet e priorizimit.

Janë bërë përpjekje për të përmirësuar procesin e monitorimit të investimeve publike, duke përfshirë projektet PPP dhe koncesionet, dhe sidomos për sa i përket raportimit të detajuar dhe cilësor. Në

¹⁰ VKM nr. 420, datë 27.05.2020 "Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe koncesionin /PPP", VKM Nr. 285, datë 10.04.2020 "Për organizimin dhe funksionin e ATTRAKO", VKM Nr. 280, datë 07.04.2020 "Për miratimin e rregullave për organizimin e Komisionit Përzgjedhës të Koncesionit/PPP dhe kritereve të vlerësimit për veçimin e projekteve të Koncesionit/PPP"

vijim të ndryshimeve të vitit 2019 të kuadrit rregullator për monitorimin e PPP-ve dhe koncesioneve, gjatë vitit 2020, Drejtoria e Koncesioneve (DK) ka vazhduar punën për përmirësimin e cilësisë së informacionit të marrë nga Autoritetet Kontraktore. Në maj të vitit 2020, u botua për herë të parë Raporti Vjetor Përmbledhës për vitin 2019 i cili përmban të dhëna financiare dhe jo financiare për PPP-të aktive. Pavarësisht, sa komplekse janë kontratat, sidomos në sektorin e hidrocentraleve, janë bërë përpjekje për të përfshirë më shumë sektorë në kuadrin raportues si dhe të përcaktohen më mirë treguesit e performancës për secilën kontratë.

Komponenti 2.4: MFP-ja në qeverinë vendore

Pjesa më e madhe e vlerave të synuara të produkteve që kanë si qëllim fuqizimin e planifikimit strategjik dhe menaxhimit të buxhetit në nivel të QV-së janë përmbushur. Me asistencën e Projektit për Financat Vendore (PFV) është kryer një rishikim i kuadrit rregullator për proceset e PBA-së në nivel vendor. Raporti i këtij rishikimi u prezantua në një seminar me pjesëmarrës të përfaqësuesve nga disa drejtori të MFE-së, PFV-së, ambasadës zvicerane dhe ekspertë të ndryshëm të fushës së financave. Rishikimi i kuadrit rregullator shërbeu si një bazë e fortë për hartimin e procesit të monitorimit të përputhshmërisë ligjore i cili lehtëson përgatitjen e Raportit Vjetor për Përputhshmërinë në nivel bashkie. Gjatë vitit 2020, janë zhvilluar shumica e trajnimeve të planifikuara për bashkitë për treguesit e performancës (21 nga 25 bashki të planifikuara). Drejtoria për Financat Vendore (DFV) vazhdoi monitorimin dhe publikoi Raportin për Detyrimet e Prapambetura në faqen zyrtare të MFE-së. Sidoqoftë, stoku i detyrimeve të prapambetura në fund të muajit dhjetor 2020 nuk u zvogëlua në përputhje me vlerën e synuar, dhe kjo ndodhi për shkak të ndikimit negativ të tërmetit dhe pandemisë COVID-19 tek mbledhja e të ardhurave nga ana e bashkive. Detyrimet e prapambetura deri me 31 dhjetor 2020 janë 6.9 miliard Lek (në krahasim me 6.5 miliard të planifikuara). Pas trajnimit që iu bë nga Projekti për Financat Vendore, të gjitha bashkitë hartuan një Raport mbi Statusin e Vështirësive Financiare. Si përfundim, të gjitha bashkitë përgatitën raportin për monitorimin e zbatimit të buxhetit, i cili ishte i një cilësie të lartë. Në tërësi, këto raporte monitorimi janë një bazë e mirë për të rritur transparencën, bashkëpunimin dhe raportimin tek strukturat e qeverisjes qendrore.

Objektivat e synuara të produkteve për të ngritur një menaxhim efikas të të ardhurave për vitin 2020 u përmbushën pjesërisht. Puna për të përgatitur një manual që të përmbajë të gjithë kuadrin rregullator për tatimet nuk përfundoi sipas planit. Megjithatë, në bashkëpunim me PFV-në u përgatitën dy rregullore, një për administrimin e borxhit tatimor dhe një për shërbimin ndaj tatimpaguesve. Rregullorja e parë u zbatua nga 18 bashki, ndërsa e dyta nga 5 bashki. Për sa i përket objektivit tjetër që ka si synim përmirësimin e paketave fiskale dhe regjistrin tatimor në 15 bashkitë pilot, deri në fund të vitit 2020, në 18 bashki këto paketa fiskale u përmirësuan, ndërsa përditësimi i regjistrin tatimor nuk u përfundua sipas planit.

Objekti i synuar i produktit për të pasur një sistem të përmirësuar të transfertave financiare ndërqeveritare, u përmbush pjesërisht gjatë vitit 2020. Fondet për arsimin parashkollor u ndanë në bazë të numrit të nxënësve, të përcaktuar si forca drejtuese më e mirë në përcaktimin e fondeve dhe shërbimeve. Të ardhurat nga Tatimi mbi të Ardhurat Personale u transferuan periodikisht sipas planit tek njësitë e qeverisjes vendore.


DPHKBFP-ja ka kryer shumë aktivitete për rritjen e kapaciteteve për të ngritur një funksion efektiv për kontrollin e brendshëm dhe auditimin e brendshëm në nivel qeverie vendore. Prandaj, gjatë vitit 2020, janë trajnuar të gjithë audituesit e brendshëm të punësuar në bashkitë e përzgjedhura. Ndërsa trajnimi për “Hyrje në menaxhimin e riskut dhe instrumentet MFK (menaxhimi financiar dhe kontrolli) për stafin kryesor të nivelit drejtues dhe audituesit e brendshëm” u organizua në 18 bashki nga 15 të planifikuara.

Objektivat e synuara të produkteve për vitin 2020 për rritjen e kapaciteteve të MFE-së për të menaxhuar reformën e MFP-së në nivel NjQV-je janë përmbushur. Drejtoria për Financat Vendore (DFV) në MFE ka nisur të përdorë mjetet e monitorimit të cilat ndihmojnë në vlerësimin e zbatimit të Ligjit për Financat Vendore. Gjithashtu, DFV ka rishikuar kërkesat për PBA të gjitha 61 NjQV-të.

Pavarësisht faktit se nuk ishin vendosur objektiva specifik për krijimin e IPSIS në nivel të Qeverisjes Vendore, puna ka filluar në këtë drejtim. Gjatë vitit 2020 u bë një vlerësim gjithëpërfshirës i nevojave për të vlerësuar kuadrin e strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale si dhe kapacitetet aktuale për planifikimin strategjik, monitorimin dhe vlerësimin e objektivave të performancës në Njësitë e Qeverisjes Vendore. Për të adresuar nevojat e identifikuar në vlerësim, një Plan Kombëtar i të Dhënave Sistemike 2020-2027 u përgatit, u konsolidua dhe u miratua u miratua nga Grupi Tematik i Politikave të kryesuar nga DZHM/ZKM me pjesëmarrjen e të gjitha ministrive të linjës dhe të gjitha NjQV-ve pilot (30 NjQV) në bashkëpunim të ngushtë me MFE-në dhe Ministrinë e Brendshme. Plan Kombëtar i të Dhënave Sistemike është dizenuar dhe zhvilluar si një plan veprimi afatmesëm dhe afatgjatë dhe përmban tre objektiva të përgjithshme, gjashtë objektiva specifike dhe 29 masa që lidhen me funksionalitetin dhe përdorimin e sistemit në nivel qeverisje qendrore dhe vendore.

Përmbledhje e ecurisë së objektivave të synuara për produktet në objektivin specifik 2

Grafiku 2: Statusi i vlerave të synuara të produkteve për vitin 2020



Risqet kryesore

Për këtë Objektiv Specifik nuk janë identifikuar risqe të larta në zbatimin e strategjisë, me përjashtim të disa risqeve mesatare në fushën e Menaxhimit Publik dhe MFP në financat vendore. Në veçanti, vështirësi sjellin vonesat në miratimin e ndryshimeve rregullatore dhe mungesa e burimeve njerëzore në lidhje me zhvillimin dhe mirëmbajtjen e Listës së Unifikuar Kombëtare për të gjitha projektet, pavarësisht nga burimi i financimit. Gjithashtu, risqet që trajnimi i stafit të financave vendore nuk është i qëndrueshëm dhe se mungojnë aftësitë e prokurimit/TI konsiderohen mesatare.

3.3 Ecuria për Objektivin Specifik 3

Një Sistem i ri i Teknologjisë së Informacionit (TI) për Administrimin e Taksave (TI) është vënë në punë që prej janarit të vitit 2015, rishikimet e sistemit përfunduan në vitin 2017. Në vitin 2015, administrata tatimore filloi zbatimin e metodologjisë bashkëkohore të pajtueshmërisë së menaxhimit të riskut (MRP), duke synuar të përmirësojë pajtueshmërinë e tatimpaguesit bazuar në grupe (p.sh. e fokusuar në industri). Informacioni për tatimet është thjeshtuar dhe informacioni për tatimpaguesit është përmirësuar nëpërmjet faqes zyrtare të internetit, fushatave të ndërgjegjësimit dhe krijimit të një qendre telefonike. Gjatë vitit 2019, administrata tatimore përfundoi modelin për procedurat e automatizuara të bazuara në risk për të gjitha rimbursimet e TVSH-së dhe pjesa dërrmuese e punës për zbatimin e rimbursimeve automatike të TVSH-së është kryer gjatë vitit 2020. Si përfundim, periudha e rimbursimit të TVSH-së përgjysmoi stokun e papaguar të

rimbursimeve të TVSH-së të ulur me 16% gjatë vitit 2020 krahasuar me vitin 2019. Një pjesë e automatizimit të proceseve bazë të administrimit tatimor përfshinte përmirësimin e modulit të menaxhimit të faturave elektronike, i cili filloi në vitin 2019, më herët se sa ishte planifikuar. Është bërë përparim drejt përfundimit të kontrollit automatik të kryqëzuar që do të përdorej për të verifikuar informacionin e kthimit. Gjatë vitit 2019, DPT krijoi një regjistër të plotë dhe të saktë të tatimpaguesve, i cili kontribuoi më tej në informimin e të gjithë tatimpaguesve dhe inkurajoi korrigjimin vullnetar të detyrimeve tatimore. Kjo e fundit së bashku me analizat e kryera nga Departamenti i Menaxhimit të Riskut për përzgjedhjen për auditim të tatimpaguesve me risk të lartë mbështeti një nga objektivat kryesore të Departamentit të Tatimeve lidhur me reduktimin e informalitetit.

Reforma për taksën mbi pronën është vonuar për shkak të ngjarjeve të paparashikuara dhe për rrjedhojë gjatë vitit 2020 MFE, SIDA dhe Agjencia e Taksave Shtetërore kanë arritur një marrëveshje me qëllim shtyrjen e agjendës së reformës për taksën mbi pronën me dy vjet. Është krijuar një strukturë e dedikuar që synon të krijojë dhe menaxhojë në mënyrë qendrore sistemin e informacionit të kadastrës fiskale dhe reformën e tatimit në pronë, si dhe është krijuar kuadri ligjor për tatimin në pronë bazuar në çmimet e referencës. Gjatë vitit 2019 nisi tatimi mbi pronën në bazë të vlerës së zonës fiskale për ndërtesat dhe funksionalizimi i mbledhjes së taksave. Një sistem i ri TI u prezantua në vitin 2018 dhe që atëherë është përditësuar. Janë zhvilluar trajnime për stafin e bashkive.

Kuadri rregullator i Drejtorisë së Përgjithshme së Doganave (DPD) është rishikuar vazhdimisht për të qenë në përputhje të plotë me *acquis communautaire* të BE-së, duke përfshirë zhvillimet më të fundit, p.sh. grupimi i IDT-së dhe Nomenklaturës së Mallrave. Gjatë viteve 2015-2020 është përmirësuar efikasiteti dhe transparenca e dhënies së shërbimit doganor në pikat e kontrollit kufitare. DPD-ja nuk ka përparuar me miratimin e Operatorëve Ekonomik të Autorizuar si ishte planifikuar për vitin 2019, megjithatë po kryhen aktivitete për rritjen e ndërgjegjësimit në lidhje me përfitimet, procedurat dhe programet. Kontrata për Sistemin e Integruar të Menaxhimit të Tarifave, plotësisht në përputhje me BE-në dhe kontrata me UNCTAD për përmirësimin e sistemit ASYCUDA (për modulën e menaxhimit të riskut dhe për ngritjen e një baze të dhënash me të dhëna të konfiskimit të mallrave të falsifikuara) janë firmosur gjatë vitit 2020.

Kriza e COVID-19 vjen pas një tërmeti të fortë në fund të vitit 2019 dhe të dyja goditjet kanë ndikuar negativisht në mobilizimin e të ardhurave. Gjashtë nga shtatë objektivat janë rishikuar gjatë vitit 2020 (miratuar nga Komiteti Drejtues në janar 2021), por ende jo të gjitha objektivat e rishikuara janë arritur deri në fund të vitit 2020. Megjithatë, 71% e vlerave të synuara të treguesve të rezultateve janë arritur dhe 29% nuk janë arritur në vitin 2020, duke treguar përmirësim krahasuar me vitin 2019 ku u arritën 57% e këtyre objektiveve. Vlera e synuar e lidhur me raportin e rimbursimit tatimor kundrejt vitit të mëparshëm dhe kohës së përpunimit të deklarimit doganor është përmirësuar në krahasim me vitin 2019. Vlerat e synuara në lidhje me numrin e ndërtesave të regjistruara dhe të faturuara dhe përqindja e mbledhjes aktuale të të ardhurave doganore nuk janë arritur në krahasim me vitin 2019. Tabela më poshtë paraqet statusin e rezultateve kyçe dhe vlerave të synuara të vitit 2020 për treguesit e performancës (nëse statusi i vlerës së synuar është shënuar me të kuqe: nuk është përmbushur, me portokalli: është përmbushur pjesërisht, me jeshile është përmbushur).

Tabela 3: Rezultatet kyçe dhe treguesit e performancës

Rezultati	Treguesi i Performancës	Institucioni Drejtues	Niveli bazë (2018)	Vlerë faktike FY 2019	Objektivi i Synuar FY20	Vlerë faktike FY20	Objektivi i Synuar FY 2021
VII) Rritja e nivelit të të ardhurave nga tatimi	VIIa) Baza e tatimit të bizneseve	GDMPPA	112 428 biznese (2017)	113 829 (+1.24%)	≥ 14% (128 000)	47.6% (165,955 businesses in 2020)	
	VIIb) % e mbledhjes faktike të tatimeve në vitin N / mbledhja faktike në vitin N-1 -100% (nga tatimet)		>0	259.462 million ALL (Gross, in 2019) (5.23%)	-11%	-7.20%	12.0%
	VIIc) Përpjestimi i bonxhit të tatimit të mbledhur në vitin N kundrejt shumës së prapambetur të detyrimeve tatimore		63%	74.00%	70.86%	78.39%	62%
VIII) Ulja e informalitetit nga rritja e vet-deklarimit dhe rritje e forcës së kontrollit të zbulimit	VIIIa) Raporti i deklarimeve tatimore kundrejt vitit paraardhës		6.60%	3.48%	2.14%	2.21% (2,876,202 returns in 2020, vs 2,814,005 in 2019)	< 0%
IX) Kadastra fiskale tërësisht funksionale	IXa) Numri i ndërtesave të regjistruara dhe të faturuara		46.67% (2017) (700 000/1 500 000)	47.5% (570000/1200000)	80% (1 200 000/1 500 000)	80% (1 200 000/1 500 000)	86.7% 1 300 000/1 500 000
X) Rritje e nivelit të të ardhurave nga doganat	Xa) % e mbledhjes faktike të ardhurave doganore në vitin N / mbledhja faktike e të ardhurave doganore në vitin N-1 -100% (nga doganat)		>0	2.09%	-5.9%	-6.10%	9%
	Xb) Koha e përpunimit të deklaratave doganore		(2018) 143.81	453 min/ deklarata	97	97	70

Ecuria gjatë vitit 2020

Komponenti 3.1 Administrimi tatimor

Në përgjigje të kërkesës së MFE-së për mbështetje dhe udhëzime për përgatitjen e një Strategjie Afatmesme për të Ardhurat (SAA), një mision i FMN-së për administrimin e të ardhurave vizitoi Tiranën në muajin nëntor të vitit 2019 dhe parashikoi mundësitë për të adresuar zonat me risk të lartë për papajtueshmëri të detyrimeve tatimore dhe për të forcuar administrimin e të ardhurave. Projekt-strategjia është përgatitur në fillim të vitit 2020, por me nisjen e pandemisë së COVID 19 u bë më pak e përshtatshme. Kështu, strategjia do të rishikohet gjatë vitit 2021 duke marrë parasysh sfidat e reja fiskale

Hartimi i modelit të procedurës së automatizuar bazuar në risk për menaxhimin e rimbursimeve të TVSH-së u krye sipas planit dhe pjesa më e madhe e punës për zbatimin automatik të rimbursimit të TVSH-së është kryer. Gjatë vitit 2020 është rishikuar rregullorja e rimbursimit që synon të lehtësojë dhe thjeshtojë kriteret e aplikuar të riskut. Prandaj, u përgjysmua periudha e ripagimit të rimbursimit të TVSH-së dhe u ndoq metoda FIFO në mënyrë rigorozë. Si rezultat, stoku i papaguar i rimbursimeve të TVSH-së u ul në vitin 2020 me 16% krahasuar me vitin 2019.

Pjesë e automatizimit të **proceseve kryesore të administrimit të tatimeve** përfshinte gjithashtu përmirësimin e modulit të menaxhimit të faturës elektronike që nisi në vitin 2019, më herët se sa ishte planifikuar. Përfunduan specifikimet e ndërtimit të sistemit dhe modeli i të dhënave të biznesit dhe u miratuan ndryshimet legislative (ligji¹¹ dhe aktet nënligjore). Një nga objektivat për vitin 2020 që synon të ndihmojë në automatizimin e sistemit ishte përfundimi i kontrollit automatik të kryqëzuar që do të përdorej për të verifikuar informacionin e kthimit. Futja e procesit të fiskalizimit do ta bënte edhe më efektiv kontrollin e kryqëzuar, por duke qenë se raporti nuk mund të përfundohej gjatë vitit 2020, kontrolli automatik i kryqëzuar i informacionit të rimbursimit nuk mund të përfundohej.

Trajnimi i stafit për menaxhimin e riskut që synonte të ndërtonte një sistem të përgjithshëm të Menaxhimit të Riskut të Pajtueshmërisë u përmbush sipas planifikimit. Një trajnim me fokus sektorin e ndërtimit u zhvillua gjatë muajve shkurt – mars të vitit 2020 nga ekspertët e FMN-së për 14 anëtarë të Departamentit të Menaxhimit të Riskut.

U përmbushën të dy objektivat për krijimin e një regjistri të saktë të tatimpaguesve. Gjatë vitit 2020, DPT-ja punoi për të përmirësuar regjistrin e tatimpaguesve. Marrëveshja e nënshkruar midis DPT-së dhe Qendrës Kombëtare të Biznesit mundësoi transmetimin në kohë të të dhënave për regjistrim dhe ndryshimeve përkatëse të kompanive, përfshirë ato që ishin likuiduar, bashkuar apo ndarë. Një tjetër faktor

¹¹ Ligji nr. 87/2019 “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”

që ndikoi në plotësimin e regjistrimit ishin dy fushata ndërgjegjësimi të organizuara në vitin 2020, njëra për ndryshimet ligjore të paketës fiskale të vitit 2020, një tjetër për sezonin turistik dhe tjetra për fiskalizimin.

DPT-ja përmbushi gjatë vitit 2020 pjesërisht objektivat që synonin reduktimin e informalitetit.

Drejtorja e Menaxhimit të Riskut analizoi sektorin e turizmit dhe pagat për disa profesione për të identifikuar dhe përzgjedhur për auditim tatimpaguesit me risk të lartë. Në projektin e turizmit, edhe pse i vështirë për t'u vazhduar gjatë pandemisë është shënuar progres, i cili vitin e ardhshëm do të jetë edhe më i madh. Në bazë javore janë identifikuar tatimpaguesit që nuk ishin në pajtueshmëri dhe u krye monitorimi i qarkullimit të arkës fiskale (për periudhën korrik-shtator 2020). Megjithatë, gjatë vitit 2020 nuk ka pasur të ardhura shtesë nga ky sektor për shkak të numrit të ulët të turistëve të huaj dhe orarit të kufizuar të punës për shkak të pandemisë. Nga një analizë krahasuese e këtij sektori për periudhat qershor-gusht 2019/2020, është evidentuar një rënie e xhiros me 28,3%. Gjithashtu, projekti i pagave evidentoi risk nëndeklarimi të pagave të 33 profesioneve të ndryshme si: drejtor, ekonomist, inxhinier, farmacist, jurist, kardiolog etj. Këtyre tatimpaguesve (si punëdhënës ashtu edhe punëmarrës) iu dërguan letra të personalizuar për t'i nxitur të deklaronin pagat. Për disa profesione në tremujorin e parë të vitit pati një rritje prej 3.3% të pagës mesatare në shkallë vendi. Kjo shifër bazohet në statistikat e INSTAT-it. Gjithashtu, është kryer hetimi i transaksioneve zinxhir duke filluar nga kompanitë e mëdha dhe është përgatitur një raport me gjetjet. Në Prokurori janë referuar 194 çështje për veprat penale në fushën e tatimeve me vlerë dëmi 5 115 938 598 ALL. Për veprën penale “Krijimi i skemave të mashtrimit me TVSH-në” parashikuar nga neni 144/a i Kodit Penal, në Prokurori u referuan edhe 5 çështje me vlerë dëmi prej 1,087 miliardë ALL. Gjatë vitit 2020 janë kryer 1432 auditime të plota dhe totali i gjetjeve ka shkuar në 9.5 miliardë lekë. Së fundi, për të reduktuar informalitetin do të përdoren kontrollet tatimore dhe iniciativa të tjera për të zbuluar dhe parandaluar raportimin e pasaktë. Janë hartuar disa ndryshime rregullatore për dorëzimin e pasqyrave financiare, por raporti ende nuk është përgatitur. Pas ndryshimeve rregullatore për paraqitjen e pasqyrave financiare (që udhëzon procedurën e marrjes, verifikimit dhe rishikimit të pasqyrave financiare nga departamentet rajonale të auditimit), raporti në fjalë i referohet një raporti statistikor që synon të përgatitet nga departamentet rajonale të auditimit me informacion mbi rishikimin e deklaratave tatimore të tatimpaguesit dhe dorëzimit të pasqyrave financiare. Objektivi i raportit është të paraqesë problemet e mundshme të hasura gjatë këtij verifikimi dhe t'i ngrejë ato në departamentin e auditimit në DPT.

Baza e të dhënave për stokun e borxhit është përditësuar sipas planeve bazuar në raportet mujore të Drejtorive të Qarqeve për Mbledhjen e Borxhit.

Komponenti 3.2: Kadastra fiskale e pronave

Objektivat e përcaktuar për vitin 2020 për krijimin e një takse mbi pronën “ndërtesë” të bazuar në vlerën fiskale të një zone dhe funksionaliteti i mbledhjes së taksave nuk janë arritur. Qëllimi i kadastrës ishte konsolidimi dhe përmirësimi i cilësisë së të gjitha të dhënave ekzistuese për tokën, ndërtesat dhe pronarët/banorët, si dhe llogaritja e detyrimit tatimor vjetor që lidhet me secilën pronë. Taksimi i parë i ndërtesave nuk mund të kryhej për shkak të cilësisë së ulët të të dhënave të lartpërmendura dhe mungesës së angazhimit të komunave në regjistrimin dhe përditësimin e të dhënave në sistem. Disa të dhëna parashikoheshin të merreshin edhe nga OSHEE, por kjo e fundit nuk kishte marrë pozicionin e agentit të centralizuar të grumbullimit, i cili ishte një nga parakushtet e procesit të kadastrës fiskale të popullsisë. Për shkak të këtij ndryshimi, tërmetit dhe pandemisë COVID-19, MFE, SIDA dhe Agjencia Suedeze e Taksave (STA) kanë rënë dakord të zgjasin projektin me dy vjet në mënyrë që të arrijnë planin dhe të realizojnë objektivat kryesore. Më në fund, Ligji për Tatimin mbi Pronën nuk u miratua siç ishte planifikuar brenda vitit 2020 pasi është ende në proces konsultimi. Sistemi i TI-së është përmirësuar dhe personeli bashkiak janë trajnuar për versionin aktual të sistemit të TI-së. Krijimi i zonave të vlerave është në proces e sipër dhe ende nuk është zbatuar në sistem.


Komponenti 3.3: Menaxhimi doganor

Vlerat e synuara për produktet e përcaktuara për vitin 2020, për të nxitur mbledhjen e detyrimeve duke përmirësuar politikat/procedurat dhe proceset doganore janë përmbushur. DPD-ja punoi për të përafruar kuadrin rregullator me acquistë BE-së duke përditësuar Udhëzimet për IDT-në. Sistemi i menaxhimit të cilësisë në laboratorin e Doganës me qëllim analizimin e të gjitha mallrave të importit dhe akcizës që mbërrijnë në Shqipëri ka ndërmarrë gjatë vitit 2020 certifikimin dhe akreditimin vjetor për analiza të ndryshme. Gjatë vitit 2020, tetë subjekte kanë aplikuar për statusin e Operatorit Ekonomik të Autorizuar (OEA), por asnjëri prej tyre nuk është miratuar. Qëllimi i statusit është që operatorët të përfitojnë nga shumë procedura të thjeshtuara doganore pasi ato konsiderohen më pak të rrezikshme brenda dhe jashtë vendit. Është nënshkruar kontrata për Sistemin e Integruar të Menaxhimit të Tarifave (SIMT) – plotësisht në përputhje me BE-në dhe është bërë progres në zbatimin e saj.

Synimi i probuktit për vitin 2020 që synon krijimin e një sistemi gjithëpërfshirës të menaxhimit të riskut në përputhje me BE-në është arritur pjesërisht. Është nënshkruar kontrata me UNCTAD për përmirësimin e Sistemit ASYCUDA (sistemi bazë) dhe ka nisur puna me zbatimin e moduleve të reja për menaxhimin e riskut.

Përmbledhje e ecurisë së produkteve të objektivave për objektivin specifik 3

Grafiku 3: Statusi i vlerave të synuara të produkteve për vitin 2020



Risqet kyçe

Sipas këtij objektivi specifik nuk janë identifikuar risqe të larta për zbatimin e strategjisë, me përjashtim të disa risqeve të moderuara në komponentët e Kadastrës Fiskale që lidhen me sigurimin e fondeve për zbatimin e të gjitha aktiviteteve dhe organizimin e trajnimeve që janë të qëndrueshme në shkallë të gjerë. I njëjti nivel risku identifikohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, e cila e sheh si sfiduesë mjaftueshmërinë e dispozitave financiare për financimin e aktiviteteve të planifikuara dhe numrin e personelit.

3.4 Ecuria për objektivin specifik 4

SIFQ-ja është mjeti kyç i bazuar në sistem për kontrollimin dhe monitorimin e të ardhurave dhe shpenzimeve. Qeveria planifikon të shtrijë sistemin në të gjitha IB-të kryesore, por është planifikuar shtyrja e

afateve kohore. Gjatë periudhës 2014-2019, 15 institucione buxhetore u regjistruan në SIFQ, duke përfaqësuar rreth 78% të shpenzimeve totale, kundrejt planit origjinal të vitit 2014 për t'u shtrirë deri në 50 IB deri në vitin 2018. Integrimi i SIFQ-së me Sistemin e Menaxhimit Doganor, Sistemin e Prokurimit Publik dhe SIMBNJ-në ngelet një sfidë, duke qenë se testimi i ndërfaqes nuk mund të përfundojë deri në fund të vitit 2020. Ecuri të mirë ka pasur gjatë vitit 2020 në integrimin e SIFQ-së me SIMBNJ dhe planet janë të nisin përdorimin gjatë gjysmës së dytë të vitit 2021. Portali ueb për arkiv elektronik ishte i aksesueshëm për 110 BI deri në fund të 2020. Vitet e para të zbatimit të Strategjisë synonin për të krijuar masa mbrojtëse të nevojshme për të parandaluar një grumbullim të ri të detyrimeve të prapambetura duke futur kontrolle të angazhimeve shumëvjeçare. SIFQ u zgjerua për këtë qëllim, në mënyrë që IB-të të mos mbi-angazhoheshin dhe u lëshua një udhëzim i ri për të standardizuar procedurën për menaxhimin e tavanit të angazhimit. Megjithatë, ende shfaqen detyrime të reja të prapambetura dhe rrjedhimisht masat për të përforcuar angazhimin dhe kontrolluar shpenzimet kanë vijuar të jenë në fokus të MFE-së. Gjatë vitit 2020, nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë u krijua një grup pune për detyrimet e prapambetura (GPMDP) për të monitoruar zhvillimin e tyre dhe për të dhënë rekomandime sistematike. Një zhvillim pozitiv ishte angazhimi i audituesve të brendshëm në auditimin e detyrimeve të prapambetura në subjektet më problematike. Gjetjet dhe rekomandimet u përfshinë në raportin vjetor të KBFP për 2019 dhe 2020 dhe u diskutuan gjerësisht në mbledhjet e Bordit të KBFP.

DP-ja e Thesarit ka punuar për të përmirësuar parashikimin e likuiditetit dhe monitorimit dhe pjesa më e madhe e objektivave janë arritur gjatë vitit 2019 dhe 2020. Ekziston një Strategji Afatmesme e Menaxhimit të Borxhit (SAMB) dhe kryhet rregullisht analiza për qëndrueshmërinë e borxhit. Ka pasur ecuri në ndryshimin e LPP-së për të qenë në përputhje me të plotë me *Acquis Communautaire* (direktivat e reja të BE-së). Në dhjetor 2020 është miratuar një ligj i ri për prokurimet publike duke transpozuar 4 direktiva të Bashkimit Evropian. Janë ndërmarrë masa ligjore dhe rregullatore për të nxitur pavarësinë e Komisionit të Prokurimit Publik (KPP). Gjithashtu, KPP-ja e re u vu në zbatim në 16 korrik 2018, dhe të gjitha vendet e lira u plotësuan sipas planit për vitin 2019 dhe 2020. Planet për përmirësimin e mëtejshëm të sistemit të prokurimit elektronik (SPE) nuk u realizuan gjatë vitit 2020 dhe do të zbatohen gjatë vitit 2021. Sistemi i apelimit elektronik të KPP-së është në përfundim dhe do të ndihmojë në menaxhimin e ankesave. Ndërfaqja e SIFQ dhe SPE u krijua në vitin 2020 dhe kontrolli online i fondeve të disponueshme mund të kryhet përpara se të fillojë çdo procedurë prokurimi.

Një sistem për menaxhimin e fondeve të jashtme, Sistemi Informatik për Menaxhimin e Asistencës së Jashtme (SIMAJ), u vu në zbatim në qershor të vitit 2018, si dhe filloi puna për të rritur pajtueshmërinë e hedhjes së të dhënave dhe përdorimin e tij, si një burim parësor informacioni për të gjitha fondet e donatorëve. Në fund të vitit 2020, migrimi dhe hedhja e të dhënave për vitin 2017 dhe 2018 pothuajse kishte përfunduar, ndërsa informacioni për BE-në dhe partnerët e tjerë për zhvillim do të përfundojë pas vitit 2020.

Kuadri rregullator për Ndhimën Shtetërore u përmirësua për të qenë në përputhje me rregulloret dhe udhëzimet e BE-së. Ka filluar puna për të krijuar një bazë të dhënash efektive për monitorimin dhe zbatimin e ndihmës shtetërore dhe disa aktiviteteve për të rritur ndërgjegjësimin për rolin dhe kryerjen e detyrave të Komisionit të Ndhimës Shtetërore.

Qëllimi kryesor i objektivave specifik është të garantojnë një përdorim efikas dhe efektiv të burimeve buxhetore të aprovuara. Në përgjithësi, 57% e objektivave të treguesve të rezultateve u përmbushën, 29% u përmbushën pjesërisht dhe 14% nuk u arritën duke treguar përkeqësim në krahasim me vitin 2019 ku u arritën 86% e tyre. Objektivi i lidhur me treguesin e rezultateve SHPPF 22.2 Monitorimi i detyrimeve të prapambetura të shpenzimeve u përmbush për të dytin vit radhazi. Në vitin 2020 asnjë IB i ri nuk u fut në SIFQ, por ka pasur një rritje të vëllimit të buxhetit të ekzekutuar përmes SIFQ. Stoku i detyrimeve të prapambetura nuk u zvogëlua siç ishte planifikuar, ndërkohë që të dy objektivat lidhur me koston e huamarrjes u arritën. Efikasiteti i sistemit të prokurimit u ndikua nga kufizimet lidhur me COVID-19, dhe për këtë arsye objektivat nuk mund të arriheshin. Tabela e mëposhtme paraqet statusin e rezultateve kryesore dhe objektivat e vitit 2020 për treguesit e performancës (nëse statusi i objektivit është shënuar me *ngjyrë të*

kuqe: nuk është përmbushur, nëse me ngjyrë portokalli: është përmbushur pjesërisht, nëse me ngjyrë jeshile: është përmbushur).

Tabela 4: Rezultatet kyçe dhe treguesit e performancës

Rezultati	Treguesi i Performancës	Institucioni Drejtues	Niveli bazë (2018)	Vlerë faktike FY 2019	Objektivi i Synuar FY20	Vlerë faktike FY20	Objektivi i Synuar FY 2021
XI) Zbatimi efikas i buxhetit (me anë të përdorimit të TI-së)	XIa) Shuma totale e buxhetit që është zbatuar me anë të SIFQ në raport me shumën totale të buxhetit që është zbatuar nga qeveria qendrore	Drejtoria e Përgjithshme e Thesaurit	74% (2018)	75%	≥ (t-1) (tendencë në rritje)	78%	≥ (t-1) (tendencë në rritje)
XII) Detyrimet e prapambetura minimizohen	XIIa) PEFA 22.1. Stoku i shpenzimeve (detyrimet e prapambetura si përqindje e totalit të shpenzimeve për vitin fiskal)		nën 6% (B PEFA)	A	nën 4%	4,40%	nën 3%
	XIIb) PEFA 22.2. Monitorimi i detyrimeve të prapambetura të shpenzimeve (në SIFQ)		C (2017)	C	A	A	A (të dhënat jepen cdo tremujor, brenda 4 javëve në fund të secilit tremujor)
XIII) Ulet kostoja e huasë dhe likuiditeti është i disponueshëm kur nevojitet	XIIIa) Stoku i borxhit të brendshëm të risistemuar brenda një viti		56.7%	50,90%	46,7%	46,7	Max 48%
	XIIIb) Maturimi mesatar i borxhit të brendshëm		780 ditë	787 ditë	783 ditë	783	792 - 864 ditë
XIV) Rritet efikasiteti dhe transparencja e sistemit të prokurimit	XIVa) % në vlerë për procedurat e përfunduara me fitues brenda semestrit të parë kundrejt shumës së parashikuar në regjistrin e parashikimeve		22% (2018)	49,80%	(tendencë në rritje)	47,4%	(tendencë në rritje)
	XIVb) Përqindja e rasteve kur organi i shqyrtimit nuk ka respektuar afatet kohore të shqyrtimit të rastit		54.7%	16%	≤ (t-1) (tendencë në rritje)	22,10%	≤ (t-1) (tendencë në ulje)

Ecuria gjatë vitit 2020

Komponenti 4.1 Zgjerimi i përdorimit të SIFQ-së

Objektivat e produkteve të lidhura me integrimin e SIFQ-së me sisteme të tjera qeveritare janë arritur pjesërisht. Ndërfaqja me Sistemin e Menaxhimit Doganor nuk ka përfunduar, për shkak të bashkëpunimit të pamjaftueshëm nga ana e DPD, ndërkohë që ka pasur një ecuri shumë të mirë në përdorimin e WebPortal-it për arkivën elektronike deri në maj të vitit 2020. Disa probleme teknike me performancën e SIMFSH ndaluan procesin e nisjes së përdorimit. Megjithatë, 110 nga 1100 IB të reja patën akses tek WP për arkiv elektronik. Pjesa tjetër e IB-ve do të regjistrohet gjatë vitit 2021, menjëherë pas përmirësimit të harduerit SIMFSH. Për sa i përket integritetit të SIFQ-së me SIMBNJ, testimi i ndërfaqes u përfundua me sukses gjatë vitit 2020. Planet do të hyjnë në fuqi gjatë gjysmës së dytë të vitit 2021. Është rishikuar baza ligjore e SIMBNJ dhe është marrë vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 833 datë 28.10.2020 “Për rregullat e detajuara për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit dhe të regjistrimit qendror të personelit” është miratuar.

Komponenti 4.2: Kontrollat e angazhimeve shumëvjeçare dhe detyrimeve

U arritën të gjitha objektivat për regjistrimin e kontrolleve të angazhimeve, detyrimet, përfshirë detyrimet e prapambetura gjatë vitit 2020. Me urdhër të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, datë 21 korrik 2020, është krijuar një Grup Pune për Monitorimin e Detyrimeve të Prapambetura (GPMDP) për monitorimin e detyrimeve të prapambetura të enteve të qeverisjes së përgjithshme, ka zhvilluar dy takime për periudhën raportuese. GPMDP-ja e ngarkuar për monitorimin e zhvillimit të detyrimeve të prapambetura dhe bazuar në Raportin e Detyrimeve (Mujore) ka dhënë rekomandime sistematike për menaxhim më të mirë të çështjes së detyrimeve të prapambetura. Të gjitha njësive të auditimit të brendshëm iu kërkua të përfshinin në planin vjetor një auditim të detyrimeve të prapambetura. Rreth 67 njësi auditimi kanë raportuar gjetjet dhe rekomandimet e tyre për detyrimet e prapambetura për vitin 2020. NJQH dhe AT-ja e Projektit në bashkëpunim me KLSH-në kanë përgatitur një projekt - Udhëzues për auditimin e detyrimeve të prapambetura, i cili do t'i ndihmojë audituesit të kryejnë më mirë auditimet e tyre në fusha me risk të lartë. Mjedisi i dobët i kontrollit (në veçanti zbatimi i kontrollit) në të gjitha subjektet, veçanërisht në njësitë e qeverisjes vendore, ishin shkaku kryesor i krijimit të detyrimeve të prapambetura. Gjetjet e AB në lidhje me

detyrimet e prapambetura do të paraqiten në raportin vjetor¹² të KBFP 2020 dhe në Bordin e KBFP në maj 2021.

Komponenti 4.3: Menaxhimi i borxhit dhe i likuiditetit

DP-ja e Thesarit ka punuar për të përmirësuar parashikimin e likuiditetit dhe 2 nga 3 rezultatet e objektivave janë përmbushur me sukses. Parashikimi i fluksit monetar përgatitet për vitin dhe përditësohet në bazë të hyrjeve dhe daljeve aktuale të parasë si më poshtë: i) ditor, bazuar në informacionin e Bankës së Shqipërisë; dhe ii) mujor, bazuar në parashikimet e përditësuar të fondeve të veçanta dhe realizimin e të dhënave të treguesve fiskalë të konsoliduar. Misionet nga BB dhe FMN kanë dhënë disa rekomandime për të përmirësuar më tej sistemin e parashikimit të parasë dhe shumë prej tyre janë trajtuar siç duhet gjatë vitit 2020, me përjashtim të trajnimit të personelit financiar të 5 IB-ve të përzgjedhura (DPT dhe DPD që përfaqësojnë 89% të të ardhurave totale, Ministria të Arsimit dhe Ministrisë së Bujqësisë dhe Bashkisë së Tiranës, që përfaqësojnë 22% të totalit të shpenzimeve) të cilat nuk mund të mbaheshin për shkak të pandemisë COVID-19.

Drejtoria e Përgjithshme e Borxhit (DPB) miratoi dhe publikoi Strategjinë e Menaxhimit të Borxhit 2021-2023¹³ në fillim të vitit 2021. Programi vjetor i huamarrjes nuk mund të miratohej siç ishte planifikuar për shkak të sfidave të rëndësishme me të cilat u përball departamenti i borxhit me instrumentet e reja të emetuara gjatë pandemisë COVID-19, rritjen e kërkesës për likuiditet dhe qarkullimin e personelit.

Të dy objektivat vjetorë të përcaktuar nga DPB në lidhje me zgjerimin e tregut parësor dhe dytësor u arritën. Emetimet e tregut parësor u përmirësuan si pasojë e rritjes së fleksibilitetit të huamarrjes së brendshme. Është bërë analiza e sjelljes së tregjeve të brendshme dhe të jashtme të huamarrjes për të siguruar financim në kohë.

Komponenti 4.4: Prokurimi publik

Agjencia e Prokurimit Publik (APP) ka shfaqur një ecure të konsiderueshme në rishikimin e LPP-së për harmonizim me direktivat e BE-së. Në veçanti, një ligj i ri për prokurimet publike¹⁴ është miratuar në parlament në 24 dhjetor 2020 dhe ka nisur puna për hartimin e legjislacionit dytësor.

Objektivat e Komisionit të Prokurimit Publike (KPP) për të ofruar mbrojtje ligjore për tenderët dhe interesat publik në të gjitha fazat e prokurimit publik për vitin 2020 janë përmbushur. Struktura e KPP-së u miratua nga Kuvendi¹⁵ në tetor 2020, procesi i ristrukturimit përfundoi në dhjetor 2020 dhe u plotësuan pozicionet e kryetarit të KPP-së, Sekretarit të Përgjithshëm, katër inspektorëve dhe shtatë punonjësve të tjerë. Po finalizohet sistemi i apelimit elektronik të KPP-së, i cili konsiston në krijimin e një sistemi të menaxhimit të ankesave. Për më tepër, KPP ka organizuar shtatë sesione të veçanta trajnimi në bashkëpunim me SIGMA-OECD, ASPA, MFE, OCP, duke u fokusuar kryesisht në sfidat e reja të KPP.

Agjencia e Prokurimit Publik ka vazhduar punën për përmirësimin e mëtejshëm të sistemit të prokurimit elektronik (SPE). Në veçanti, kërkesat funksionale për përmirësimin e sistemit janë përfunduar gjatë vitit 2020 dhe disa ndryshime në SPE janë bërë tashmë. Megjithatë, pritet të bëhen ndryshime të mëtejshme në sistem për të akomoduar kërkesat e LPP-së të ndryshuar. Me ndryshimet e SPE janë ndryshuar gjithashtu edhe manualët dhe udhëzimet e përdoruesit.

Gjatë vitit 2020 janë marrë masa për forcimin e kontrolleve të angazhimit dhe shpenzimeve për të parandaluar akumulimin e detyrimeve të reja të prapambetura. Ndërfaqja e SIFQ dhe SPE u krijua në vitin 2020 dhe kontrolli online i fondeve në dispozicion mund të kryhej përpara se të fillonte çdo procedurë prokurimi.

¹² <https://financa.gov.al/raportet-vjetore/>

¹³ <https://www.financa.gov.al/wp-content/uploads/2021/02/Strategjia-Afatmesme-e-Menaxhimit-te-Borxhit-2021-2023-FINAL.pdf>

¹⁴ Ligji 162/2020 "Për prokurimin publik"

¹⁵ Vendimi nr. 65/2020, datë 29.10.2020

Komponenti 4.5: Menaxhimi i fondeve të jashtme

Popullimi i Sistemit të Menaxhimit të Informacionit me të dhënat nga fondet e jashtme nuk është përmbushur sipas planit gjatë vitit 2020. Sistemi do t'i mundësojë të gjithë grupeve të interesit lehtësi në hedhjen e të dhënave, analizat dhe raportet, në mënyrë që të zvogëlohen përpjekjet dhe kostot e transaksionit në mbledhjen dhe analizimin e të dhënave. Gjatë vitit 2020, të dhënat e ndihmës së jashtme të viteve 2017 dhe 2018 janë regjistruar pjesërisht. MFE ka rritur ndërgjegjësimin e komunitetit të Partnerëve për Zhvillim mbi rëndësinë e përfshirjes së tyre për të populluar SIMAJ. Gjatë vitit 2021 do të bëhen përpjekje për të populluar të dhënat e BE-së dhe të partnerëve të tjerë për zhvillim.

Komponenti 4.6: Forcimi i rolit të ndihmës shtetërore


Është përmirësuar kuadri rregullator për ndihmën shtetërore, por zbatimi nuk është bërë sipas planit. Bazuar në urdhrin e Kryeministrit¹⁶, Për shkak të kufizimeve të lidhura me COVID-19, u mbajt vetëm një mbledhje e grupit ndërmënor të punës për ndihmën shtetërore nga dy të planifikuara. Qëllimi i takimit ishte (a) koordinimi i konsultimeve paraprake për projekt-aktet ligjore për të vlerësuar përputhshmërinë me rregullat e ndihmës shtetërore dhe (b) përditësimi i grupit ndërmënor të punës për procesin e menaxhimit të ndihmës shtetërore.

Të gjithë objektivat që synonin të kishin një bazë të dhënash për monitorimin e zbatimit të skemave të ndihmës shtetërore u përmbushën. MFE-ja ka punuar në përmirësimin e bazës së të dhënave të skemave të ndihmës shtetërore. Për vitin 2019¹⁷ u përgatit një raport për ndihmën shtetërore bazuar në informacionin e dhënë nga dhuruesit e skemave të ndihmës shtetërore. Në raport paraqitet informacion për objektivat kryesorë të përmbushur për Ndihmën Shtetërore në Shqipëri, si edhe për instrumentet kryesore të përdorur gjatë periudhës 2015-2019. Instrumentet kryesore të ndihmës shtetërore në Shqipëri gjatë vitit 2019 ishin grantet dhe përjashtimet nga taksat, rimbursimet ose uljet e normës së taksave. Komisioni i Ndihmës Shtetërore ka aprovuar vetëm shtatë nga dhjetë vendime të parashikuara për vitin 2019.

Objekti i përcaktuar për vitin 2020 për të rritur ndërgjegjësimin për rolin dhe detyrat e Komisionit të Ndihmës Shtetërore u përmbush. Publiku u informua për tre skema të reja ndihme, përkatësisht “Ndihma shtetërore për projektin TAP”, “Mbështetje financiare (Grant) për bizneset e reja të Gjellbërta “Go Green” dhe “Për Fuqizimin e të Rinjve”, ndërsa synimi ishte që të kishte të paktën dy njoftime. Të gjitha skemat e reja të ndihmës shtetërore janë publikuar në Fletoren Zyrtare.

Përmbledhje e ecurisë së produkteve të objektivave për objektivin specifik 4

Grafiku 4: Statusi i vlerave të synuara të produkteve për vitin 2020



¹⁶ Urdhri i Kryeministrit nr. 128, datë 1.10.2019 “Për ngritjen e Grupit të Punës për Ndihmën Shtetërore”.

¹⁷ <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2020/07/08/534/c85f75d0-1679-4256-84fd-d7c6aa260748;q=raporti%20vjetor%202019%20ndihma%20shtetere>

Risqe kyçe

Sipas këtij objektiwi specifik, komponenti kryesor sfidë lidhet me zgjerimin e përdorimit të SIFQ-së në Institucione të tjera Buxhetore, sepse mungesa e burimeve të duhura financiare dhe njerëzore mund të rrezikojë zbatimin e suksesshëm të tij. Marrja e një ndihme të jashtme funksionale është parë e një rëndësie të madhe për trajtimin e këtyre vështirësive. Aktivitetet që synojnë zbatimin e regjistrimit të zotimeve, përfshirë detyrimet e prapambetura mund të ndikohen nga vonesat në miratimin e ndryshimeve rregullatore dhe prokurimet e TI-së, megjithatë këto rreziqe të mundshme klasifikohen si të moderuara nga drejtuesit dhe do të monitorohen nga afër gjatë vitit. Për sa i përket menaxhimit të borxhit dhe parasë, koordinimi i pamjaftueshëm ndërmjet aktorëve të ndryshëm të përfshirë mund të ndikojë shumë në arritjen e rezultatit të dëshiruar, prandaj, ndërtimi i një rutine të rregullt komunikimi mund të krijojë mjedisin e duhur për vendimmarrje. Edhe në këtë komponent janë identifikuar dy risqe të moderuara, që janë: mungesa e burimeve financiare dhe njerëzore, por drejtuesit janë të përkushtuar t'i monitorojnë nga afër këto rreziqe. Janë identifikuar tre risqe të moderuara që mund të pengojnë rritjen e efikasitetit dhe transparencës së sistemit të Prokurimit Publik, si mungesa e burimeve financiare, vonesat në miratimin e kuadrit rregullator dhe prokurimi i TI-së. Plotësimi i SIMAJ me të dhëna për fondet e jashtme mund të jetë me risk të moderuar për shkak të mungesës së stafit, aftësive të TI-së dhe koordinimit të papërshtatshëm. Së fundi, forcimi i rolit të Ndihmës Shtetërore mund të ndikohet nëse nuk punësohen burime njerëzore të përshtatshme (aktualisht ky risk konsiderohet i moderuar).

3.5 Ecuria për objektivin specifik 5

Forcimi i sistemeve dhe kapaciteteve për të përgatitur statistika financiare të qeverisë në përputhje me standardet ndërkombëtare ka qenë fokusi kryesor që kur është publikuar strategjia. Gjatë vitit 2017, për herë të parë INSTAT plotësoi dhe transmetoi të dhënat e Statistikave Financiare të Qeverisë (SFQ) në përputhje me kërkesat e Sistemit Evropian të Llogarive (SELL), programi i transmetimit 2010. Grupi i Punës ndërmintor (INSTAT, MFE-ja dhe Banka e Shqipërisë) përfundoi listën e Njësive të Qeverisjes të Përgjithshme në përputhje me MSFQ-në 2014 dhe SELL-in 2010, dhe gjatë vitit 2019 zhvilloi me sukses sisteme shkëmbimi të dhënash duke synuar krijimin e një sistemi statistikor të qëndrueshëm për Njësitë e Qeverisjes të Përgjithshme. Megjithatë, për shkak të kufizimeve të lidhura me COVID-19, si automatizimi i sistemit të përpilimit të buxhetit të qeverisë ashtu edhe Tabela 1100 - Mbi shpenzimet e përgjithshme të qeverisë sipas funksioneve, nuk mund të përfundonin plotësisht dhe të zgjeroheshin siç ishte planifikuar. Një dokument i rëndësishëm¹⁸ që synon të përmirësojë respektimin e parimit të dyfishtë të përafrimit midis fushave statistikore në nivel kombëtar dhe të bashkërendimit të koordinuar midis vendeve në nivel BE-je u publikua nga INSTAT gjatë vitit 2020.

Sipas Anketës së Buxhetit të Hapur të vitit 2017, që nga viti 2015 Shqipëria ka rritur (a) disponueshmërinë e informacionit buxhetor të dhënë në Raportin e Auditimit dhe Pasqyrën e Para-Buxhetit, dhe (b) numrin e raporteve të publikuara të ekzekutimit të buxhetit. Gjithashtu, procedurat për zbatimin e buxhetit të “gjatë vitit” janë përmirësuar dhe për herë të parë në faqen e internetit të MFE-së¹⁹ në vitin 2017 u publikuan: Raporti i Mesit të Vitit Performancës Makroekonomike, Fiskale dhe Buxhetore të qeverisë. Shqipëria u përmirësua pak më tej në Anketën e Buxhetit të Hapur të 2019 pasi ka publikuar edhe Rishikimin e Mes-vitit në internet. Modelet dhe përmbajtja e raporteve të ekzekutimit të buxhetit vjetor dhe atij brenda vitit të qeverisë u rishikuan gjatë vitit 2019. Seancat në punë me menaxherët e programit dhe departamentet e financave të dy ML-ve me qëllim përmirësimin e modeleve të ekzekutimit të buxhetit vjetor dhe brenda vitit

¹⁸ Politika Rishikuese të Harmonizuara për Statistikat Makroekonomike

¹⁹ <http://www.financa.gov.al/raporti-i-mes-vitit-mbi-zbatimin-e-buxhetit-2017/>

u zhvilluan në vitin 2020. Për më tepër, SIMFSH është shpërndarë në të gjitha ministritë e linjës dhe institucionet buxhetore dhe të dhënat përkatëse janë ngarkuar në sistem.

MFE-ja është asistuar nga nisma BOOST, një mjet i Bankës Botërore që i jep akses në të dhënat e buxhetit dhe nxit përdorimin efektiv për procese të përmirësuara vendim-marrëse, transparencë dhe besueshmëri. Duke filluar që prej vitit 2015, Ligji Buxhetor Vjetor²⁰ u formulua në një mënyrë më transparente dhe të kuptueshme dhe u publikua “Buxheti me një Vështrim” dhe një version i thjeshtësuar i “Buxheti i Qytetarëve”. Gjatë vitit 2020 u përgatit dhe u zbatua një kalendar me proceset kyçe të buxhetit. Gjithashtu, gjatë vitit 2019 dhe 2020 u përpunua dhe u publikua një Manual për Buxhetin e Qytetarëve. U kryen gjithashtu trajnime për OShC-të për të nxitur kapacitetet e tyre për të kuptuar ciklin e buxhetit.

Në lidhje me kontabilitetin, u krye një analizë hendeke, e cila krahasonte kuadrin aktual rregullator të kontabilitetit me SNKSP-të, në mënyrë që të merren masat e duhura për zbatimin e kontabilitetit mbi bazë të drejtash dhe detyrimesh të konstatuara. Bazuar në analizën e hendekut, qeveria miratoi një Plan Veprimi Strategjik për vendin për kalimin në SNKSP në muajin tetor 2019. Gjithashtu, u krijua një funksion specifik brendaDPH/KBFP-së i dedikuar kontabilitetit, përgjegjës për përditësimin e metodologjisë së kontabilitetit në sektorin publik si edhe të akteve ligjore dhe nënligjore në sektorin privat. Zhvillimi i metodologjisë dhe udhëzimet për njohjen dhe vlerësimin e aktiveve nuk u përfundua siç ishte planifikuar për vitin 2020, ndërkohë që regjistrimi i aktiveve në SIFQ ka pasur ecuri sipas planit.

Për të përmirësuar mbulimin, cilësinë dhe mundësinë për të përdorur informacionin në financat publike, u kryen përpjekje (i) për të fuqizuar sistemet dhe kapacitetet për të përgatitur statistika financiare të qeverisë në përputhje me standardet ndërkombëtare; ii) për të ofruar mundësi formale për publikun për t'u angazhuar në procesin e buxhetit; dhe (iii) përgatitja e një regjistri të plotë të aktiveve. Nuk ka ecur sipas planit treguesi i performancës i lidhur me kalimin në një bazë të përshkallëzuar për të paraqitur pasqyrat financiare të qeverisë mbi bazë të drejtash dhe detyrimesh të konstatuara.

Gjatë vitit 2020 u përmbushën 75% e vlerave të synuara të treguesve të rezultateve me qëllim forcimin e Transparencës së Financave Publike duke treguar një përmirësim krahasuar me vitin 2019 ku u përmbushën vetëm 60% e tyre. Vlerat e synuara në lidhje me treguesin e performancës nr. XVI, “*Përgjegjshmëria dhe transparenca përmes raportimit të performancës financiare dhe jo financiare është rritur*”, janë ndryshuar gjatë procesit të ndryshimeve të vlerave të synuara të produkteve dhe rezultateve të Strategjisë 2019-2022 si pasojë e pandemisë Covid-19. Ky TP nuk ka vlerë të synuar për vitin 2020, ai do të matet për vitin 2021 i cili do të shërbejë si bazë e re. Tabela e mëposhtme paraqet statusin e TP-ve për OS 5 (nëse statusi i vlerës së synuar është shënuar me të kuqe: nuk përmbushet, nëse me ngjyrë portokalli: është përmbushur pjesërisht, nëse me jeshile: është përmbushur).

²⁰ <http://www.financa.gov.al/buxheti-2016/>

Tabela 5: Rezultate kyçe dhe treguesit e performancës

Rezultati	Treguesi i Performancës	Institucioni Drejtues	Niveli bazë (2018)	Vlerë faktike FY 2019	Vlerë e Synuar FY20	Vlerë faktike FY20	Vlerë e Synuar FY 2021
XV) Fuqizim i sistemeve dhe kapaciteteve për të përgatitur statistikat financiare të qeverisë sipas standardeve ndërkombëtare	XVa) Përgatitja e llogarive kombëtare të qeverisë sipas metodologjisë ndërkombëtare (ESA 2010)	INSTAT	50% (2018)	75%	75%	75%	75%
XVI) Llogaridhënia dhe transparenca me anë të raportimit të performancës financiare dhe jo-financiare është rritur	XVIa) Publikimi i raporteve financiare dhe atyre gjatë vitit përmbajnë informacion për performancën financiare dhe jo-financiare, përfshirë TKP-të.	DMB	janë përgatitur formate të reja për RZVB & gjatë vitit	Po zbatohen formatet e reja	n/a		25%
XVII) Ofrohen mundësi formale për pjesëmarrjen e publikut në procesin e buxhetit	XVIIa) Vlerësimi nga indeksi për Buxhetin e Hapur (Pjesëmarrja e Publikut)	DAPB	2 nga 100 (2017)	7/100	≥ (t-1) (tendencë në rritje)	7 nga 100	≥ (t-1) (tendencë në rritje)
XVIII) 'Prezantimi i pasqyrave financiare sipas kuadrit të përgjithshëm SNKSP	XVIIIa) Kalimi në fazën ku pasqyrat financiare të qeverisë do të paraqesin kontabilitetin në bazë të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara	DHMFKK	0%	0%	≥ (t-1) (tendencë në rritje)	0%	≥ (t-1) (tendencë në rritje)
XIX) Përgatitja e regjistrit të plotë të asetëve të sektorit publik, bazuar në rregulloret e përmirësuara për vlerësimin dhe inventarin e këtyre asetëve	XIXa) Aktivitet publike të regjistruara në SIFQ	DP Thesari	6 (2018)	6	3	3	5

Ecuria për vitin 2020

Komponenti 5.1. Llogaritë Kombëtare të Qeverisë

Njëfarë progresi është bërë gjatë vitit 2020 nga INSTAT në krijimin e një sistemi të qëndrueshëm statistikor për njësitë e qeverisjes së përgjithshme. Dy vlera të synuara të produktit u përmbushën pjesërisht. Kjo ndodhi më së shumti sepse aktivitetet e INSTAT-it vareshin nga mbështetja e Asistencës Teknike, e cila nuk mundi të realizonte aktivitetet e planifikuara për vitin 2020 për shkak të kufizimeve të lidhura me Covid-19. Vlera e parë e synuar lidhej me zhvillimin e "Sistemit të automatizuar të përpilimit të buxhetit të qeverisë". Disa module të sistemit janë testuar gjatë vitit 2020 dhe puna do të vazhdojë deri në fund të vitit 2021 kur pritet që sistemi të nisë funksionimin. Për sa i përket vlerës së dytë të synuar me qëllim integrimin e vlerësimeve COFOG, INSTAT dërgoi në Eurostat "Tabela 1100 - Shpenzimet e qeverisë së përgjithshme sipas funksioneve", duke filluar nga të dhënat e vitit 2017 e në vazhdim, por me sistemin e ri të TI që pritet të funksionojë në fund të vitit 2021, cilësia, saktësia dhe mbulimi i kësaj table do të rritet.

INSTAT publikoi sikurse kishte synuar: "Politikat e Rishikimit të Harmonizuara për Statistikat Makroekonomike"²¹. Qëllimi kryesor i këtij dokumenti ishte të trajtonte shqetësimet e përdoruesve për mungesën e koordinimit të rishikimeve dhe synon të përmirësojë respektimin e parimit të dyfishtë të përafrimit midis fushave statistikore në nivel kombëtar dhe të koordinimit të harmonizuar midis vendeve në nivel të BE-së.

Komponenti 5.2: Raportimi dhe Monitorimi Financiar dhe ai i Performancës

Trajnimi i personelit për raportin e monitorimit të buxhetit ishte vlera e vetme e synuar për vitin 2020, me qëllim përmirësimin e modeleve të raporteve të ekzekutimit të buxhetit vjetor dhe brenda vitit të qeverisë. Gjatë vitit të kaluar ka vazhduar puna për përmirësimin e kapaciteteve monitoruese të buxhetit në nivel Programi. Në janar dhe shkurt 2020 u zhvilluan seanca trajnimi në vendin e punës me menaxherët e programit dhe Departamenteve të Financave të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR) si dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Për më tepër, SIMFSH u shpërnda në të gjitha ministratë e linjës dhe institucioneve buxhetore dhe të dhënat përkatëse janë ngarkuar në sistem.

Komponenti 5.3: Angazhimi i qytetarëve

21 <http://www.instat.gov.al/media/6557/harmonized-revision-policies-for-macroeconomic-statistics.pdf>

Një udhëzues për buxhetin qytetar është hartuar dhe publikuar²² siç ishte planifikuar. Qëllimi kryesor i udhëzuesit është të rrisë angazhimin e qytetarëve, OShC-ve dhe grupeve të tjera të interesit në procesin e buxhetit të qeverisë.

Një kalendar për dëgjesat mbi buxhetin me proceset kyçe buxhetore është përgatitur dhe zbatuar siç ishte planifikuar për vitin 2020. Në këtë drejtim një seri seminaresh online për ngritjen e kapaciteteve me organizatat e shoqërisë civile u iniciuan në fund të vitit 2020. Trajnimet synonin rritjen e kapaciteteve të OShC-ve për të kuptuar buxhetin e shtetit dhe forcimin e kapaciteteve të tyre për të luajtur një rol mbikëqyrës për financat publike. Seria e seminareve filloi me dy seminare të mbajtura përkatësisht në nëntor dhe dhjetor 2020. Seminari i e parë u përqendrua në ciklin buxhetor dhe pikat hyrëse për advokimin e OSHC-ve; ndërsa idyti mbi fazat e ndryshme të kalendarit buxhetor dhe ofrimin e aftësive për vlerësimin e buxhetit sektorial për OSHC-të. Seminaret u mbajtën në distancë, për shkak të kufizimeve të lidhura me Covid-19 dhe niveli i pjesëmarrjes ishte i kënaqshëm (webinar-i i parë: 16 persona nga OShC të ndryshme dhe MFE; webinar-i i dytë: 17 persona). Webinar-ët online mundësuan përfshirjen e një gamë më të gjerë OShC-sh.

Komponenti 5.4: Kontabiliteti

Vlera e synuar që ka për qëllim të përmirësojë kuadrin rregullator të kontabilitetit dhe të zgjerojë SIFQ për të regjistruar të dhënat kontabël të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara u përmbush pjesërisht në vitin 2020. Pjesë e projektit "Zhvillimi i Standardeve të Kontabilitetit të Sektorit Publik në Shqipëri (ZHSKSP)" është rishikimi i akteve ligjore në lidhje me kontabilitetin publik. Për shkak të kufizimeve të COVID-19, rishikimi nuk mund të përfundohej. I njëjti status vlen edhe për vlerësimin mbi zgjerimin SIFQ për të mundësuar regjistrimin e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara i cili nuk është përmbushur sikurse ishte planifikuar.

Plani i zhvillimit të kapaciteteve nuk mund të zbatohet siç ishte synuar. Pas miratimit të Planit Strategjik të Veprimit të Vendit, përmendur më sipër, NJQH përgatiti Termat e Referencës që nevojiten për përzgjedhjen e kompanisë që do të ndihmojë me planin e zhvillimit të kapaciteteve dhe Strategjinë e Arsimit dhe Trajnimit për kontabilistët. Procesi i përzgjedhjes u përfundua dhe të dyja detyrat filluan në vitin 2020, por nuk mund të përfundonin plotësisht siç ishte planifikuar.

Komponenti 5.5: Menaxhimi i aktiveve


Metodologjia për një inventar të plotë të aktiveve publike në institucionet e Qeverisë Qendrore (QQ) nuk u përfundua. Zhvillimi i metodologjisë do të ndërmerret në kuadër të projektit "Zhvillimi i Standardeve të Kontabilitetit të Sektorit Publik në Shqipëri (ZHSKSP)" dhe do të pasojë disa ndryshime në kuadrin ligjor që u hartuan në tremujorin e fundit të vitit 2020. Një draft i parë i metodologjisë tashmë është përgatitur dhe është planifikuar të përfundohet gjatë vitit 2021.

Vlerat e synuara të produktit për vitin 2020 me qëllimin e regjistrimit të plotë të aktiveve publike në SIFQ (për IB-të në sistem) u përmbushën. Tre IB, konkretisht Ministria e Kulturës, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Autoriteti Rrugor Shqiptar kanë futur inventarin e aktiveve në modulën e aktiveve gjatë vitit 2020. Disa trajnime për menaxhimin e aktiveve janë ofruar nga Departamenti i Processimit të Biznesit në MFE për financimin e specialistëve të këtyre IB-ve (6 punonjës personeli në total).

²² <https://www.financa.gov.al/wp-content/uploads/2020/11/CB-2021.pdf>

Përmbledhje e ecurisë për vlerat e synuara të produkteve për objektivin specifik 5

Grafiku 5: Statusi i vlerave të synuara të produkteve për vitin 2020



Risqet kyçe

Sipas këtij objektivi specifik, sfida kryesore lidhet me komponentine Menaxhimit e Aktiveve, sepse mungesa e asistencës teknike mund të ndikojë në arritjen e rezultatit të dëshiruar. Njësia përgjegjëse është në kontakt të vazhdueshëm me donatorët e huaj për të marrë ndihmën e duhur në këtë drejtim. Dy risqe shtesë në kuadër të këtij komponenti, si mungesa e burimeve financiare dhe njerëzore vlerësohen të moderuara, kështu që kërkesat për drejtuesit e lartë për të plotësuar këto nevoja do të bëhen sapo të lindë nevoja. Për sa i përket Kontabilitetit, katër risqe të mundshme të moderuara po identifikohen nga drejtuesit e lartë dhe janë: vonesa në kryerjen e ndryshimeve rregullatore, mungesa e personelit të kualifikuar profesional, prokurimi/afësitë e TI-së, si dhe mungesa e disponueshmërisë së asistencës teknike. Duke qenë se këto risqe mund të bëhen pengesë për të kaluar në pasqyrat financiare të qeverisë bazuar në të drejta dhe detyrime të konstatuara, është planifikuar një monitorim nga afër. Gjithashtu, futja e kontabilitetit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara është një reformë shumë e shtrenjtë dhe afatgjatë, e cila duhet të zhvillohet më tej dhe në periudhën e ardhshme është e nevojshme të kryhet një analizë shtesë kosto-përfitim për kalimin gradual në kontabilitetin e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara. Së fundi, janë identifikuar dy risqe të moderuara që lidhen me forcimin e sistemeve për përgatitjen e statistikave financiare të qeverisë në përputhje me standardet ndërkombëtare, si mosdisponueshmëria në kohë e asistencës teknike dhe koordinimi i pamjaftueshëm. Drejtuesit e lartë janë të vetëdijshëm dhe do të përpiqen të zbusin ndikimin në rast se ndonjë prej këtyre risqeve do të materializohet.

3.6 Ecuria për objektivin specifik 6

Gjatë periudhës 2015-2019, u bënë ndryshime dhe shtesa në ligjet “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, “Për auditimin e brendshëm”, dhe “Për inspektimin financiar publik” si dhe u miratuan një numër aktesh nënligjore në zbatim të legjislacionit parësor. Drejtoria e Harmonizimit për Menaxhimin Financiar, Kontrollin dhe Kontabilitetin (DHMFKK) ka organizuar disa trajnime për të rritur ndërgjegjësimin e nëpunësve të nivelit të lartë dhe drejtuesve mbi rëndësinë e zbatimit të suksesshëm të MFK-së. Për të pasur një sistem të fortë të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, në vitin 2020 u miratuan tre projekt-dokumente të rëndësishme, më konkretisht (1) Dokumenti i Politikave për Zhvillimin e Mëtejshëm të KBFP-së në Shqipëri për periudhën 2021–2022, (2) Udhëzim për delegimin e detyrave dhe (3) Metodologjia për rishikimin e cilësisë së kontrollit të brendshëm. DPHKBFP-ja ka punuar në disa drejtime për të forcuar sistemin KBFP. Si kuadri rregullator i MFK-së ashtu edhe i AB-së janë në rishikim dhe ekzistojnë plane për miratimin e ndryshimeve nëse kërkohet.

Gjatë periudhës 2015-2020 është bërë monitorimi në terren mbi funksionimin e sistemit MFK dhe auditimit të brendshëm në disa institucione buxhetore, si dhe janë organizuar një sërë aktiviteteve për rritjen e kapaciteteve, këshillime dhe vizita studimore.

U krijuan më shumë njësi për auditimin e brendshëm në qeverinë qendrore dhe atë vendore dhe nga fundi i vitit 2020, 77 për qind e audituesve të brendshëm në detyrë, u certifikuan nga Komisioni për Kualifikimin e Audituesve të Brendshëm (KKAB) dhe rreth 12% janë në proces certifikimi (që pritet të përfundojë deri në shtator të vitit 2021). Baza e të dhënave të veçanta për gjetjet dhe rekomandimet e MFK-së dhe AB-së janë krijuar gjatë vitit 2020, të cilat do ta ndihmojnë NJQH-në të analizojë më mirë dhe të raportojë për çështjet sistematike të Bordi të KBFP.

Gjithashtu, për të vendosur një funksion efektiv të inspektimit financiar publik, u zgjodhën inspektorë të jashtëm për të ndihmuar Departamentin e Inspektimit Financiar Publik për të kryer inspektime sipas ekspertizës së kërkuar. Një shqyrtim i listës së inspektimeve të jashtme që synonte zëvendësimin ose punësimin e të rinjve u krye gjatë vitit 2020, por për shkak të pandemisë COVID-19 punësimi nuk u realizua. Nënshkrimi i 17 marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione të ndryshme ndihmoi në forcimin e funksionimit të rrjetit të Shërbimit të Koordinimit Anti-Mashtrim (ShKAM) ndër vite.

Në përgjithësi, të gjithë objektivat e treguesve të rezultateve që synojnë forcimin e sistemit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik në nivel qendror dhe vendor janë përmbytur gjatë vitit 2020, duke treguar një përmirësim në krahasim me vitin 2019 ku vetëm 50% e tyre janë përmbytur, 33% nuk janë përmbytur dhe 17% janë përmbytur pjesërisht. Për të matur shkallën në të cilën sistemet e kontrollit të brendshëm janë zbatuar në praktikë dhe nëse janë rregulluar mekanizmat përgjegjës menaxherial, DPHKBFP-ja ka përgatitur një metodologji vlerësimi për vlerësimin vjetor të institucioneve buxhetore. Bazuar në vlerësimin e kryer për vitin 2020, rezultoi se institucionet buxhetore shënuan respektivisht 2.56 dhe 2.9 nga 4, duke treguar një përmirësim në krahasim me vitin 2019 pavarësisht situatës së krijuar nga pandemia Covid-19. Forcimi i funksionit të auditimit të brendshëm në sektorin publik është në rrugën e duhur ku u arritën të gjithë objektivat e treguesve të rezultateve, duke treguar progres drejt përafrimit të kuadrit të auditimit të brendshëm me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm. Puna drejt krijimit të një Inspektimi Financiar Publik efikas është gjithashtu në rrugën e duhur sepse objektivat u arritën plotësisht në 2020 dhe 2019. Tabela më poshtë paraqet statusin e rezultateve kryesore dhe objektivat e vitit 2020 për treguesit e performancës (nëse statusi i objektivit shënohet *me të kuqe*: do të thotë se nuk është përmbytur, nëse është *portokalli*: do të thotë se është përmbytur pjesërisht, nëse është *jeshile*: do të thotë që është përmbytur).

Tabela 6: Rezultatet kyçe dhe treguesit e performancës

Rezultati	Treguesi i Performancës	Institucioni Drejtues	Niveli bazë (2018)	Vlerë faktike VF 2019	Objektivi i Synuar VF 2020	Vlerë faktike VF 2020	Objektivi i Synuar VF 2021
XX) Llogaridhënie menaxheriale efektive në të gjitha institucionet publike	XXa) Niveli i zbatimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm në praktikë brenda institucioneve buxhetore	DPHKBFP	2.71 nga 4 (Urdhër i Ministrit të Financave nr. 117, datë 01.04.2019 Metodologjia për Monitorimin e Performancës)	2.4	>(t-1) (tendencë në rritje)	2.56	>(t-1) (tendencë në rritje)
	XXb) Mekanizmat për llogaridhënien menaxheriale në kuadrin rregullator	DPHKBFP	2.71 nga 4 (Urdhër i Ministrit të Financave nr. 117, datë 01.04.2019 Metodologjia për Monitorimin e Performancës)	2.5	>(t-1) (tendencë në rritje)	2.90	>(t-1) (tendencë në rritje)
XXI) Forcimi i funksionit të auditimit të brendshëm në sektorin publik	XXIa) % e rekomandimeve të zbatuara të auditimit të brendshëm	DPHKBFP	57% (2018)	60%	>(t-1) (tendencë në rritje)	65%	>(t-1) (tendencë në rritje)
	XXIb) Kuadri për auditimin e brendshëm është harmonizuar me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm	DPHKBFP	Kuadri për auditimin e brendshëm nuk është harmonizuar tërësisht me SNAB	Rishikimi i Manualit për AB	Është kryer analiza e boshllëqeve	Është kryer analiza e boshllëqeve	Kuadri ligjor është përditësuar
	XXIc) % e rekomandimeve bazë për sistemin që janë adresuar kundrejt numrit total të gjetjeve	DPHKBFP	35% (2018)	37%	>(t-1) (tendencë në rritje)	42%	>(t-1) (tendencë në rritje)
XXII) Inspektim Financiar Publik efikas	XXIIa) % e rekomandimeve të zbatuara të inspektimit financiar (të nxjerra me urdhër të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë)	DIFP	VF 18 70%	83.30%	>(t-1) (tendencë në rritje)	85%	>(t-1) (tendencë në rritje)

Ecuria për vitin 2020

Komponenti 6.1: Menaxhimi financiar dhe kontrolli në të gjitha institucionet publike

DHMFKK ka arritur të gjitha objektivat duke synuar krijimin e një sistemi më të fortë të menaxhimit financiar dhe mjedisit të kontrollit të brendshëm. Dokumenti i Politikave²³ “Për zhvillimin e mëtejshëm të KBFP në Shqipëri për periudhën 2021–2022” dhe udhëzimi “Për delegimin e detyrave të punonjësve në njësitë e sektorit publik”²⁴ u miratuan gjatë vitit 2020. Dokumenti i Politikave do të shërbejë si një mjet për t’u përdorur nga entitetet publike për një menaxhim transparent dhe të përgjegjshëm të fondeve të brendshme dhe të huaja, ndërsa udhëzimi i ri i miratuar ka pasur si qëllim kryesor përcaktimin e rregullave dhe procedurave që duhen ndjekur në procesin e delegimit të detyrave. Organi qeverisës institucional për monitorimin e zbatimit të planit të veprimit të dokumentit të politikave do të jetë Komiteti Teknik dhe Komiteti Drejtues i MFP-së. Disa aktivitete të përfshira në planin e veprimit të dokumentit të politikave kanë filluar gjatë vitit 2020. Lidhur me rishikimin e bazës ligjore të MFK-së, një vlerësim i statusit aktual të sistemit të menaxhimit të riskut në disa institucione të përzgjedhura (MFE, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve) u krye në bashkëpunim me Asistencën Teknike të MFP. Gjetjet dhe rekomandimet e rishikimit do të shërbejnë si një bazë e mirë për të hartuar rrugën e ndryshimeve ligjore të MFK-së.

DHMFKK ka miratuar metodologjinë për vlerësimin e cilësisë së kontrollit të brendshëm me qëllim krijimin e sistemeve funksionale në fushën e kontrollit të brendshëm. Gjendja e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësive të sektorit publik do të analizohet dhe vlerësohet me hollësi dhe në bazë të kësaj metodologjie do të dalin rekomandime për trajtimin e mangësive të evidentuara. Programi i trajnimit për zbatimin e kërkesave ligjore për MFK-në si dhe për zhvillimin e mëtejshëm të sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike është përgatitur dhe diskutuar në Bordin e KBFP-së deri në fund të vitit 2020.

²³ Urdhër i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 305, datë 18.12.2020

²⁴ <https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2020/01/Udhhezimi-nr.4-date-29.01.2020-Per-delegimin-e-te-drejtave-dhe-detyrave-ne-njesite-e-qeverisjes-se-pergjithshme.pdf>

Programi do të përdoret për trajnimet e ardhshme sipas nevojave dhe kërkesave të institucioneve për ngritjen e kapaciteteve.

Të gjithë objektivat e përcaktuar për vitin 2020 për forcimin e sistemit të monitorimit në fushën e KBFP-së u përmbushën. Janë krijuar baza të veçanta të dhënash për gjetjet dhe rekomandimet e MFK dhe AB. Informacioni i mbledhur në mënyrë të strukturuar do të ndihmojë NJQH-në që të analizojë dhe raportojë më mirë për çështjet sistematike të Bordit të KBFP-së dhe t'i ndjekë ato lehtësisht në kohën e duhur.

Komponenti 6.2: Auditimi i brendshëm

Dy objektivat e synuara të produktit për të përmirësuar funksionin e AB në të gjitha njësitet e qeverisjes së përgjithshme janë përmbushur. Pas analizës së Hendeqeve ndërmjet kuadrit ligjor të AB në Shqipëri krahasuar me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm (SNAB) të kryera gjatë vitit 2019, është rishikuar Manuali i AB në janar 2020. Arsyeja kryesore e ndryshimit lidhej me domosdoshmërinë për të përmirësuar cilësinë e raporteve të auditimit të brendshëm. Më tej, ndryshimet në Ligjin për AB janë diskutuar edhe në mbledhjet e Bordit të KBFP. Ndryshimet do të konsistojnë në: (a) sqarimin e mënyrave se si do të organizohet shërbimi i auditimit në njësitet publike që plotësojnë kriteret për ngritjen e njësive të AB-së, por që nuk kanë kapacitet për auditues të brendshëm; (b) rregullimin e termave të marrëveshjeve dhe kontraktimit të shërbimit të AB nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë; (c) kriteret për punësimin e audituesve dhe drejtuesve të auditimit të brendshëm; (d) të drejtat dhe përgjegjësitë e drejtuesve të njësive të auditimit që synojnë të sigurojnë përputhjen me kërkesat e standardeve të AB; (e) kriteret për çdo njësi publike që ka një njësi të dedikuar të AB për krijimin e Komitetit të AB; (f) statusin e Komisionit të Kualifikimit të AB.


Dy objektivat e synuara të produktit për rritjen e kontributit të AB-së në përmirësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, u përmbushën. Siç u raportua nga njësitet për auditimin e brendshëm, gjatë vitit 2020, audituesit vlerësuan përshtatshmërinë dhe efektivitetin e sistemeve të kontrollit të brendshëm duke u fokusuar në: (a) menaxhimin financiar të sistemit në tërësi b) nxjerrjen e rekomandimeve për të përmirësuar efektivitetin e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe (c) monitorimin e statusit të rekomandimeve të nxjerra. Më shumë se 9,200 gjetje u identifikuan në lidhje me dobësitë e sistemit dhe rekomandime të përshtatshme në lidhje me MFK u raportuan në Bordin e KBFP në Raportin Vjetor të vitit 2020.

Komponenti 6.3: Inspektimi financiar publik

Gjatë vitit 2020, për të rritur rolin e inspektorëve financiarë, u organizuan trajnime sipas planit. U krye një Vlerësim për Nevojat për Trajnim në tremujorin e parë të vitit 2020 u organizuan module të posaçme për “Prokurimi dhe menaxhimi i kontratave në zbatimin e projektit”, “Auditimi i procedurave të prokurimit të kontratave me fondet e BE-së”, “Kontratat e Partneritetit Publik Privat në infrastrukturën publike”. 63% e inspektorëve të brendshëm financiarë morën pjesë në këto module, pasi MFE nuk mundi të përfundonte rishikimin e listës së inspektorëve të jashtëm financiarë gjatë vitit 2020.

Përmbledhja e ecurisë së vlerave të synuara të produkteve për Objektivin Specifik 6

Grafiku 6: Statusi i vlerave të synuara të produkteve për vitin 2020



Risqet kyçe

Për këtë Objektiv Specifik, nuk ka asnjë komponent të ekspozuar ndaj risqeve të larta. Sipas vlerësimit të drejtuesve, komponenti që lidhet me forcimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit në të gjitha institucionet buxhetore është i ekspozuar ndaj disa risqeve të moderuara, si vonesa në miratimin e ndryshimeve rregullatore, mungesa në kohë e asistencës teknike ose mungesa e koordinimit. Dy komponentët e tjerë janë të ekspozuar secili ndaj një risku të moderuar, siç është mungesa e personelit për komponentin e auditimit të brendshëm dhe risku që trajnimet të mos jenë të qëndrueshme për një inspektim financiar. Monitorimi i afërt i risqeve të identifikuara është planifikuar gjatë zbatimit të Planit të Veprimit të Strategjisë.

3.7 Ecuria për Objektivin Specifik 7

KLSH-ja miratoi disa Standarde të reja Ndërkombëtare për Institucionet Supreme të Auditimit, të cilat sollën kalimin nga auditimet e përputhshmërisë në ato financiare dhe të performancës. Një metodologji e re për planifikimin e veprimtarisë së auditimit u aprovua në vitin 2019 dhe u përgatit dhe një manual për Sigurimin e Cilësisë që përmbush standardet SNISA 40. Ngritja e kapaciteteve dhe zhvillimi profesional i stafit të auditimit ishte një nga objektivat strategjikë të KLSH-së dhe çdo auditues ka marrë mesatarisht 25- 28 ditë trajnim gjatë periudhës së viteve 2015 - 2020, për t'i ndihmuar ata të thellojnë njohuritë e tyre në lidhje me auditimin financiar, të performancës dhe auditimin e TI-së si dhe qasjet e tjera të auditimit tematik.

Një ligj i ri “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”²⁵ u aprovua në vitin 2014 nga Parlamenti. Qëllimi kryesor i tij ishte të rregullonte funksionimin, pavarësinë financiare dhe operacionale, mandatin dhe organizimin e Organizatës si dhe të përafronte disa prej kërkesave nga Standardet Ndërkombëtare për Institucionet Supreme të Auditimit si përdorimi i auditimeve financiare dhe/ose të performancës. Si rezultat, KLSH-ja adoptoi qasje të reja audituese dhe u përgatitën e u përditësuan metodologji dhe udhëzime të përshtatshme. U miratuan manuale për auditimin e përputhshmërisë, financiare,

²⁵ Ligji nr.154, datë 21 nëntor 2014

të performancës dhe TI-së deri në fund të vitit 2015, të cilat u rishikuan dhe u amenduan edhe gjatë vitit 2020.

Komunikimi dhe angazhimi me Parlamentin, qeverinë, mediat dhe qytetarët u përmirësua me zbatimin e Strategjive të Zhvillimit të KLSH-së dhe Kodit të ri të Etikës. Hapat për të trajtuar shqetësimet në lidhje me uljen e shkallës së zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, janë ndjekur përmes një rregulloreje parlamentare që synon të sigurojë një mekanizëm më efektiv për monitorimin e zbatimit të gjetjeve, megjithëse nevojitet punë e mëtejshme. Ndër të tjera, u krijua një Sekretariat i Përbashkët me anëtarët e KLSH-së dhe MFE me qëllim gjetjen e mënyrave për të përmirësuar shkallën e zbatimit të rekomandimeve nga ana e KLSH-së dhe e auditimit të brendshëm. Që prej ngritjes së tij në vitin 2019, Sekretariati i përbashkët mbledhet çdo tremujor.

Si përfundim, janë përmbushur të gjitha objektivat e synuara, të vendosura për të rritur efektivitetin e mbikëqyrjes së jashtme të financave publike, si dhe rritjen e vlerave dhe përfitimeve për shoqërinë, për vitet 2019 dhe 2020. Vlera e synuar për vitin 2020 për TP “% e rekomandimeve të auditimit të pranuar dhe të zbatuara nga të audituarit” u vendos gjatë rishikimit të Planit të Veprimit të MFP-së në vitin 2020, ndërsa për TP-në e dytë u vendos të fokusohet më shumë në proporcionin e auditimeve financiare (auditim financiar i pastër + auditim i kombinuar) dhe auditimet e performancës, ndryshe nga viti 2019 ku fokusi ishte rënia e trendit të auditimit të përputhshmërisë. Tabela më poshtë tregon statusin e rezultateve kyçe dhe objektivave të synuara për vitin 2020 për treguesit e performancës (nëse statusi i objektivit shënohet *me të kuqe*: do të thotë se nuk është përmbushur, nëse është *portokalli*: do të thotë se është përmbushur pjesërisht, nëse është *jeshile*: do të thotë që është përmbushur)).

Tabela 7: Rezultatet kyçe dhe treguesit e performancës

Rezultati	Treguesi i Performancës	Institucioni Drejtues	Niveli bazë (2018)	Vlerë faktike VF 2019	Objektivi i Synuar VF 2020	Vlerë faktike VF 2020	Objektivi i Synuar VF 2021
XXIII) Përmirësimi i mëtejshëm i auditimit të jashtëm për të rritur sa më shumë vlerat dhe përfundimin e tij në shoqëri	XXIIIa) % e rekomandimeve të auditimit të pranuar dhe të zbatuara nga subjektet e audituara	KLSH	R acc 2017 = 93% R impl 2017 = 50,5 %	R acc 2018= 95% R impl 2018= 52.2 %	R acc: ≥ 75% R impl: ≥ 40%	R acc:94% R impl:47%*	R acc: ≥ t-1 (tendencë në rritje) R impl: ≥ t-1 (tendencë në rritje)
	XXIIIb) Ndarja e auditimeve financiare (audit financiar i pastër + audit i kombinuar) dhe audit performance		Audit Financiar (9%) Audit Performance (10%) (2017)	42% audit përputhshmërie	AF: 7% AP: 12.5%	AF: 7% AP: 12,5%	AF: ≥ 20% AP: ≥ 14%

*Treguesit janë matur për periudhën janar – dhjetor 2019 pasi shkalla e zbatimit të rekomandimeve matet vetëm 6 muaj pas nxjerrjes së tyre.

Ecuria gjatë vitit 2020

Komponenti 7.1: Auditimi i jashtëm


U përmbushën të gjitha objektivat e synuara për vitin 2020 që synonin të përafronin më shumë qasjet audituese me standardet ndërkombëtare. *Pikë së pari*, u përgatit plani vjetor i auditimit bazuar në metodologjinë e rishikuar “Metodologjia strategjike dhe planifikimit vjetor për aktivitetin auditues bazuar në risk”. Si rezultat, gjatë planifikimit të auditimeve të përputhshmërisë dhe auditimeve financiare, sfera e auditimit u përcaktua bazuar në risk, materialitetin e fondeve të përdorura, rezultatet e auditimit të mëparshëm dhe kështu me radhë, ndërsa gjatë planifikimit të auditimit të performancës, ndikimi në mirëqenien publike dhe rëndësinë e subjektit / objektit, u mor në konsideratë edhe opinioni publik. *Së dyti*, gjatë vitit 2020, stafi i KLSH-së u angazhua në rishikimin dhe ndryshimin e kuadrit rregullator të institucionit, siç ishin: rishikimi i manualeve të auditimit të pajtueshmërisë, atij financiar dhe auditimit të performancës; ndryshimi i Rregullores së Auditimit dhe përgatitja e një manuali të ri “Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve dhe Regjistrin Institucional të Rekomandimeve”, i cili u miratua nga Kryetari i KLSH-së më 26 qershor 2020. *Së treti*, audituesit e KLSH-së, përfshirë të sapo punësuarit, kanë kryer mesatarisht 28.5 ditë trajnime. Trajnimet u organizuan si brenda institucionit, ashtu edhe jashtë tij. Temat

kryesore të trajnimeve ishin Standardet Profesionale të Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (ONISA), manualët dhe udhëzimet e auditimit që janë në fuqi në lidhje me menaxhimin financiar, kontrollin e brendshëm dhe auditimin e brendshëm në sektorin publik, për Energjinë e Qëndrueshme, Anti-korrupsionin dhe Integritetin, mbi auditimin e çështjeve që lidhen me pandeminë e Covid-19, për raportimin jofinanciar dhe raportimin e integruar në sektorin publik, si dhe për masat parandaluese kundër Covid-19.

KLSH-ja ka punuar për të përmbushur të gjitha objektivat e synuara, të vendosura për vitin 2020, për të rritur ndikimin e auditimit përmes komunikimit më të mirë me të gjitha palët e interesit. Objektivi i parë i synuar ka të bëjë me operacionalizimin e Memorandumit të Mirëkuptimit (MM) ndërmjet KLSH-së dhe MFE përmes krijimit të një sekretariati të përbashkët. Gjatë vitit 2020 është miratuar një plan i bazuar në aktivitete dhe janë përfunduar të gjitha aktivitetet e planifikuara. Qëllimi i aktiviteteve ishte: (1) diskutimi dhe miratimi i Planit të Veprimit të Sekretariatit për vitin 2020 dhe miratimi i raportit për zbatimin e Planit të Veprimit të Sekretariatit 2019; (2) diskutimi i gjetjeve të projekt - raportit vjetor të KBFP për vitin 2019 të përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të KBFP-së, si dhe niveli i zbatimit të rekomandimeve të auditimit të brendshëm; (3) diskutim mbi rekomandimet e raportit të ekzekutimit të buxhetit të KLSH; dhe (4) diskutimi mbi Kontabilitetin Publik që do të miratohet në rast të riorganizimit dhe përthithjes së organizatave; diskutimi mbi projekt - Udhëzuesin për detyrimet e prapambetura të auditimit; dhe mbi planin e veprimit të Sekretariatit për vitin 2021. Lidhur me objektivin e dytë të synuar, KLSH-ja i ka dorëzuar një numër raportesh Parlamentit si: (a) Raportin për zbatimin e rekomandimeve të auditimit, (b) Raportin për Performancën Vjetore 2019, dhe (c) Raportin për Zbatimin e Buxhetit të vitit 2019.

Përmbledhje e ecures së vlerave të synuara të produkteve për Objektivin Specifik 7

Grafiku 7: Statusi i vlerave të synuara të produkteve për vitin 2020




Risqet kyçe

Për këtë objektiv specifik ka vetëm një komponent të ekspozuar ndaj risqeve të moderuara që është vonesa në miratimin e Ligjit për KLSH-në. Gjatë zbatimit të Planit të Veprimit të Strategjisë, është planifikuar monitorimi nga afër i këtij risku.


4. Performanca e kategorizuar nga standardet

Gjatë vitit 2020, 75% e objektivave të rezultateve u arritën, 17.5% nuk u arritën dhe 5% u arritën pjesërisht. Për 2.5% të tyre kishte të dhëna të pamjaftueshme për të bërë në një vlerësim. Për OS 6 dhe OS 7 janë përmbushur të gjitha objektivat e planifikuara (100%). OS 1, OS 2, OS 3 dhe OS 5 performuan mirë deri në nivel të kënaqshëm, duke arritur përkatësisht 83%, 63%, 71% dhe 75% të objektivave të planifikuar të rezultateve. Ndërsa për OS 4 u arritën vetëm 57% e objektivave. Ka pasur përmirësim krahasuar me vitin 2019. Gjatë vitit 2019 janë përmbushur 68.3% e objektivave të rezultateve, 22% nuk janë përmbushur dhe 7.3% janë përmbushur pjesërisht.


Treguesit e Performancës së Rezultateve 2020




Treguesit e Performancës së Rezultateve 2019



Statusi i produkteve për 2020





Në nivel produktesh, në vitin 2020 ka një përmirësim krahasuar me vitin 2019. Në vitin 2020 janë përmbushur 62% e produkteve dhe 38% e tyre janë përmbushur pjesërisht. Në vitin 2019, 50% janë përmbushur, 42% janë përmbushur pjesërisht dhe 8% nuk janë përmbushur.

5. Risqet dhe hapat për t'i trajtuar

Për të menaxhuar në mënyrë efektive reformat, si dhe bazuar në përvojën e përftuar gjatë periudhës 2014-2019, është bërë një menaxhim më aktiv i risqeve. Këto mbulojnë jo vetëm ato risqe që lidhen me zbatimin e aktiviteteve brenda kuadrit logjik, por edhe risqe të mundshme në përmbushjen e objektivave të përgjithshme të Objektivave Specifikë dhe komponentëve brenda tyre. Gjatë vitit 2020, disa lloje risqesh që ishin parashikuar dhe përfshirë në dokumentin strategjik, ishin të pranishëm dhe penguan përmbushjen e plotë të rezultateve të planifikuara për atë vit. Gjithashtu, pandemia Covid-19 ka rritur ndikimin e saj negativ në arritjen e objektivave strategjike dhe është bërë pengesa kryesore për ecurinë e tyre, fakt i cili mund të ndikojë dhe të përbëjë risk edhe për vitin 2021. Si rezultat, disa ndryshime janë bërë tek risqet kryesore të mundshme si vijon:

- *Vonesa në kuadrin ligjor/rregullues* fshirë ky risk për komponentët 4.4; 4.5; 5.2;
- *Dispozita të papërshtatshme financiare* shtuar ky risk për komponentin 3.2; 4.1; 4.3; 4.2; 5.2;
- *Trajnimi nuk është i qëndrueshëm* shtuar ky risk për komponentët 2.4; 3.2, 5.2 dhe 6.3 dhe fshirë për 7.1;
- *Burime njerëzore të duhura* shtuar risku për komponentët 1.2; 3.1; 4.5; 5.2; 4.1; dhe 6.3;
- *Prokurimi TI/ aftësitë* shtuar risku për komponentët 2.2, 2.4; dhe fshirë për 5.2;
- *Disponueshmëria e asistencës teknike në kohë* shtuar risku për komponentët 2.2; 3.2; 4.1; dhe 6.1;
- *Koordinim i papërshtatshëm* shtuar risku për komponentët 2.2; 2.3; 2.4; 4.1 dhe 6.1 dhe fshirë për 4.4 dhe 4.6.
- *Pasojat e COVID-19* shtuar risku për komponentët 2.1, 2.4.

Tabela 8: Risqet kyçe të mundshme

	Faktorët e riskut							
	Vonesa në kuadrin ligjor/rregullues	Dispozita të papërshtatshme financiare	Trajnimi nuk është i qëndrueshëm	Burime njerëzore të duhura	Prokurimi TI/ aftësitë	Disponueshmëria e asistencës teknike në kohë	Koordinim i papërshtatshëm	Pasojat nga Covid-19
Objektivi specifik 1 – Kuadër fiskal i qëndrueshëm dhe i matur								
1.1 Rregullat fiskale			U	U				
1.2 Risqet fiskale				L		U	U	
Objektivi specifik 2: Planifikim i mirëintegruar dhe efikas dhe buxhetim i shpenzimeve publike								
2.1 Zhvillimi i politikave dhe qeverisje strategjike	M			M			M	U
2.2 Programi Buxhetor Afatmesëm					U	U	M	
2.3 Planifikimi dhe mbikëqyrja e investimeve publike	M			M			U	
2.4 MFP në qeverisjen vendore			M		M		U	M
Objektivi specifik 3: Administratimi i të ardhurave tatimore dhe doganore								
3.1 Administrata tatimore				U			U	
3.2 Kadastra fiskale e pronave	U	M	M			U		
3.3 Menaxhimi doganor		M		M	U			
Objektivi specifik 4: Zbatimi efikas i buxhetit								
4.1 Zgjerimi i përdorimit të SIFQ-së		M		M		L		
4.2 Kontrollat e angazhimeve shumëvjeçare dhe llogaritë e pagueshme	M				M		M	
4.3 Menaxhimi i borxhit dhe likuiditetit		M		M	U		L	
4.4 Prokurimi Publik	M	M		U	M			
4.5 Menaxhimi i fondeve të jashtme				M	M		M	
4.6 Forcimi i rolit të ndihmës shtetërore				M				
Objektivi specifik 5: Transparenca e financave publike								
5.1 Llogaritë kombëtare të qeverisë						M	M	M
5.2 Monitorimi dhe raportimi financiar dhe i performancës		U	U	U				
5.3 Angazhimi i qytetarëve							U	
5.4 Kontabiliteti	M	U		M	M	M		M
5.5 Menaxhimi i përmirësuar i aseteve		M		M		L		
Objektivi specifik 6: Kontroll i brendshëm efektiv								
6.1 Menaxhimi financiar dhe kontrolli në të gjitha institucionet publike	M				U	M	M	
6.2 Auditimi i brendshëm			U	M				
6.3 Inspektimi financiar publik			M	U				
Objektivi specifik 7: Mbikëqyrje e jashtme efektive e financave publike								
7.1 Auditimi i jashtëm	M							

Vlerësimi i riskut është bërë në përputhje me kategorizimin në tre nivele: i ulët, i mesëm dhe i lartë. Si rezultat, vetëm rezultatet e katër komponentëve janë identifikuar si me risk të lartë për arritjen e rezultateve të dëshiruara, prandaj propozohen masa zbutëse për të reduktuar probabilitetin e konkretizimit siç detajohet më poshtë:

1. Forcimi i përgjithshëm i NJRF-së me staf si nxitës për ndryshim do të monitorohet nga afër nga nivelet më të larta të menaxhimit;
2. Zgjerimi i SIFQ-së për institucionet e tjera buxhetore, ekspozohet ndaj risqeve të larta për shkak të mungesës së burimeve të mjaftueshme financiare dhe njerëzore pasi mund të rrezikojë zbatimin me sukses. Pasja e asistencës së jashtme funksionale është me rëndësi të jashtëzakonshme për të trajtuar këto vështirësi.
3. Përsa i përket menaxhimit të borxhit dhe parasë, koordinimi i papërshtatshëm mes aktorëve të ndryshëm të përfshirë mund të ndikojë shumë në arritjen e rezultatit të dëshiruar, prandaj, krijimi i një rutine të rregullt komunikimi mund të krijojë një mjedis të duhur për vendimmarrje.
4. Menaxhimi i aktiveve do të ekspozohet në risk të lartë për shkak të mungesës së asistencës teknike. Njësia përgjegjëse dhe niveli i lartë në MFE do të jenë në kontakt të vazhdueshëm me donatorët e huaj për të marrë ndihmën e duhur në këtë drejtim.

6. Kostoja e Strategjisë MFP

Më poshtë është një përmbledhje e shkurtër e burimeve të përdorura për zbatimin e reformës, duke paraqitur të dhënat financiare për shpenzimet gjatë zbatimit të secilit objektiv specifik si shumën e fondeve të buxhetit të qeverisë të shpenzuara dhe financimin e donatorëve në euro.

		Shumat në euro			
		Financim i brendshëm	Financim i huaj	Gjithsej aktualisht 2020	% e ndryshimit
SO1	Kuadër fiskal i matur dhe i qëndrueshëm	90,096	0	90,096	-43%
1.1	Rregullat fiskale dhe parashikimi	18,019	0	18,019	-82%
1.2	Menaxhimi i riskut fiskal	72,077	0	72,077	39%
SO2	Planifikim i mirëintegruar dhe efikas	1,256,813	1,805,171	3,061,984	-46%
	Zhvillimi i politikave dhe qeverisje strategjike e integruar	0	109,700	109,700	-96%
2.1					
2.2	Plani buxhetor afatmesëm	396,423	49,937	446,360	-12%
2.3	Planifikimi dhe mbikëqyrja e investimeve publike	797,323	933,333	1,730,656	90%
2.4	MFP-ja në qeverisjen vendore	63,067	712,201	775,268	-28%
SO3	Mbledhja e të ardhurave	2,812,705	1,263,756	4,076,461	-45%
3.1	Administrata tatimore	2,165,672	0	2,165,672	-16%
3.2	Kadastra fiskale e pronave	0	530,833	530,833	-66%
3.3	Menaxhimi doganor	647,033	732,923	1,379,956	37%
SO4	Zbatimi efikas i buxhetit	421,048	62,639	483,687	-336%
4.1	Zgjerimi i përdorimit të SIFQ-së	0	0	0	-100%
	Kontrollet e angazhimeve shumëvjeçare dhe llogaritë e pagueshme	0	0	0	-100%
4.2					
4.3	Menaxhimi i borxhit dhe likuiditetit	45,048	62,639	107,687	-40%
4.4	Prokurimi Publik	195,807	0	195,807	-39%
4.5	Menaxhimi i fondeve të jashtme	36,038	0	36,038	-30%
4.6	Forcimi i rolit të ndihmës shtetërore	144,154	0	144,154	-26%
SO5	Transparenca e financave publike	1,876,192	247,765	2,123,958	199%
5.1	Llogaritë kombëtare të qeverisë	1,632,933	0	1,632,933	70%
	Monitorimi dhe raportimi financiar dhe i performancës	0	95,238	95,238	90%
5.2					
5.3	Angazhimi qytetarëve	162,173	0	162,173	79%

Raporti i monitorimit MFP 2020

5.4	Kontabiliteti	0	152,527	152,527	152,527	0%
5.5	Menaxhimi i përmirësuar i aktiveve	81,087	0	81,087	136,559	-41%
SO6	Kontroll i brendshëm efektiv	144,154	0	144,154	228,265	-152%
	Menaxhimi financiar dhe kontrolli në institucionet publike	117,125	0	117,125	136,559	-14%
6.1						
6.2	Auditimi i brendshëm	18,019	0	18,019	39,902	-55%
6.3	Inspektimi financiar publik	9,010	0	9,010	51,804	-83%
SO7	Mbikëqyrje efektive e jashtme e financave publike	1,267,042	0	1,267,042	1,310,118	-3%
7.1	Auditimi i jashtëm	1,267,042	0	1,267,042	1,310,118	-3%
					14,638,46	
		7,868,050	3,379,332	11,247,382	2	

7. Konkluzionet dhe rekomandimet

Raporti vjetor i monitorimit janar - dhjetor 2020, në përputhje me Planin e Veprimit 2020-2022, Strategjisë së MFP 2019-2022, përmban informacion mbi zbatimin e shtatë objektivave specifike të strategjisë, Objektivat Specifikë/treguesit e performancës së rezultateve sipas objektivave dhe të arriturve, vlerat dhe aktivitetet konkrete të parashikuara.

Ky dokument është raporti i parë i monitorimit duke përdorur metodologjinë e sistemit SIPIS. Në vitet e ardhshme do të bëhen përpjekje për të patur një përafrim më të mirë me standardet SIPIS.

Ky raport ofron informacion specifik për objektivat OS/produktet e MFP 2020, problemet e hasura gjatë zbatimit, sfidat e institucioneve si dhe identifikimin e masave të nevojshme korrigjuese për periudhat në vijim. Gjithashtu, përmban të dhëna statistikore dhe analitike të bazuara në raportimin e drejtpërdrejtë të institucioneve përgjegjëse, në raportet dhe informacionet e publikuara, konsultimet me të gjithë aktorët e MFP-së. Qeveria e Shqipërisë ka bërë progres të mirë në zbatimin e Strategjisë së Reformës së Menaxhimit të Financave Publike. Ky raport përmban një vlerësim të kriterëve të pranueshmërisë së MFP-së për BE-në për të ofruar mbështetje buxhetore për Shqipërinë. Kriteri i përshtatshmërisë për MFP-në kërkon ekzistencën e një programi të besueshëm dhe përkatës për të përmirësuar menaxhimin e financave publike, si dhe progres të kënaqshëm në zbatimin e programit. Sipas vlerësimit tonë progresi i MFP-së në përgjithësi ka qenë i **kënaqshëm**. Nga monitorimi rezulton se: 75% e objektivave të rezultateve u arritën, 17.5% nuk u arritën dhe 5% u arritën pjesërisht. Për 2.5% kishte të dhëna të pamjaftueshme për të bërë vlerësim. OS 6 dhe OS7 arritën të gjitha objektivat objektive (100%). OS1, OS2, OS3 dhe OS5 patën performancë të mirë deri të kënaqshme, duke arritur përkatësisht 83%, 63%, 71% dhe 75% të objektivave të objektivave të rezultatit. Ndërsa për SO4 u arritën vetëm 57% e objektivave. Në nivelin e produkte: për OS6 dhe OS7 të gjitha rezultatet janë arritur plotësisht; dhe për OS1 67% e produktit u përmbush plotësisht, ndërsa 33% u arrit vetëm pjesërisht. Për OS2 dhe OS5 përqindja e rezultateve që u arritën plotësisht ishte 59%, 50%, 62% dhe 50%.

Informacioni i raportuar duhet të përpunohet dhe dorëzohet në përputhje me kategorinë e informacionit, të jetë bazuar në fakte, të ketë prova të qarta dhe të dhëna analitike në përputhje me raportet e përgatitura nga institucionet përgjegjëse.

Shtojca 1: Statusi i produkteve për 2020

Produkti	Treguesi i Performancës	Niveli bazë	Objektivi i produktit VF20	* Statusi i Objektivit të Produktit VF20
Objektivi Specifik 1: KUADËR FISKAL I MATUR DHE I QËNDRUESHËM				
1.1: RREGULLAT FISKALE DHE PARASHIKIMI				
Produkti 1.1.1: Rregulla fiskale të përmirësuara	a) Janë bërë rregulla fiskale/objektiva të synuara	Rregullat fiskale aktuale	Janë përgatitur rregulla fiskale/objektiva të synuara	
	a) Ndryshime në LOB		Janë miratuar ndryshimet në LOB	
Produkti 1.1.2: Besueshmëria e parashikimit të të ardhurave është rritur	a) Rritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore		Nuk ka objektiva të synuara	
1.2: MENAXHIMI I RISKUT FISKAL				
Produkti 1.2.1: Një DRF e përmirësuar, duke monitoruar dhe zvogëluar më shumë risqe fiskale, sipas nevojës	a) Përfshirja e risqeve fiskale në DRF	DRF mbulon: - sektorin energjistik për NSh-të, - detyrimet e prapambetura, - pretendimet ligjore, - koncesionet, - PPP-të	+ UKT, Hekurudha Shqiptare, Posta Shqiptare, Albgas.	
Produkti 1.2.2: Raport i përmirësuar për detyrimet e prapambetura të qeverisë në përgjithësi	a) Raporti për detyrimet e prapambetura të qeverisë përgatitet nga SIFQ	SIFQ nuk gjeneron raporte automatike për detyrimet e prapambetura të qeverisë	Udhëzimi i është dërguar të gjitha GGU Raporti i konsoliduar është përgatitur dhe publikuar në faqen e internetit të MFE.	

Raporti i monitorimit MFP 2020

Objektivi Specifik 2: PLANIFIKIM I MIRËINTEGRUAR DHE EFIKAS

Produkti	Treguesi i Performancës	Niveli bazë	Objektivi i produktit FY20	* Statusi i Objektivit të Produktit FY20
2.1: ZHVILLIMI I POLITIKAVE DHE QEVERISJE STRATEGJIKE E INTEGRUAR				
Produkti 2.1.1: Përmirësohet procesi për rishikimin e cilësisë së strategjisë, prioritetet e politikave dhe kërkesat e PBA-së	a) Pjesa e strategjive për të cilat janë dhënë rekomandime	41,60%	Tendencë në rritje	
Produkti 2.1.2: Aktivitete të koordinuara për menaxhimin e strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale	a) Hartimi i Raport Progresi Afatmesëm për SKZHI-në		Është përgatitur Raporti Afatmesëm i Progresit të SKZHI	
	b) Raporti i komenteve të dhëna mbi strategjitë sektoriale	NA	> 70 %	
Produkti 2.1.3: Zbatimi me efektivitet i Sistemit të Integruar të Planifikimit (SPI)	a) Miratimi i bazës ligjore për SPI	NA	Baza ligjore për SPI është miratuar	
	b) Miratimi i VKM për hyrjen në fuqi të IPSIS	NA	VKM u miratua	
	c) Përfundimi i analizës së mangësive dhe përkatësisht rishikimi i kuadrit rregullator		Është bërë analiza e mangësive	
Produkti 2.1.4: Forcimi i procesit për zhvillimin e politikave bazuar në të dhëna	a) Ekziston një udhëzues për IP-të	NA	Shpejguesi i udhëzuesit për IP-të është miratuar	
Produkti 2.1.5: Menaxhimi dhe zbatimi efektiv i sistemit IPSIS	a) përdorimi i rrjetit		NA	
	b) SDD përgatitet dhe dorëzohet		NA	
	c) Lançimi i parë i sistemit IPSIS		NA	
	d) përgatitja e manualeve			
	e) materialet e trajnimit			
	f) hartimi i raportit të trajnimit			
	g) Trajnime faza 1			
	h) Trajnime faza 2			
	i) Trajnimi i administratorëve, trajnerëve			
	j) Sistemi IPSIS është operacional			
	k) Plotësimi i lidhjeve mes qëllimeve strategjike të qeverisë dhe programeve buxhetore		100 % të lidhur	
	l) Përgatitet arkiva/sistemi elektronik IPSIS	NA	arkiva elektronike e zhvilluar	

Raporti i monitorimit MFP 2020

2.2: PROGRAMI BUXHETOR AFATMESËM

Produkt 2.2.1: Zbatimi i buxhetit me bazë performancën dhe rritja e përputhshmërisë me metodologjinë e re me të sapo prezantuarën	a) Pilotimi i qasjes së re të PBA-së		Tri organizata buxhetore shtesë kanë përgatitur: • parashikimin e nivelit bazë; • Nismat për politika të reja; • Klasifikimin e programeve buxhetore dhe TKP-ve	
	c) Numri i ML-ve/IB të përfshira në SIMF			
	b) Numri i ekipeve të menaxhimit që janë asistuar	128	128	
	d) Përfunduar dhe publikuar udhëzimet për buxhetin e sektorit	0	4	
Produkt 2.2.2: Shqyrtimi dhe financimi i nismave për politika të reja	a) Numri i mandateve ligjore të pafinancuara			
	b) Komiteti i Planifikimit Strategjik miraton listën e PKA (para se të përfshihet në dokumentin e PBA)			
Produkt 2.2.3: Mbështetja e buxhetit në nivel qendror dhe vendor për barazinë gjinore	a) numri i programeve buxhetore që kanë integruar tërësisht buxhetimin gjinor	33%	55%	
	b) Numri i ekipeve të menaxhimit të programeve nga njësitë e qeverisjes vendore të trajnuar për buxhetimin gjinor (planifikimi dhe monitorimi)	75	tendencë në rritje	
	c) Numri i OSHC-ve të trajnuara për buxhetimin me pjesëmarrje dhe atë gjinor	15	tendencë në rritje	
Produkt 2.2.4 Objektivat e politikave dhe TKP-të përkatëse janë pilotuar për t'u përfshirë si një aneks specifik në Ligjin vjetor të buxhetit	a) Lista e TKP-ve të zgjedhura për secilin program buxhetor dhe prezantimin e procesit të programimit dhe zbatimin përmes SIMF			
	b) raportimi i ML/IB për objektivat			
	c) Ligji për buxhetin vjetor për 2023 përmban objektiva politike dhe TKP-të e tyre si aneks më vete.			
Produkt 2.2.5:Përmirësimi i cilësisë dhe përmbajtjes së dokumenteve buxhetore që shkojnë në parlament për miratim	a) Plani i Veprimit për të miratuar ndryshimet		Plani i Veprimit i miratuar	
	a) Përgatiten dhe përdoren formate për prezantimin e të dhënave dhe përmbajtjes lëndore		Formatet e hartuara	

Raporti i monitorimit MFP 2020

2.3: PLANIFIKIMI DHE MBIKËQYRJA E INVESTIMEVE PUBLIKE

